

# Manual Trajnimi për Qeverisjen e Migracionit dhe Strategjinë e Komunikimit për nëpunësit e shtetit Shqiptar



# | Disclaimer

Përmbajtja e këtij dokumenti “Manual Trajnimi për Qeverisjen e Migracionit dhe Strategjinë e Komunikimit për nëpunësit e shtetit Shqiptar” paraqet vetëm pikëpamjet e autorit dhe përgjegjësinë e tij apo të saj të vetme. Komisioni Evropian nuk pranon asnjë përgjegjësi për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që ai përmban.

Publikuar nga: Organizata Ndërkombëtare për  
Migracionin – Misioni në  
Shqipëri  
Rruga Brigada VIII, P. LID  
Kati III, Ap. 303  
Tirana, Shqipëri  
Tel.: +355 42257836-7  
Fax: +355 4225 7835  
Email: [infotirana@iom.int](mailto:infotirana@iom.int)  
Website: <http://www.albania.iom.int>

# | Mirënjohje

Ky dokument është përgatitur në kuadrin e projektit ARISE ALL që zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe financohet nga Bashkimi Evropian, Zyra e Migracionit e Shërbimit Federal për Punët e Brendshme të Belgjikës dhe Shërbimi i Riatdhesimit dhe Depërtimit i Holandës.

“Manualin e trajnimit për Qeverisjen e Migracionit për nëpunësit e Shtetit Shqiptar” u koordinua me znj. Enkela Dudushi, Drejtor i Deleguar i ASPA - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Për të mbështetur zhvillimin e kurrikulës, IOM angazhoi një ekspert vendas si më poshtë:

- Z. Genti Beqiri: Konsulent Lokal

## Përmbajtja

		Faqe
<b>i</b>	<b>Shkurtime</b>	6
<b>1.</b>	Hyrje	7
<b>1.1</b>	Fusha e veprimit të Manualit	7
<b>1.2</b>	Çfarë përmban ky Manual?	8
	<b>Moduli A</b>	10
	<b>BAZAT E QEVERISJES SË MIGRACIONIT</b>	11
<b>A.1</b>	Migracioni sot: Dimensionet dhe Zhvillimet Globale, Rajonale	19
<b>A.2</b>	Llojet e migracionit dhe shkaqet bazë	19
<b>A.2.1</b>	Migracioni i detyruar	20
<b>A.2.2</b>	Migracioni qarkullues	23
<b>A.2.3</b>	Migracioni/lëvizja e parregullt/pa dokumente	25
<b>A.2.4</b>	Kategoritë e migrantëve në lidhje me llojin e migracionit	27
<b>A.3</b>	Nevoja për Mirëqeverisjen e Migracionit dhe shtyllat bazë	29
<b>A.3.1</b>	Përkufizimi i qeverisjes së migracionit	29
<b>A.3.2</b>	Qasjet ndaj qeverisjes globale të migracionit	31
<b>A.3.3</b>	Shtyllat bazë të mirëqeverisjes së migracionit	32
<b>A.4</b>	Migrantët në situatë vulnerabël dhe përcaktuesit e vulnerabilitetit të migrantit – pjesë e rëndësishme për krijimin e politikave të menaxhimit të migracionit	37
<b>A.4.1</b>	Përcaktuesit e modelit të Vulnerabilitetit të Migrantit	37
<b>A.5</b>	Qeverisja e Migracionit dhe sfidat e COVID-19	41
	<b>Moduli B</b>	
	<b>TË DREJTAT E MIGRANTËVE DHE DETYRIMET E SHTETIT - STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE PËR MIGRACIONIN DHE QEVERISJEN E MIGRACIONIT</b>	
<b>B.1</b>	Legjislacioni ndërkombëtar për migracionin	44
<b>B.1.1</b>	Cilat janë detyrimet e shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut?	46
<b>B.1.2</b>	Instrumentet ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut të migrantëve	47
<b>B.2</b>	Legjislacioni dhe politika rajonale për migracionin	55
<b>B.2.1</b>	Legjislacioni dhe politika rajonale për migracionin	57
<b>B.2.2</b>	Legjislacioni dhe politika e BE-së për migracionin	58
<b>B.3</b>	E ardhmja në qeverisjen e migracionit: Pakti Global për Migracion të Sigurt të organizuar dhe të Rregullt dhe Zbatimi i Objektivave të Zhvillimit të qëndrueshëm (SDG)	64
<b>B.3.1</b>	Pakti Global për Migracion të Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt	64
<b>B.3.2</b>	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm	67
<b>B.4</b>	Migracioni i ndjeshëm ndaj gjinisë dhe miqësor me të miturin	72
<b>B.4.1</b>	Migracioni i ndjeshëm ndaj gjinisë	74
<b>B.4.2</b>	Migracioni miqësor ndaj fëmijëve	79
<b>B.5</b>	Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal dhe kuadri në lidhje me menaxhimin e migracionit dhe pozicioni i Shqipërisë	84
<b>B.5.1</b>	Instrumente të nivelit global të bashkëpunimit për migracionin	84
<b>B.5.2</b>	Bashkëpunimi rajonal për migracionin	86
<b>B.5.3</b>	Marrëveshje dypalëshe	89
<b>B.5.4</b>	Pozicioni i Shqipërisë në lidhje me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në rrjete	91
	<b>Moduli C</b>	
	<b>QEVERISJA E MIGRACIONIT - LEGJISLACIONI, POLITIKAT DHE PRAKTIKA KOMBËTARE</b>	
<b>C.1</b>	Konteksti Kombëtar	94

<b>C.2</b>	Aktorët e rëndësishëm për qeverisjen e migracionit - qasja e qeverisjes qendrore dhe vendore	97
<b>C.3</b>	Vështrim i përgjithshëm i legjislacionit parësor, dytësor dhe i politikave	100
<b>C.4</b>	Hyrja, Vizat, Lëvizja dhe Qëndrimi i të Huajve	104
<b>C.4.1</b>	Regjimi i vizave	105
<b>C.4.2</b>	Qëndrimi i shtetasve të huaj	106
<b>C.5</b>	Migracioni i Parregullt	110
<b>C.5.1</b>	Refuzimi i hyrjes	112
<b>C.5.2</b>	Ri pranimi	113
<b>C.5.3</b>	Kthimi vullnetar	114
<b>C.5.4</b>	Ndalimi	115
<b>C.5.5</b>	Largimi i të huajve	118
<b>C.5.6</b>	Dëbimi	120
<b>C.6</b>	Qeverisja e migracionit përmes mbrojtjes së kategorive të migrantëve në situata veçanërisht vulnerabël	121
<b>C.6.1</b>	Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	125
<b>C.6.2</b>	Azilkërkuesit	128
<b>C.6.3</b>	Refugjatët	131
<b>C.6.4</b>	Të mitur të pashoqëruar dhe të ndarë (UASC)	131
<b>C.6.5</b>	Gratë migrante	135
<b>C.7</b>	Qeverisja e migracionit për motive punësimi	137
<b>C.7.1</b>	Të drejtat e migrantëve për motive punësimi dhe familjeve të tyre	137
<b>C.8</b>	Të drejtat e migrantëve	143
<b>C.8.1</b>	Të drejtat sociale dhe ekonomike	143
<b>C.8.2</b>	Aksesi në kujdesin shëndetësor	144
<b>C.8.3</b>	E drejta për arsimim	145
<b>C.9</b>	Statusi ligjor i qëndrueshëm i migrantëve	146
<b>C.9.1</b>	Qëndrimi afatgjatë	146
<b>C.9.2</b>	Shtetësia	147
<b>C.9.3</b>	Bashkimi familjar	148
<b>Moduli D</b>		
<b>PËRFSHIRJA SOCIALE (RI)INTEGRIMI I MIGRANTËVE DHE 142</b>		
<b>PRAKTIKAT MË TË MIRA</b>		
<b>D.1</b>	Të drejtat në zbatim dhe praktikat më të mira në përfshirjen sociale dhe (ri)integrimin e migrantëve	152
<b>D.1.1</b>	Punësimi	155
<b>D.1.2</b>	Strehimi	156
<b>D.1.3</b>	Shkollimi	158
<b>D.1.4</b>	Mbrojtja sociale dhe shëndetësore	159
<b>D.2</b>	Roli i organizatave ndërkombëtare, OJQ-ve dhe sektorit privat - Partneritetet	161
<b>D.3</b>	Angazhimi i diasporës në zhvillim	164
<b>Moduli E</b>		
<b>NJE STRATEGJI KOMUNIKIMI</b>		
<b>E.1.</b>	Krijimi i një strategjie komunikimi	169
<b>E.1.1.</b>	Strategjia e komunikimit - kuptimi	169
<b>E.1.2.</b>	Përfitimet e të pasurit të një strategjie komunikimi	170
<b>E.1.3</b>	Elementet e një strategjie komunikimi	170
<b>E.1.4</b>	Qasja teorike	171
<b>E.1.5</b>	Komunikimi për ndryshimin shoqëror dhe te sjelljes (SBCC)	172
<b>E.1.6</b>	Kuadri ekologjik i Bronfenbener për zhvillimin njerëzor	172
<b>E.1.7</b>	Vlerësimi dhe përshtatja e qasjes	174
	Pyetje	176
<b>E.2.</b>	<b>Analiza e situatës</b>	177
<b>E.2.1.</b>	Migrimi në Shqipëri realiteti dhe sfidat	177
<b>E.2.1.1</b>	Te dhënat mbi migrimin	179

<b>E.2.1.2</b>	Gjetjet kryesore të punës kërkimore	182
<b>E.2.2</b>	Mjedisi i komunikimit në Shqipëri	183
<b>E.2.2.1</b>	Media tradicionale	183
<b>E.2.2.2</b>	Interneti dhe media online	185
<b>E.2.2.3</b>	Kanalet alternative të komunikimit	186
	Pyetje	187
<b>E.3.</b>	<b>Objektivat e strategjisë së komunikimit</b>	188
<b>E.3.1.</b>	Objektivat e strategjisë	188
<b>E.3.2.</b>	Fushat e përqendrimit	190
<b>E.3.3</b>	Përqendrimi të shtresat e shoqërisë shqiptare	191
<b>E.3.4</b>	Audienca e synuar	192
<b>E.3.5</b>	Grupet e interesit	194
	Pyetje	195
<b>E.4.</b>	<b>Kanalet dhe mjetet e komunikimit</b>	
<b>E.4.1</b>	Kanalet e komunikimit	196
<b>E.4.2</b>	Media e shkruar dhe materialet informuese	200
<b>E.4.3</b>	Mediat e bazuara në internet dhe kanalet e komunikimit elektronik	200
<b>E.4.4</b>	Kanalet alternative të komunikimit	201
	Pyetje	204
<b>E.5.</b>	<b>Mesazhet kryesore dhe ndërveprimi</b>	205
<b>E.5.1</b>	Komunikimi ndër personal	205
<b>E.5.2</b>	Plani i aktiviteteve	208
<b>E.5.3</b>	Plani i veprimit	212
-	Bibliografia	216
-	Koncepti didaktik për ndërtimin e strategjisë së komunikimit	218

## FIGURAT

Figura 1 - Përkufizimi i migrantit, dallimi ndërmjet UNHCR dhe UNPD .....	14
Figura 2 - Pamje e migracionit ndërkombëtar (Raporti Botëror i IOM për Migracionin 2020) .....	18
Figura 3 - Migrantët ndërkombëtarë sipas rajonit më të madh të qëndrimit (IOM WMR 2020, burimi UN DESA 2019) .....	19
Figura 4 -Vendet e emigracionit 2019 (IOM-WMR 2020, burim UN DESA 2019) .....	19
Figura 5 - Marrëdhënia ndërmjet faktorëve të shpërnguljes së detyruar.....	24
Figura 6 - Modeli i përcaktuesve të Vulnerabilitetit të Migrantit (DoMV) .....	39
Figura 7 - Detyrimet e shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare në lidhje me migrantët dhe të drejtat e tyre të njeriut .....	47
Figura 8 - Hierarkia e akteve ligjore në Shqipëri .....	100
Figura 9 - Llojet e vizave në RSH.....	106
Figura 10 - Standardet e pritjes.....	130
Figura 11 - Migrantët nga vendet jo të BE-së .....	141
Figura 12 - Procedura për marrjen e statusit të qëndrueshëm ligjor.....	147
Figura 13 - Profilet e Migracionit, faktorët e kthimit për migrantët shqiptarë .....	151
Figura 14 - Të Kthyerit në Shqipëri 2019.....	153
Figura 15 - Rintegrimi i qëndrueshëm i migrantëve të kthyer .....	161
Figura 16 - Pozicioni i Shqipërisë në partneritete dhe bashkëpunim ndërkombëtar.....	162
Figura 17 - Modeli ekologjik (apo ekosistemi) Bronfenbrenner.....	174
Figura 18 - Burimi i skicës: Materialet të IOM për Migrimin .....	177
Figura 19 - Përqindja e popullsisë shqiptare që ka migruar në vende të tjera.....	178
Figura 20 - Objektivat e politikave dhe komunikimit 1 .....	189
Figura 21 - Objektivat e politikave dhe komunikimit 2 .....	190
Figura 22 - Objektivat e politikave dhe komunikimit 3 .....	190

Figura 23 - Përdorimi i ngjyrave për mesazhet .....	205
Figura 24 - Preferencat e pjesëmarrësve .....	206

## TABELAT

Tabela 1 - Faktorë shtytës dhe tërheqës të shpërnguljes së detyruar .....	24
Tabela 2 - Faktorë shtytës dhe tërheqës të migracionit qarkullues me dëshirë.....	27
Tabela 3 - Aktorët e përfshirë në programimin e nivelit strukturor .....	40
Tabela 4 - Disa nga veçoritë kryesore të migracionit dhe ndikimi i mundshëm i COVID-19 .....	42
Tabela 5 - Lloje specifike të lejeve (nenet 47-60).....	107
Tabela 6 - Identifikimi i migrantëve në nevojë dhe identifikimi i vulnerabiliteteve .....	123

## SHKURTIMET

<b>AMA</b>	Autoriteti i Medias Audio vizuale
<b>ARISE</b>	Ndërgjegjësimit dhe Informacion për Sigurinë dhe Fuqizimin për të Gjithë -
<b>ALL</b>	Shqipëri
<b>ASPA</b>	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
<b>ATSH</b>	Agjencia Telegrafike Shqiptare
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CAT</b>	Konventa kundër Torturës
<b>CEDAW</b>	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave
<b>CERD</b>	Konventa për Eliminimin e Racizmit dhe Diskriminimit Racor
<b>DoMV</b>	Përcaktuesit e Vulnerabilitetit të Migrantit
<b>DT&amp;V</b>	Shërbimi i Riatdhesimit dhe Dëbimit të Holandës
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar
<b>GAMM</b>	Qasja Globale ndaj Migracionit dhe Lëvizshmërisë
<b>GATS</b>	Marrëveshja e Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve
<b>GCM</b>	Pakti Global për Migracionin
<b>GFMD</b>	Forumi Global për Migracionin dhe Zhvillimin
<b>ICCPR</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike
<b>ICESRC</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
<b>ICRMW</b>	Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së Tyre
<b>IDM</b>	Dialogu Ndërkombëtar për Migracionin
<b>ILO</b>	Organizata Ndërkombëtare
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>IO</b>	Zyra e Migrimit e Shërbimit Federal për Punët e Brendshme të Belgjikës
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
<b>ITU</b>	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
<b>KDF</b>	Konventa për të drejtat e fëmijës
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>MiGOF</b>	Kuadri i Qeverisjes së Migracionit

<b>OBT</b>	Organizata Botërore e Tregtisë
<b>OSHC</b>	Organizata të Shoqërisë Civile
<b>OSHC</b>	Organizatat e Shoqërisë Civile
<b>PSV</b>	Procedurat Standarde të Veprimit
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>SBCC</b>	Komunikimi për ndryshimin shoqëror dhe të sjelljes
<b>SDG</b>	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>SHBA</b>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>SKM</b>	Strategjia Kombëtare e Migracionit
<b>SMP</b>	Ofrues të shërbimit të mediave
<b>UN DESA</b>	Departamenti i OBK-së për Çështje Ekonomike dhe Sociale
<b>UNDP</b>	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
<b>UNHCR</b>	Komisioneri i Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
<b>VMT</b>	Viktima të Mundshme Trafikimi
<b>VT</b>	Viktima të Trafikimit



## Hyrje

Miliona njerëz janë pjesë e flukseve migratore në të gjitha vendet në botë sot. Komuniteti ndërkombëtar në tërësi dhe shtetet e veçanta përballen me sfida komplekse për të siguruar që migracioni të zhvillohet në mënyra që janë të rregullta, të sigurta, dhe të organizuara me përfitime reciproke dhe që respektojnë të drejtat e njeriut.

Nuk mungojnë ligje dhe politika për migracionin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Disa masa njohin kontributin pozitiv të migrantëve dhe migracionit në rritjen socio-ekonomike dhe kulturore si dhe në zhvillimin e vendit; megjithatë, masa të tjera reagojnë ndaj migracionit dhe migrantëve si fenomene kërcënuese. Këto masa mund të kenë pasoja negative, sidomos shkeljen e të drejtave të njeriut të migrantëve dhe familjeve të tyre.

Manuali ofron përgjigje për pyetje themelore mbi migracionin, të tilla si ato që kanë të bëjnë me shkaqet bazë dhe përgjigjet e mundshme sa i përket politikave dhe praktikave të mirëqeverisjes, si edhe sfidave, si për migrantët ashtu edhe për shtetet, në lidhje me mirëqenien sigurinë, zhvillimin, integrimin dhe kohezionin shoqëror. Manuali propozon një qasje të ekuilibruar ndërmjet sovranitetit të shtetit dhe të drejtave të njeriut të migrantëve për të zbatuar ligje dhe politika që adresojnë të drejtat e njeriut të migrantëve dhe qeverisjen e migracionit - si një proces i tërë që duhet të sigurojë kohezion mes këtyre dy çështjeve të rëndësishme.

Manuali pasqyron përvojën e gjatë të organizatave ndërkombëtare si OKB dhe IOM që punojnë në fushën e qeverisjes së migracionit dhe tregon si të zbatohet ajo në kontekstin e Shqipërisë. Ai përmban shembuj të masave dhe praktikave në lidhje me qeverisjen e migracionit që janë vërtetuar të jenë të suksesshme në vende të ndryshme të botës.

Manuali ka për qëllim të jetë i dobishëm, jo vetëm për profesionistët që punojnë drejtpërdrejt me migrantët, por edhe për politikë bërësit dhe ekspertët në nivelin e qeverisë, si edhe për shoqërinë civile.

Objektivi përfundimtar i këtij Manualit është informimi dhe promovimi i qeverisjes së migracionit të drejtë dhe të bazuar në të drejta, të pasqyruar përmes politikave dhe praktikave, në përputhje me standardet dhe kuadrin e normave ndërkombëtare dhe rajonale që janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe fëmijëve dhe janë në interes të të gjithë migrantëve si edhe të mirëqenies së shtetit.

### 1.1 Fusha e veprimit të Manualit

Manuali përmban një sërë temash të konsideruara si komponentët kryesorë për trajnimin mbi qeverisjen e migracionit dhe bazohet në Manualin e kursit të IOM-it "Bazat e Menaxhimit të Migracionit Një udhëzues për Politikë bërësit dhe Profesionistët", Paktin Global për Migracionin (GCM), Programin për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG) dhe dokumente të tjera të rëndësishme për qeverisjen e migracionit.

Manuali synon të arrijë një ekuilibër mes trajtimit të qeverisjes së migracionit nga këndvështrimi drejtues-qeverisës dhe nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, duke i kushtuar të dyve vëmendje të njëjtë duke i ndërlidhur ato.

Manuali synon të përdoret si material referimi nga trajnerët e ardhshëm për zhvillimin dhe zbatimin e trajnimeve prezantuese për një larmi profesionistësh përgjegjës për zbatimin e SKM dhe qeverisjen e migracionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale.

## 1.2 Çfarë përmban ky Manual?

Manuali është hartuar për të marrë parasysh kuadrin ligjor dhe operacional ndërkombëtar dhe kombëtar në lidhje me qeverisjen e migracionit. Prandaj, Manuali përpiqet të sjellë një qasje novatore për qeverisjen e migracionit në Shqipëri duke parë përmes këndvështrimit të "të drejtave" me vëmendje të veçantë kushtuar grupeve të pambrojtura të migrantëve.

Ky Manual ofron një vështrim hap pas hapi të kushteve, çështjeve, mjeteve dhe përgjigjeve të politikave në lidhje me migracionin ndërkombëtar që politikë-bërësit dhe profesionistët duhet të kuptojnë për të kryer në mënyrë efektive përgjegjësitë e tyre në nivel kombëtar, për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe qeverisjen e migracionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale për migracionin.

**Moduli A** "Bazat e Qeverisjes së Migracionit" ofron një vështrim të tendencave globale të migracionit. Analizohen shkaqet themelore të migracionit për vendet e destinacionit dhe vendet e origjinës dhe llojet e migracionit; eksploron konceptin e qeverisjes së migracionit; analizon përcaktuesit e vulnerabilitetit të migrantëve si një element i rëndësishëm për t'u konsideruar për hartimin e politikave të migracionit; dhe diskuton çështjet kryesore në lidhje me qeverisjen e migracionit dhe pandeminë COVID-19.

**Moduli B** "Të Drejtat e Migrantëve dhe Detyrimet e Shtetit - Standardet ndërkombëtare dhe rajonale për migracionin dhe qeverisjen e migracionit" hedh bazat për qeverisjen e migracionit në të drejtën ndërkombëtare. Vëmendje e veçantë i kushtohet parimeve dhe detyrimeve të shtetit që burojnë prej instrumenteve thembësore ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat të njeriut sidomos standardeve të punës, ku vëmendje e veçantë i kushtohet instrumenteve specifike ndërkombëtare për mbrojtjen e migrantëve. Gjithashtu jep një pasqyrë e mënyrës se si monitorohen traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe standardet e punës; thekson çështjet gjinore dhe të migracionit duke iu referuar veçanërisht politikave miqësore të migracionit të grave migrante dhe fëmijëve; dhe eksploron proceset dhe bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal, si edhe marrëveshjet bilaterale.

**Moduli C** "Qeverisja e Migracionit": Legjislacioni Kombëtar, Politikat dhe Praktikata" ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të kontekstit ligjor dhe institucional kombëtar që trajton qeverisjen e migracionit. Një vështrim i shkurtër i legjislacionit parësor, dytësor dhe zhvillimeve të politikave përpiqet të prezantojë garancitë ligjore që zbatohen për të huajt si hyrja, lëvizja, qëndrimi dhe banimi në Shqipëri. Ky modul gjithashtu adreson ndalimin e shtetasve të huaj, dëbimin dhe kthimin e të huajve. Vëmendje e veçantë i kushtohet prezantimit të mekanizmave mbrojtës të kategorive veçanërisht të pambrojtura të migrantëve siç janë viktimat e trafikimit, azilkërkuetit, refugjatët, të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, migrantët viktimat e dhunës, abuzimit dhe

shfrytëzimit përfshirë SGBV. Ky modul shtjellon statusin e migrantit dhe zbatimin efektiv të të drejtave të migrantëve.

**Moduli D** "Përfshirja sociale dhe (ri) integrimi i migrantëve dhe praktikat më të mira" prezanton praktikat më të mira për përfshirjen sociale dhe (ri) integrimin e migrantëve në Shqipëri. Analiza përqendrohet në garancitë dhe zbatimin e të drejtave që lidhen me punësimin, strehimin, arsimimin, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore. Qeverisja efektive e migracionit kërkon nxitjen e partneriteteve të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe novatore. Prandaj, vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të organizatave ndërkombëtare, OJF-ve, sektorit privat dhe diasporës, që mbeten thelbësore për rritjen e zhvillimit ekonomik dhe kulturor të Shqipërisë.

**Moduli E** "Strategjia e komunikimit për palët e interesuara në Shqipëri" do t'i shërbejë qëllimit të trajnimit të zyrtarëve publikë që merren me migracionin, të dhënat dhe statistikat e migracionit (të punës). Një strategji komunikimi mund të ndihmojë në sigurimin e informacionit që duhet të komunikohet, rritjen e ndërgjegjësimit, nxitjen e veprimeve, ndërtimin e konsensusit, promovimin e pjesëmarrjes së komunitetit dhe në fund ndryshimin e sjelljes. Komunikimi mund të ndikojë gjithashtu në identifikimin e shqetësimeve që mund të ngrihen dhe të sigurojë arritjen e audiencës së duhur për këtë çështje kaq të rëndësishme.

# **Moduli A**

## **BAZAT E QEVERISJES SË MIGRACIONIT**

## A.1. Migracioni sot: Dimensionet dhe Zhvillimet Globale dhe Rajonale

"Sipas arkeologëve, pothuajse të gjithë njerëzit në Tokë janë migrantë, pasi njerëzimi filloi në Afrikë rreth 200,000 vjet më parë dhe më pas u përhap në të gjithë botën - në Evropë, Azi, Australi dhe Amerikë. ....Në ditët e sotme ka rreth 200 milion migrantë në botë, dhe politikanët dhe njerëzit e zakonshëm në të gjithë globin debatojnë fuqishëm për problemet dhe mundësitë në lidhje me migracionin. ... Ne mund të quajmë shekullin 21 si "epoka e migrantëve"."  
Boris Altner, gazetar<sup>i</sup>

Edhe pse shifrat e përmendur në këtë citat kanë ndryshuar, (shifrat më të fundit vendosin datën e origjinës së njerëzimit në 300,000 mijë vjet më parë dhe tregojnë se aktualisht ka rreth 281 milion migrantë<sup>ii</sup>) përsëri përshkrimi i realiteti migrator të lidhur me fillimin e ekzistencës së njeriut, mbetet aktual edhe pse natyra e tij dhe numri i migrantëve ka ndryshuar me kohën dhe është ndikuar nga rrethana të ndryshme.

Njerëzit lëvizin vazhdimisht në botën e sotme të globalizuar. Migracioni eliminon kufijtë tradicionalë midis kulturave, grupeve etnike dhe gjuhëve dhe shton diversitetin, pasurinë kulturore dhe ekonomike. Pra mund të thuhet që migracioni është një fenomen global. Çdo rajon është i prekur dhe vetëm pak vende mbeten të pa prekur nga ky fenomen.

***Migracioni është një proces i lëvizjes, qoftë përtej një kufiri ndërkombëtar ose brenda një vendi, që përfshin çdo lloj lëvizjeje të njerëzve, pavarësisht nga shkaqet.<sup>iii</sup>***

Është më e vështirë të përkufizosh "migrantin". Një term ombrellë, që nuk është përkufizuar në të drejtën ndërkombëtare, që kuptohet si një person i cili largohet nga vendi i tij ose i saj i qëndrimit të zakonshëm, qoftë brenda një vendi apo përtej një kufiri ndërkombëtar, përkohësisht ose përgjithmonë, dhe për një larmi arsyesh. Termi përfshin një sërë kategorish ligjore të mirë-përcaktuara të njerëzve, siç janë punëtorët migrantë (personat, llojet e veçanta të lëvizjeve të cilëve përcaktohen me ligj) dhe migrantët e kontrabanduar, për shembull; si dhe ata statusi ose mjetet e lëvizjes së cilëve nuk përkufizohen në mënyrë specifike sipas të drejtës ndërkombëtare, siç janë studentët ndërkombëtarë."

Është e rëndësishme të theksohet se duke qenë se në nivel ndërkombëtar, nuk ekziston asnjë përkufizim i pranuar botërisht për "migrantin", IOM ka formuluar një përkufizim operacional të migrantit për qëllime të brendshme i cili nuk ka si qëllim që të krijojë asnjë kategori të re ligjore. Ky përkufizim paraqitet në Kutinë 1 .

**Kutia 1. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) e përkufizon migrantin si një term**

*"një person i cili largohet nga vendi i tij ose i saj i qëndrimit të zakonshëm, qoftë brenda një vendi apo përtej një kufiri ndërkombëtar, përkohësisht ose përgjithmonë, dhe për një larmi arsyesh."<sup>iv</sup>*

Përgjithësisht ndiqen dy qasje për të përkufizuar termin "migrant": qasja e përfshirjes, e ndjekur ndër të tjera nga IOM-i, e konsideron termin "migrant" si një term ombrellë që mbulon të gjitha format e lëvizjeve; dhe qasja e mbetjes, që përjashton nga termi "migrant" ata që largohen nga luftërat ose persekutimi.<sup>v</sup> Për qëllimin e mbledhjes së të dhënave mbi migracionin, Departamenti i

Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale (UN DESA) përkufizon "migrantin ndërkombëtar" si "çdo person që ndryshon vendin e tij ose të saj të qëndrimit të zakonshëm"<sup>vi</sup>. Përkufizimi i UN DESA përjashton lëvizjet që për shkak të "rekreacionit, pushimeve, vizitave të miqtë dhe të afërmit, biznesit, trajtimit mjekësor ose pelegrinazheve fetare".<sup>vii</sup>

Për Komisionerin e Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), refugjatët dhe azilkërkuesit përbëjnë një grup të veçantë të njerëzve, për shkak të arsyeve që kanë pasur për t'u larguar nga vendi i origjinës apo i qëndrimit të zakonshëm për shkak të kërcënimeve të rënda për jetën dhe lirinë e tij. UNHCR e përkufizon refugjatin si "Person i cili, për shkak të frikës të bazuar të përndjekjes për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësimi në një grup të caktuar shoqëror ose mendimit politik, është jashtë vendit të kombësisë së tij dhe nuk është në gjendje ose, për shkak të një frike të tillë, nuk është i gatshëm të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi; ose i cili, duke mos pasur shtetësi dhe duke qenë jashtë vendit të vendbanimit të tij të mëparshëm të zakonshëm si rezultat i ngjarjeve të tilla, nuk është në gjendje ose, për shkak të një frike të tillë, nuk është i gatshëm të kthehet tek ai vend."<sup>viii</sup>

UNHCR paralajmëron lidhur me rreziqet e krijimit të paqartësisë të vijës që ndan refugjatët nga grupet e tjera të migrantëve të cilët janë zhvendosur nga një vend në tjetrin për arsye ekonomike ose sociale që të përmirësojnë jetën e tyre, ndërsa refugjatët janë të detyruar të largohen për të shpëtuar jetën e tyre ose për të ruajtur lirinë e tyre.<sup>ix</sup>

Si rezultat, ekziston kuptimi "migrantëve" të mbetur, si njerëz që jetojnë jashtë vendeve të tyre të origjinës të cilët nuk janë refugjatë (figura 1):


- "një kategori e larmishme, e mbetur e njerëzve që janë të bashkuar nga veçoria që nuk janë refugjatë"

Përkundrazi, Divizioni i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara, siç u tha më lart përdor një përkufizim gjithëpërfshirës sipas të cilit:

- "migrant është çdo person që banon jashtë vendit të tij ose të saj të origjinës.x"

Ky manual do të përdorë përkufizimin më të gjerë të migrantëve që përfshin gjithashtu refugjatët.

Figura 1 - Përkufizimi i migrantit, dallimi ndërmjet UNHCR dhe UNPD



Source: Carling, 2017 (adapted).

## **Sipas të dhënave të stokut të migrantëve ndërkombëtar 2020:<sup>xi</sup>**

**1. Në vitin 2020, numri i migrantëve ndërkombëtarë arriti në gati 281 milion, nga 153 milion në vitin 1990**

### **2. Përqindja e migrantëve ndërkombëtarë në raport me popullsinë e botës**

Përqindja e migrantëve ndërkombëtarë në raport me popullsinë globale ka mbetur relativisht e qëndrueshme ndërmjet viteve 1990 dhe 2020, në rreth 2.8 deri në 3.6 për qind. Megjithatë, për shkak të COVID-19, përlllogaritjet e hershme me supozimin e rritjes zero në periudhën 1 mars - 1 korrik 2020, sugjerojnë një rënie prej gati 2 milion migrantë ndërkombëtarë në shkallë globale nga ajo që pritej fillimisht në mes të vitit 2019 dhe në mes të vitit 2020.

### **3. Shpërnguljet e detyruara përmes kufijve ndërkombëtarë**

Në fund të vitit 2019 të paktën 79.5 milion njerëz në të gjithë botën janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre. Midis tyre janë gati 26 milion refugjatë, rreth gjysma e të cilëve janë nën moshën 18 vjeç.<sup>xii</sup>

### **4. Shumica e migrantëve të botës jetojnë në një numër relativisht të vogël të vendeve<sup>xiii</sup>**

Në vitin 2019, dy të tretat e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë jetonin në vetëm 20 vende. Numri më i madh i migrantëve ndërkombëtarë (51 milion) banonin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke numëruar rreth 19 përqind të totalit të botës. Gjermania dhe Arabia Saudite priten numrin e dytë dhe të tretë më të madh të migrantëve ndërkombëtarë në të gjithë botën (rreth 13 milion secili), pasuar nga Federata Ruse (12 milion) dhe Mbretëria e Bashkuar (10 milion).

### **5. Një e treta e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë e kanë origjinën vetëm nga dhjetë vende<sup>xiv</sup>**

Në vitin 2019, India ishte vendi kryesor i origjinës së migrantëve ndërkombëtarë, me 17.5 milion persona që jetonin jashtë vendit. Migrantët nga Meksika përbënin "diasporën" e dytë më të madhe (11.8 milion), të ndjekur nga Kina (10.7 milion), Federata Ruse (10.5 milion) dhe Republika Arabe e Sirisë (8.2 milion).

### **6. Gratë dhe vajzat përbëjnë pak më pak se gjysmën (48 përqind) e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë<sup>xv</sup>**

Globalisht, përqindja e grave dhe vajzave në numrin e përgjithshëm të migrantëve ndërkombëtarë ra pak nga 49.3% në vitin 2000 në 47.9% në vitin 2019. Përqindja e migrantëve femra ishte më e larta në Amerikën e Veriut (51.8%) dhe Evropë (51.4%), dhe më e ulëta në Afrikën sub-Sahariane (47.5%), dhe Afrikën Veriore dhe Azinë Perëndimore (35.5%).

Në masë të konsiderueshme më shumë gra migrojnë sot vetë ose si kryefamiljare. Migracioni gjithashtu mund të kontribuojë në fuqizimin ekonomik dhe social dhe në emancipimin e grave migrante punëtore përveçse në zhvillimin e tyre socio-ekonomik dhe kulturor. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se fluksi i vazhdueshëm i remitancave të gjeneruara nga punëtore

migrante (ndonjëherë duke tejkeluar ato të meshkujve) është rezultat pozitiv i lëvizshmërisë, pasi ato remitanca janë ndihmë për familjet dhe komunitetet.

## **7. Edhe pse migracioni në botën e sotme ka një ndikim të ndjeshëm në madhësinë e popullsisë në rajonet e destinacionit, ndikimi i tij është shumë më pak i ndjeshëm në rajonet e origjinës<sup>xvi</sup>**

Skenarët e projeksionit tregojnë se madhësia e popullsisë së Amerikës Veriore do të ishte gati 21 përqind më e vogël deri në vitin 2070 me migracion neto zero, ndërsa popullsia e Oqeanisë do të ishte 17 përqind më e vogël dhe e Evropës rreth 9 përqind më e vogël. Përkundrazi, popullsia në rajonet e origjinës do të ishte vetëm ndërmjet 0,1 dhe pak më shumë se 3 përqind më e madhe deri në vitin 2070 sipas skenarit të migracionit neto zero.

## **8. Vetëm disa qeveri po synojnë të ulin numrin e imigrantëve që vijnë përmes rrugëve të rregullta<sup>xvii</sup>**

Në vitin 2019, shumica e 111 vendeve për të cilat kishte të dhëna raportuan që kishin politika ose për të rritur nivelet e imigracionit përmes rrugëve të rregullta (37%) ose për të ruajtur nivelet aktuale (26%). Vetëm tre përqind e qeverive kishin politika për të ulur nivelin aktual të imigracionit të rregullt.

## **9. Promovimi i migracionit të sigurt, të organizuar, të rregullt dhe të përgjegjshëm është një përparësi për shumicën e qeverive<sup>xviii</sup>**

Globalisht, 84 përqind e qeverive raportuan se kishin dispozita për mbërritjen e të miturve të pashoqëruar ose të ndarë; 80 përqind raportuan se kishin informacion dhe fushata sensibilizuese për migrantët e ardhshëm; 76 përqind kishin kontroll për autorizimin para mbërritjes për ata që kërkonin të imigronin; dhe 75 përqind treguan se kishin një sistem për të monitoruar migrantët ndërkombëtarë të cilët qëndronin përtej afatit të vizave të tyre.

## **10. Instrumentet ligjore në lidhje me migracionin ndërkombëtar janë ratifikuar në shkallë të ndryshme nga Shtetet Anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara**

Deri në tetor 2019, instrumentet e hartuara për të mbrojtur refugjatët ose për të luftuar kontrabandimin e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore ishin ratifikuar nga më shumë se tre të katërtat e të gjitha shteteve anëtare, ndërsa instrumentet që mbrojnë të drejtat e punëtorëve migrantë ishin ratifikuar nga më pak se 30 përqind. (Shikoni Modulën B Seksioni 1 për detaje të standardeve ligjore ndërkombëtare)

## **11. Në dhjetor 2018, dy paktet globale, njëri në lidhje me migracionin ndërkombëtar dhe tjetri për refugjatët, u mbështetën nga shumica e Shteteve Anëtare Organizatës të Kombeve të Bashkuara**

Vendet që votuan në favor të Paktit Global për Migracion të Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt (GCM) pritën së bashku rreth 181 milion migrantë ndërkombëtarë në vitin 2019, duke përfaqësuar 67 përqind të totalit në të gjithë botën. Ndërkohë, vendet që votuan në favor të



Paktit Global për Refugjatët priten rreth 25 milion refugjatë, ose 89 përqind të popullsisë globale të refugjatëve.

## **Kutia 2.**

### **Fakte interesante mbi migracionin (Raporti Botëror i Migracionit, IOM 2020)**

Numri i migrantëve ndërkombëtarë në nivel global në vitin 2019: 281 milion në vitin 2000 ishte 150 milion

- **Në vitin 2000-2.8% ndërsa në vitin 2019-3.6% e popullsisë së botës.**
- **52% ishin meshkuj dhe 48% femra.**
- **74% e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë ishin në moshë pune (20-64).**

India vazhdoi të ishte vendi më i madh i origjinës për migrantët në migracionin ndërkombëtar, i ndjekur nga Kina dhe Meksika.

Numri i punëtorëve migrantë ra paksa në vendet me të ardhura të larta ndërsa u rrit në vende të tjera.

Ndërmjet 2013-2017, vendet me të ardhura të larta përjetuan një rënie të lehtë të punëtorëve migrantë - nga **112.3 milion në 111.2 milion**.

Vendet me të ardhura mbi mesatare vunë re rritjen më të madhe - nga 17.6 milion në 30.5 milion.

Numri i punëtorëve migrantë në vitin 2018 ishte 164 milion.

Remitancat ndërkombëtare u rritën në 689 miliardë dollarë në vitin 2018.

Popullsia e refugjatëve në botë në vitin 2018 ishte 25.9 milion.

- **52% e popullsisë të refugjatëve në botë ishte nën 18 vjeç.**

Numri i personave të shpërngulur brenda vendit për shkak të dhunës dhe konfliktit arriti në 41.3 milion.

Numri i personave pa shtetësi në nivel global në vitin 2020 ishte rreth 3.9 milion.

**Në parim njerëzit migrojnë nga zonat/vendet më pak të zhvilluara në ato më të zhvilluara.**

## **Kutia 3.**

### **Përkufizimi i vendeve të origjinës destinacionit dhe tranzitit (IOM)**

**Vend tranziti** është vendi përmes të cilit lëvizin flukset migratore (të rregullta apo të parregullta). Me këtë kuptohet vendi (ose vendet), i ndryshëm nga vendi i origjinës, përmes të cilit kalon një migrant në mënyrë që të mbërrijë në një vend të destinacionit.

**Vend destinacioni** është vendi që është destinacion për flukset migratore (të rregullta apo të parregullta).

**Vendi i origjinës është vendi i shtetësisë së migrantit ose, për personat pa shtetësi, të vendbanimit të mëparshëm të zakonshëm.**

Migracioni neto nga viti 1950 deri në vitin 2020 përjetoj një fluks pozitiv neto të lëvizjes së njerëzve nga rajonet më pak të zhvilluara në vendet të rajoneve më të zhvilluara dhe pritet të vazhdojë në këtë mënyrë në të ardhmen e parashikueshme. Megjithatë, sot shohim se ka disa ndryshime në prirjet migratore, edhe pse përgjithësisht ka vende që janë dhe mbeten kryesisht vende të origjinës ose vende destinacioni që gjithashtu po bëhen vende tranziti dhe destinacioni ose origjine.<sup>xix</sup>


Prandaj, mund të shohim se konceptet tradicionale të migracionit që bëjnë dallim të qartë ndërmjet vendeve të origjinës dhe destinacionit janë duke u zbehur.

**Sot, të gjitha vendet janë vende origjine, tranziti dhe destinacioni, por nga vendi në vend ndryshon vetëm intensiteti i flukseve të lëvizjeve.**

**Migracioni ka kontribuar prej kohësh në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenien sociale si në vendet e destinacionit ashtu edhe në ato të origjinës.** Në këtë epokë të globalizimit dhe lëvizshmërisë në rritje të punës, migracioni sjell përfitime të rëndësishme si për vendet e origjinës, ashtu edhe për vendet e destinacionit, dhe për vetë migrantët - për sa kohë që ndodh në kushte të rregulluara, të përshtatshme.<sup>xx</sup>

Në mënyrë kronologjike lëvizshmëria e njerëzve ka shënuar një prirje në rritje. Kjo mund të shihet përmes numrit të njerëzve që migrojnë krahasuar përgjatë viteve, që tregojnë rritje çdo vit.

Figura 2 - Pamje e migracionit ndërkombëtar (Raporti Botëror i IOM për Migracionin 2020)<sup>xxi</sup>



Duke vëzhguar tendencat rajonale në vitin 2019, Evropa dhe Azia priten secila përkatësisht rreth 82 milion dhe 84 milion migrantë ndërkombëtarë, - që përbëjnë 61 përqind të totalit të stokut global të migrantëve ndërkombëtarë (shih figurën 1). Këto rajone u ndoqën nga Amerika e Veriut, me pothuajse 59 milion migrantë ndërkombëtarë në vitin 2019 ose 22 përqind të stokut global të migrantëve, Afrika me 10 përqind, Amerika Latine dhe Karaibet me 4 përqind dhe Oqeania me 3 përqind.

Figura 3 - Migrantët ndërkombëtarë sipas rajonit më të madh të qëndrimit (IOM WMR 2020, burimi UN DESA 2019)<sup>xxii</sup>





Figura 4 - Vendet e emigracionit 2019 (IOM-WMR 2020, burim UN DESA 2019)<sup>xxiii</sup>



Numri i njerëzve që banojnë në Shtetet Anëtare të BE-së me shtetësi të një vendi jo-anëtar në 1 janar 2020 ishte 23 milion, që përfaqëson 5.1% të popullsisë së BE-së. Gjithashtu, 13.5 milion njerëz me shtetësinë e një Shteti tjetër Anëtar të BE-së jetonin në një nga Shtetet Anëtare të BE-së në 1 janar 2020.<sup>xxiv</sup>

Për shumicën e vendeve të Evropës Juglindore dhe Lindore, **emigracioni më shumë se imigracioni** ka qenë **veçoria kryesore** gjatë viteve dhe dekadave të fundit, me nivele mjaft të ulëta të imigracionit krahasuar me nën rajone të tjera të Evropës. Për shkak të kësaj dhe faktorëve të tjerë, disa vende në Evropë parashikohet se do të përjetojnë rënie shumë të ndjeshme të popullsisë deri në vitin 2050 (përfshirë Bosnjë-Hercegovinën, Shqipërinë, Bullgarinë, Rumaninë, Republikën e Moldavisë dhe Ukrainën).<sup>xxv</sup>

Emigracioni nga vendet e Evropës Lindore në Evropën Perëndimore ka qenë një tendencë në rritje, veçanërisht që me zgjerimin e BE-së në 2004 dhe 2007 për të përfshirë më shumë shtete anëtare të Evropës Lindore, ndërkohë që janë zgjeruar kufijtë e jashtëm të BE-së drejt vendeve jo-anëtare në Lindje.<sup>xxvi</sup>

Emigracioni nga Evropa Lindore dhe Jugore kryesisht përfshin migrantë për motive punësimi në profesione me kualifikime të larta dhe të ulëta. Për shembull, vitet e fundit, kanë parë një rritje të mprehtë të numrit të profesionistëve të shëndetësisë që lëvizin në Evropën Perëndimore.<sup>xxvii</sup>

Në fund, shkalla në rritje e imigracionit të parregullt është një nga tendencat e rëndësishme të migracionit global. Ende në ditët e sotme, pavarësisht përpjekjeve të fuqishme të vendeve kryesore pritëse për të dalë kundër imigracionit të parregullt, numri i parashikuar i imigrantëve të parregullt vazhdon të rritet.

Për shembull, ka pasur një rritje relative të flukseve të migracionit të parregullt në rajon në vitin 2015, krahasuar me vitet e mëparshme, me mbi 1 milion njerëz që mbërritën në Evropë nga deti. Atë vit, rruga e Mesdheut Lindor (kryesisht nga Turqia në Greqi) u bë rruga mbizotëruese për migrantët dhe azilkërkuesit, në krahasim me rrugën e Mesdheut Qendror (nga Afrika e Veriut në Itali).<sup>xxviii</sup>

Mbërritjet e parregullta në Greqi nga toka dhe deti tejkaluan 900,000 në vitin 2015, njëmbëdhjetë herë më shumë se në vitin 2014. Në vitin 2016, shifra e përgjithshme ra ndjeshëm edhe pse ishte akoma në nivele më të larta se vitet e mëparshme; 387.895 migrantë të parregullt arritën në Evropë nga toka dhe deti. Në vitin 2017, 186,768 migrantë të parregullt kishin mbërritur në Evropë nga toka dhe deti, pothuajse të gjithë duke udhëtuar përgjatë rrugës Qendrore, ndërsa numri i migrantëve të parregullt në Evropë ra edhe më shumë në vitin 2018 dhe arriti në 144,166.<sup>xxix</sup> Që nga 13 tetori 2019, në Evropë kanë mbërritur 88,698 migrantë të parregullt.<sup>xxx</sup>

## A.2. Llojet e migracionit dhe shkaqet bazë

Njerëzit kanë shumë arsye pse mund të dëshirojnë të lëvizin nga një vend në tjetrin. Këto arsye mund të ndikohen nga disa faktorë si: ekonomik, social, politik ose mjedisor. Këta faktorë kanë ndikim në kushtet ku ndodh migracioni, si dhe në rezultatet e tij, për shembull: arsyet pse dikush vendos të migrojë, natyra (me dëshirë ose jo) dhe modeli i migracionit (i përhershëm, i përkohshëm, qarkullues); karakteristikat socio-ekonomike (të tilla si mosha, gjinia, kombësia, etnia, statusi social, statusi i migracionit); qasja e migrantëve në kapitalin shoqëror dhe përfshirja e tyre në transaksione dhe rrjete ndërkombëtare; mundësitë dhe sfidat me të cilat përballen migrantët në kontekstet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit dhe rolet që luajnë migrantët në kontekste të tilla.

**Që të ndodhë migracioni duhet të ketë faktorë shtytës dhe tërheqës.**

**Faktorët e migracionit mund të dallohen në dy grupe të përgjithshme si faktorë shtytës dhe tërheqës.**

- **Faktorët shtytës** janë arsyet që e bëjnë dikë të vendosë të lëvizë. Kjo është përvoja e tyre e jetës në një vend, gjë që u jep atyre arsye të mira për t'u larguar. Shpesh faktorët shtytës janë situata të vështira (faktorë negativë) të tilla si papunësia, dështimi i të korrave, thatësira, përmbytjet, lufta, mundësitë e pakta të shkollimit ose shërbime dhe burime të pakta.
- **Faktorët tërheqës**, nga ana tjetër, janë zakonisht pritshmëritë e larta dhe kushtet më të favorshme për qëndrim dhe mundësitë më të mira për migrantët në vendin e destinacionit, të cilat tërheqin njerëzit në vendin destinacionit. Këto janë zakonisht situata të favorshme (faktorë pozitivë) si mundësitë për punë, një standard më i mirë jetese, shkollim ose kujdes shëndetësor më i mirë.

Migracioni në formën e tij më të përgjithshme mund të ndahet në **imigracion dhe emigracion**, në varësi të lëvizjes brenda apo jashtë një vendi:

**Imigracioni** është këndvështrimi nga vendi i mbërritjes - lëvizja në një vend tjetër përveç vendit të kombësisë ose vendbanimit të zakonshëm kështu që vendi i destinacionit bëhet vendi i tij i ri i banimit të zakonshëm.<sup>xxxI</sup>

**Emigracioni** është këndvështrimi nga vendi i nisjes, lëvizja nga vendi i kombësisë ose vendbanimi i zakonshëm në një vend tjetër, kështu që vendi i destinacionit bëhet vendi i tij i ri i banimit të zakonshëm.<sup>xxxii</sup>

Gjithashtu migrimi mund të jetë **ndërkombëtar ose i brendshëm, pra brenda kufijve të shtetit**.

Migracioni ndërkombëtar është largimi i personave nga shteti i vendbanimit të tyre të zakonshëm përtej një kufiri ndërkombëtar duke shkuar në një shtet ku ata nuk janë shtetas.<sup>xxxiii</sup>

Migracioni i brendshëm është lëvizja e njerëzve brenda të njëjtit shtet që përfshin krijimin e një vendbanimi të ri të përkohshëm ose të përhershëm.<sup>xxxiv</sup>

**Migracioni ndërkombëtar mund të ndahet në migracion të detyruar, migracion qarkullues, dhe migracion i parregullt.<sup>xxxv</sup>**

### **A.2.1. Migracioni i detyruar**

Në dallim nga migracioni i rregullt vullnetar, një fluks më i vogël por shumë i rëndësishëm i lëvizjeve migratore ndërkombëtare është ai i njerëzve që detyrohen të largohen nga shtëpitë dhe vendi i tyre pa dëshirë. Sipas IOM (2019) **migracioni i detyruar është:**

#### **Kutia 4. Përkufizimi i IOM-it për migracionin e detyruar**

**"...një lëvizje migratore që edhe pse shtysat mund të jenë të ndryshme, karakterizohet nga një element force, detyruar, ose shtrëngues."<sup>xxxvi</sup>**

Megjithëse nuk është një term ligjor ndërkombëtar, ky term është përdorur për të përshkruar lëvizjet e refugjatëve, personave të zhvendosur brenda vendit ose përmes kufijve (përfshirë ata të zhvendosur nga katastrofat ose projektet zhvillimore) dhe në disa raste, viktimave të trafikimit. Në nivelin ndërkombëtar, përdorimi i këtij termi është i diskutueshëm pasi pranohet gjerësisht që profilet dhe vulnerabilitetet e personave në lëvizje mund të mbivendosen dhe një situatë mund të çojë në një tjetër pra nuk ka një ndarje të prerë ndërmjet migracionit vullnetar e atij të detyruar. Në praktikë kjo mund të çojë në vështirësi në zbatimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e tyre, siç shpjegohet më poshtë.<sup>xxxvii</sup>

Sidoqoftë, duhet të merret në konsideratë që dallimi midis migracionit të detyruar dhe vullnetar që paraqitet këtu lidhet më shumë me një qasje teorike për dallimin midis faktorëve shtytës dhe tërheqës të lëvizshmërisë njerëzore.

Kështu në realitet, njerëzit në lëvizje mund të zhvendosen nga një kategori në tjetrën edhe brenda të njëjtës lëvizje migratore. Për shembull, njerëzit që fillimisht janë shpërngulur me forcë mund të lëvizin më vonë vullnetarisht ose anasjelltas, ose të mbeten në një krizë pasi të kenë migruar në një vend (për shembull migrantët në Libi, Jemen dhe vende të tjera në krizë).

Për sa i përket migracionit të detyruar, një qasje e dobishme për identifikimin e shkaqeve rrenjësores është bërja e dallimit ndërmjet:

- shkaqeve strukturore të shpërnguljes, të cilat përfshijnë një gamë të gjerë zhvillimesh politike, ekonomike dhe sociale; dhe
- shkaqeve akute të shpërnguljes të cilat mund të jenë konflikte të armatosura, luftëra civile dhe forma të tjera të dhunës së përgjithësuar.

Të dy këto grupe faktorësh kanë një rol për të luajtur në lidhje me migracionin e detyruar.<sup>xxxviii</sup> Në përgjithësi, faktorët që kontribuojnë në migracionin e detyruar mund të ndahen gjithashtu si:

- **Faktorët e sigurisë**

Faktorët e sigurisë mund të shkaktojnë rrezik për integritetin personal dhe fizik të individëve, duke i shtyrë ata të migrojnë.

**Përndjekja dhe diskriminimi** në bazë të shtetësisë, racës, fesë, bindjes politike ose anëtarësimi në një grup të veçantë shoqëror i detyron njerëzit të largohen përmes kufijve në kërkim të mbrojtjes ndërkombëtare. Njerëzit mund të rrezikohen nga diçka formale, si **lufta**, apo joformale, siç është **veprimtaria e përhapur e bandave**.<sup>xxxix</sup>

**Qeverisja e dobët**, paqëndrueshmëria politike dhe dështimi për të mbrojtur të drejtat e njeriut shpesh mund të krijojnë kushtet për situata që çojnë në dhunë të përgjithshme, që i detyron njerëzit të largohen nga jetesa e tyre dhe i ekspozon ndaj vulnerabiliteteve dhe rreziqeve. Ndonjëherë, situata e krijuar nga këta faktorë tenton të gjenerojë shpërngulje të ngadaltë ose episodike në dallim nga situatat e eksodeve të shpejta e masive të shkaktuara nga krizat humanitare si p.sh. në rastin e një lufte civile.<sup>xl</sup>

- **Faktorët mjedisorë**

Migracioni i shkakuar nga faktorë mjedisorë është gjithnjë e më pak një zgjedhje për njerëzit që jetojnë në zonat e prekura. Faktorët mjedisorë shkaktojnë shpërnguljen, ose lëvizjen e detyruar të njerëzve. **Dështimi i të korrave** për shembull, shpesh rezulton në mungesë të ushqimit, si edhe në rënie të vendeve të punës në bujqësi, duke mos u lënë njerëzve asnjë mundësi tjetër përveçse të lëvizin në një vend me mundësi më të mira për punë dhe stabilitet. **Ndotja** e ujit, ajrit dhe tokës si në mjediset urbane ashtu edhe në ato rurale mund të krijojë gjithashtu një rrezik serioz shëndetësor për njerëzit që jetojnë në zonat e prekura, duke i detyruar ata të kërkojnë një jetë më të mirë për veten dhe familjet e tyre.

**Fatkeqësitë natyrore** shkatërruese si cunami, uraganet dhe tërmetet janë faktorë mjedisorë që gjithashtu shkaktojnë shpërnguljen e njerëzve.

Megjithëse nuk është në thelb lëvizje e detyruar, në kontekstin e përshkruar më sipër, dhe nuk shoqërohen me dhunë, kushtet shpesh i detyrojnë njerëzit të largohen nga shtëpitë e tyre: njerëzit e pambrojtur kërkojnë të shpëtojnë nga këto situata të rrezikshme dhe të vështira për jetën e tyre .

#### **Kutia 5. Shembuj të faktorëve të sigurisë**

Sipas UNHCR deri në vitin 2020 gati 6.7 milion sirianë janë të zhvendosur brenda vendit dhe mbi 6.6 milion sirianë llogariten si refugjatë. Republika Demokratike e Kongos ka numrin më të lartë të njerëzve të zhvendosur në kontinentin e Afrikës, me gati 6 milion njerëz të detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të konflikteve të ndryshme.

#### **Kutia 6. Shembuj të faktorëve të mjedisit**

Që vitin 2018, 678 000 emigrantë nga Haiti jetojnë në Shtetet e Bashkuara. Shumë prej tyre u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të efekteve shkatërruese të dy uraganeve të mëdha dhe një tërmeti që ndodhen gjatë atyre viteve. Në vitin 2010, një tërmet me magnitudë 7.0 goditi kryeqytetin, duke lënë 1.5 milion Haitianë pa shtëpi. Asnjë katastrofë natyrore nuk kishte prekur asnjëherë një kryeqytet në një mënyrë të tillë. Pasojat e tërmetit paralizuan edhe zonat e tjera jashtë zonës së katastrofës.

Në vitin 2015, një seri tërmetesh shkatërruese goditën Afganistanin, Pakistanin dhe Indinë (me magnitudë 7.5) dhe Nepal (përkatësisht me magnitudë 7.8-dhe 7.3-madhësi). Këto tërmete çuan në dëbimin e qindra mijëra banorëve nga shtëpitë e tyre.


**Ndryshimet e klimës**, që manifestohet në ngritjen e ngadaltë të nivelit të detit, shkretëtirëzimin, dhe në rritjen e incidencës të kushteve ekstreme të motit, ka të ngjarë të jetë një kontribuues i madh për shpërnguljen e detyruar gjatë këtij shekulli nëse nuk merren masa për këto ndryshime .<sup>xli</sup>

Tabela 1 - Faktorë shtytës dhe tërheqës të shpërnguljes së detyruar

Faktorë shtytës	Faktorë tërheqës
Keq menaxhimi i shtetit (korrupsioni, paaftësia), baza e ngushtë e pushtetit, mungesa e legjitimitetit Mobilizimi i mbështetjes përtej linjave etnike, konflikteve civile Konflikti i dhunshëm	Burime dhe njohuri në vendet e destinacionit, sistemet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vendet e destinacionit dhe e drejtë e barabartë dhe pa diskriminim për shërbime dhe siguri;
Mungesa e plotësisimit të nevojave bazë	Vende pune, shkollim, sigurime shoqërore, sisteme të mbrojtjes së shëndetit në vendet e destinacionit
Ngjarje shkatërruese natyrore	Siguri dhe stabilitet, mirëqenie, risk më i vogël për katastrofa natyrore

Në diagramën më poshtë paraqitet marrëdhënia ndërmjet faktorëve të shpërnguljes së detyruar dhe efekteve që ajo ka mbi migracionin e këtyre kategorive të njerëzve

Figura 5 - Marrëdhënia ndërmjet faktorëve të shpërnguljes së detyruar





## A.2.2. Migracioni qarkullues

Migracioni qarkullues është lëvizja e njerëzve mes dy ose më shumë vendeve, duke përfshirë lëvizjen e përkohshme ose afatgjatë, e cila mund të jetë e dobishme për të gjithë aktorët e përfshirë, dhe e lidhur me nevojat e punës të vendeve të origjinës dhe destinacionit.<sup>xliii</sup> Ka disa përkufizime për migracionin qarkullues.

Agunias dhe Newland e shohin migracionin qarkullues në një mënyrë më të gjerë dhe sipas rrethanave identifikojnë katër lloje më të gjera të migracionit qarkullues:

- Migracioni i përhershëm dhe kthimi i përhershëm: Migrantët që kalojnë periudha të gjata jashtë vendit dhe më pas kthehen në vendin e tyre të origjinës;
- Migracioni i përhershëm dhe kthimi i përkohshëm: Migrantët që kanë emigruar një herë e mirë por që kthehen për qëndrim të përkohshëm;
- Migracioni i përkohshëm dhe kthim i përhershëm: Migrantët që qëndrojnë jashtë vetëm për një periudhë të shkurtër dhe më pas kthehen një herë e mirë;
- Migracioni i përkohshëm dhe kthim i përkohshëm: Migrantët që lëvizin rregullisht ndërmjet dy ose më shumë vendeve;

Sipas këtyre tipologjive, të gjitha lëvizjet e migracionit që përfshijnë dy lëvizje ndërkufitare mund të kategorizohen si migracion qarkullues.<sup>xliiii</sup>

### **Kutia 7. Komisioni Evropian, në Komunikatën e tij të vitit 2007, përkufizoi migracionin qarkullues**

*"si një formë e migracionit që menaxhohet në një mënyrë që lejon një masë të lëvizshmërisë ligjore vajtje ardhje ndërmjet dy vendeve."<sup>xliiv</sup>*

Ky është një përkufizim i migracionit të mirë menaxhuar dhe i referohet vetëm menaxhimit të 'lëvizshmërisë të ligjshme'. Përkufizimi është i paqartë dhe i pasaktë, sepse i referohet 'në një farë mase' lëvizshmërisë (që nënkupton kufij të qartë ndaj lëvizshmërisë) dhe 'menaxhohet në një mënyrë' pa qenë specifik në cilën mënyrë.<sup>xliv</sup>

Komunikata e KE-së identifikon dy lloje të migracionit qarkullues në kontekstin e Bashkimit Evropian:

- Migracioni qarkullues i shtetasve të vendeve të treta të vendosur në BE (persona biznesi dhe profesionistë) – migracioni në dalje në vendet e origjinës.
- Migracioni qarkullues i personave që banojnë në një vend të tretë - migracioni në hyrje në një vend të BE-së. Është e rëndësishme të thuhet se Komunikata e KE-së i konsideron studentët si pjesë të përkufizimit.<sup>xlvi</sup>

Veçoritë më karakteristike të migracionit qarkullues përgjatë vijave të këtyre përkufizimeve janë:<sup>xlvii</sup>

- Migracion vullnetar, ndërkufitar;
- Migracioni i përkohshëm afatgjatë / afatshkurtër;
- Migracioni i kthimit afatgjatë / afatshkurtër i migrantëve që janë vendosur jashtë vendit;

- I përsëritur në kohë;
- Mund t'i referohet përfundimit të ciklit të migracionit nga një individ ose nga grupe me modele të ngjashme migracioni;
- Zakonisht i rregullt, por gjithashtu mund t'i referohet migracionit të paautorizuar;
- Kryesisht, por jo domosdoshmërisht i lidhur me aktivitete ekonomike ose kualifikimi (studime, trajnime, punësime, start-up, etj.);
- Mund të përfshijë punëtorë të kualifikuar, me pak kualifikim, stinorë; mund të ndodhë në mënyrë spontane ose të organizuar në programe (migracioni për punë/shkollë) (stinor, jo-stinor, profesionistë, studentë / akademikë /të trajnuar);
- Migracioni qarkullues de facto dhe vullnetar po ndodh në rrjetet e migracionit që lejojnë lëvizjen e lirë (ose të lehtë) mes vendit të destinacionit dhe origjinës (p.sh. BE, shtetet nordike).

Gjithashtu, mund të thuhet se përfundimi i parashikuar i të paktën një cikli migracioni midis të paktën dy vendeve: vendi i origjinës - vendi i destinacionit - vendi i origjinës, megjithëse me pikëpamje të ndryshme për afatin kohor përkatës, është një kriter që e kanë të përbashkët të gjitha konceptet e migracionit qarkullues.

Dallimi themelor midis koncepteve të ndryshme është, nga ana tjetër, qasja e tyre ose normative ose përshkruese ndaj natyrës qarkulluese të migracionit.<sup>xlviii</sup>

Shumica e lëvizjeve të migracionit qarkullues në kontekstin e politikës dhe kërkimit merr një qëndrim normativ (rregullohen me ligje, akte nënligjore dhe marrëveshje dypalëshe e shumëpalëshe).

#### **Kutia 8. Shembull i migracionit qarkullues**

Ekspertët e IT-së që kthehen në Indi për të ngritur një biznes pas qëndrimit në SHBA ose Gjermani.

Punëtorët shqiptarë në plantacionet me portokalle në Greqi që kthehen në Shqipëri me të mbaruar sezoni i vjeljes.

Duke marrë parasysh shumë rezultate pozitive që lidhen me migracionin qarkullues, shumë prej të cilave kanë të bëjnë me efektet e tij pozitive të zhvillimit, migracioni qarkullues vlerësohet si një model i dëshirueshëm migracioni që duhet nxitur (në vend të promovimit të migracionit të përhershëm) dhe që është (ri-)shfaqur si mjet i menaxhimit të migracionit në vitet e fundit.

Përfitimet e zhvillimit të migracionit qarkullues janë theksuar për shembull nga Komisioni Evropian në vitin 2007 që është shprehur se përfitimet e migracionit qarkullues qëndrojnë mbi të gjitha në transferimin e aftësive midis vendeve në fjalë, duke njohur migracionin qarkullues si një formë kryesore të migracionit që nëse menaxhohet mirë mund të ndihmojë në sigurimin e ofertës për kërkesën ndërkombëtare për fuqi punëtore.<sup>xlix</sup>

**Prandaj migracioni qarkullues me fjalë të tjera kryesisht lidhet me migracionin ekonomik vullnetar.**

Tabela 2 - Faktorë shtytës dhe tërheqës të migracionit qarkullues me dëshirë

Faktorë shtytës	Faktorë tërheqës
Keq menaxhimi ekonomik/varfëria, papunësia	Mundësi ekonomike më të mira dhe ofrim i shërbimeve
Keq menaxhim mjedisor/mungesa e burimeve	Kërkesa për fuqi punëtore në vendin e destinacionit dhe rrjetet e migrantëve
Mungesa e shërbimeve sociale bazë	Kultura e migracionit në vendin e origjinës
Sistem arsimor jo mjaftueshëm i zhvilluar	Mundësia për bursa/sisteme arsimore të zhvilluara
Sistem shëndetësor i pamjaftueshëm	Shërbime më të mira shëndetësore dhe akses më i mirë në to.

### A.2.3. Migracioni/lëvizja e parregullt/pa dokumente

Migracioni i parregullt ose i pa dokumentuar është një lëvizje që zhvillohet jashtë normave rregullatore të vendeve të origjinës, tranzitit dhe vendeve pritëse. **Nuk ka një përkufizim të pranuar ose të qartë ndërkombëtarisht të migracionit ndërkombëtar!**

- Nga perspektiva e vendeve të destinacionit: hyrja, qëndrimi ose punësimi në një vend pa autorizimin e nevojshëm ose dokumentet e kërkuara sipas rregullave të imigracionit, si për shembull vizë dhe/ose leje pune.
- Nga perspektiva e vendit të origjinës: migracioni është i parregullt nëse, për shembull, një person kalon një kufi ndërkombëtar pa pasaportë dhe dokument udhëtimi të vlefshëm ose nuk përmbush kërkesat administrative për t'u larguar nga vendi.<sup>1</sup>

Shkaku kryesor i migracionit të parregullt nuk është mosrespektimi i rregullave për migracion se sa është pabarazia ndërmjet vendeve si dhe vështirësitë e shteteve për të krijuar regjime të duhura migracioni për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Mospërputhjet ndërmjet kushteve të rregullave të hyrjes dhe kërkesës për fuqi punëtore, burokracia dhe vonesat administrative bien në kundërshtim me teknologjitë e shpejta të transportit dhe komunikimit që lehtësojnë flukset ndërkufitare të punës dhe nuk marrin shumë parasysh ndryshimin e dinamikës sociale të migracionit.<sup>1</sup> Një nga shkaqet e migracionit të parregullt është edhe mungesa e informacionit nga ana e migrantëve në lidhje me rregullat ekzistuese të vendosura nga vendi pritës. Gjithashtu, kriteret shumë strikte të vendosura për bashkimin familjar dhe vështirësitë për të plotësuar kërkesat ligjore mund të kontribuojnë në migracionin e parregullt. Po ashtu edhe mundësitë e kufizuara për të përfitur statusin e refugjatit nga shteti pritës ose mekanizmat e mbrojtjes, për shembull për të miturit migrantë të pashoqëruar dhe viktimat e trafikimit.

Ka disa përkufizime për migracionin e parregullt:

Një nga dokumentet e para ndërkombëtare që adresonte termin "imigracion i parregullt" ishte Konventa nr. 143 për Punëtorët Migrantë e miratuar nga Konferenca e ILO-s në vitin 1975.

**Kutia 9. Përkufizimi i imigracionit të paligjshëm në Konventën nr. 143 për punëtorët migrantë**

“Lëvizjet si ato ku migrantët e gjejnë veten ‘gjatë udhëtimit të tyre, në mbërritje ose gjatë periudhës së tyre të qëndrimit dhe punësimit në kushte që bien ndesh me instrumentet ose marrëveshjet përkatëse shumëpalëshe ose dypalëshe ndërkombëtare, ose ligjet apo rregulloret kombëtare.”<sup>iii</sup>

**Kutia 10. Përkufizimi i migracionit të parregullt në Fjalorthin për Migracionin, e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin**

"Lëvizja e personave që kryhet jashtë ligjeve, rregullave apo marrëveshjeve ndërkombëtare që rregullojnë hyrjen në ose daljen nga shteti i origjinës, tranzitit ose destinacionit."<sup>iiii</sup>

**Nuk ka një përkufizim të pranuar ose të qartë ndërkombëtarisht të migracionit të parregullt.**

Komuniteti ndërkombëtar, në disa raste, ka inkurajuar përdorimin e termave "të pa dokumentuar" ose "të parregullt" si një alternativë për termin të paligjshëm. Rezoluta 3449 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (Masat për të Siguruar të Drejtat e Njeriut dhe Dinjitetin e Të gjithë Punëtorëve Migrantë (9 Dhjetor 1975)) pranoi që termi "i paligjshëm" nuk duhet të përdoret për të përkufizuar migrantët në një situatë të parregullt. Termi "i parregullt" preferohet në vend të termit "i paligjshëm" sepse ky i fundit mbart një konotacion kriminal, është kundër dinjitetit të migrantëve dhe rrezikon respektimin e të drejtave të njeriut të migrantëve. Migrantët, si çdo qenie njerëzore, nuk mund të jenë kurrë të paligjshëm; ata mund të jenë në një situatë të parregullt, por është e pasaktë t'i referohesh një personi si "të paligjshëm".<sup>liv</sup>

Migracioni i parregullt mund të shfaqet brenda një vendi nëse ka kufizime për lëvizjet e brendshme të popullsisë pa një leje të veçantë (*p.sh.*, në Rusi në kohën e BRSS ose në Korenë e Veriut).<sup>lv</sup>

Ekzistojnë dy lloje kryesore të migracionit të parregullt: *emigracioni i parregullt* dhe *imigracioni i parregullt*. Përveç kësaj, vitet e fundit janë vërejtur se kanë lindur forma të reja të migracionit të parregullt tranzit që kanë të bëjnë me kontrabandimin e migrantëve dhe trafikimin e migrantëve.

- *Emigracioni i parregullt*: zakonisht nënkuptohet si pa kthim dhe shumë shpesh merr formën e migracionit të detyruar. Imigrantët e parregullt shpesh aplikojnë për statusin e refugjatit dhe në rast refuzimi bëhen imigrantë të parregullt në vend dhe ndonjëherë mund të dëbohen në vendet e tyre të origjinës, gjë që mund t'i ekspozojë ndaj rrezikut të përndjekjes.
- *Zakonisht migracioni i parregullt nënkupton kthimin* - kur migrantët kalojnë kufirin shtetëror në mënyrë të rregullt (si turistë, migrantë, ose me ftesë nga miqtë dhe të afërmit), dhe shkelin afatet e qëndrimit, në mënyrë të parregullt (përmes kufijve të pakontrolluar mirë) ose në mënyrë të gabuar (duke përdorur dokumente false dhe viza tranziti) por në të gjitha rastet pasohet me punësim të parregullt (apo në të zezë siç njihet më shumë në gjuhën e përditshme).

- *Punësimi i parregullt* i migrantëve është punësimi pa plotësuar kriteret e kuadrit ligjor lokal në fuqi për punësimin që aplikohen për punëtorët migrantë.

Tre llojet e imigracionit të parregullt mund të përkufizohen:<sup>lvi</sup>

- *Hyrje e pa dokumentuar /e paautorizuar* - një nga llojet kryesore të migracionit të parregullt (*p.sh.*, në SHBA kjo kategori përbën rreth dy të tretat e të gjithë imigrantëve të parregullt). Këta janë njerëz që hyjnë në një shtet tjetër në mënyrë klandestine, në kundërshtim me ligjet e imigrimit. Shumica e atyre këtyre kalimeve të kufirit bëhen përmes kufijve tokësorë, por gjithashtu përdoren edhe rrugët detare dhe ajrore. Në të gjitha rastet, migrantët në kufi arrijnë të shmangë zbulimin dhe, rrjedhimisht, kontrollin. Në të njëjtën kohë, shpesh përdoren rrugë të rrezikshme për migrantët e parregullt të krijuara nga organizatat e kriminimit të organizuar të përfshirë në kontrabandimin e migrantëve.

Duhet bërë dallimi mes kalimeve të parregullta me ndihmë dhe pa ndihmë. Migranti i parregullt që nuk ndihmohet është një person i cili planifikon vetë dhe hyn në mënyrë të parregullt, ndërsa një migrant i parregullt që ndihmohet u drejtohet njerëzve të tjerë (ose grupeve të kriminit të organizuar) për ndihmë. Imigrantët e parregullt shpesh mbështeten - vullnetarisht ose me detyrim - në ndihmën e "ndërmjetësve të migracionit" që shpesh janë pjesë e grupeve kriminale ndërkombëtare të specializuara në kontrabandimin dhe trafikimin e migrantëve.<sup>lvii</sup> Në fakt, është një segment i veçantë i infrastrukturës migratore informale që kundërshton menaxhimin e sigurt e të rregullt të migracionit.<sup>lviii</sup>

- *Hyrja me dokument të falsifikuar* - migrantët që mbërrijnë në vendin e destinacionit duke përdorur dokumente të falsifikuar për hyrje (si pasaporta false ose pasaporta të personave të tjerë, viza false ose të modifikuara, ftesa false, *etj.*).
- *Punësimi i parregullt (informal)*. Ky lloj përfshin njerëz që hyjnë në një shtet tjetër në mënyrë të rregullt (*p.sh.* me viza turistike ose me ftesa private), por më vonë ata nuk përmbushin kushtet e qëndrimit dhe banimit, sipas legjislacionit vendas, dhe hyjnë në tregun e punës në mënyrë të parregullt.

#### **A.2.4. Kategoritë e migrantëve në lidhje me llojin e migracionit**

Përveç llojeve të ndryshme të lëvizjes/migracionit që u diskutuan në tekstin e mësipërm, njihen edhe disa kategori të tjera të migrantëve:<sup>lix</sup>

##### **Kutia 11. (IOM, 2019) Kategoritë e migrantëve:**

- **Migrantë të punësuar të përkohshëm (të njohur edhe si punëtorë mysafirë), në përgjithësi konsiderohet se janë punëtorë migrantë të rekrutuar për një kohë të kufizuar qëndrimi dhe punësimi.**
- **Migrantë Punëtorë dhe sipërmarrës të kualifikuar: punëtorë dhe sipërmarrës migrantë që kanë fituar, me arsim ose përvojë profesionale të nivelit më të**

**lartë, nivelin e aftësive ose kualifikimeve zakonisht të nevojshëm për të praktikuar një profesion me kualifikim të lartë apo zhvilluar një biznes.**

- Migrantë të parregullt (**ose të pa dokumentuar, të paautorizuar**): njerëz që hyjnë në një vend pa dokumentet dhe lejet e nevojshme.
- Anëtarët e familjes së migrantit: të cilët bashkohen me të afërmit e tyre të ngushtë që tashmë kanë migruar.
- Migrantët e kthyer: **personat që kthehen në vendin e tyre të origjinës pasi janë larguar nga vendi i tyre i qëndrimit të zakonshëm dhe kanë kaluar një kufi ndërkombëtar.**

Refugjatët, azilkërkuesit dhe personat e shpërngulur brenda vendit gëzojnë mbrojtje të veçantë sipas ligjit ndërkombëtar. IOM i përkufizon këto grupe si më poshtë:

**Refugjat** është një "person i cili, për shkak të frikës të bazuar të përndjekjes për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësimi në një grup të caktuar shoqëror ose mendimit politik, është jashtë vendit të kombësisë së tij dhe nuk është në gjendje ose, për shkak të një frike të tillë, nuk është i gatshëm të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi; ose i cili, duke mos pasur shtetësi dhe duke qenë jashtë vendit të vendbanimit të tij të mëparshëm të zakonshëm si rezultat i ngjarjeve të tilla, nuk është në gjendje ose, për shkak të një frike të tillë, nuk është i gatshëm të kthehet tek ai vend.

**Azilkërkues** është një "individ që kërkon mbrojtje ndërkombëtare. Në vende me procedura të individualizuara, azilkërkues është një person për kërkesën e të cilit nuk është marrë akoma vendimi nga vendi ku ai e ka paraqitur kërkesën. Jo çdo azilkërkuesi do t'i njihet në përfundim statusi i refugjatit, por çdo refugjat i njohur në fillim është një azilkërkues.

**Persona të shpërngulur brenda vendit (IDP)** janë njerëz apo grupe njerëzish të cilët janë shtrënguar apo detyruar të largohen apo të lënë shtëpitë apo vendbanimet e zakonshme veçanërisht si rezultat apo për të shmangur pasojat e konfliktit të armatosur, situatave të dhunës në shkallë të gjerë, dhunimit të të drejtave të njeriut apo katastrofave natyrore apo njerëzore dhe që nuk kanë kaluar një kufi shtetëror të njohur ndërkombëtarisht."

Gjithashtu ekziston një grup tjetër anëtarët e të cilit përballen me probleme të ngjashme dhe me dhunimin e të drejtave të tyre të njeriut megjithëse mund të mos e kenë ndryshuar vendin e tyre të rezidencës. Ata janë personat pa shtetësi.

**Person pa shtetësi është** "një person i cili nuk konsiderohet si shtetas nga ndonjë shtet në kuadrin e ligjit të tij." Ka një larmi arsyesh pse dikush mund të bëhet pa shtetësi, përfshirë shpërbërjen e shteteve si Bashkimi Sovjetik ose Jugosllavia, apo krijimi i shteteve të reja për shkak të dekolonizimit.

## **A.3. Nevoja për Mirëqeverisjen e Migracionit dhe shtyllat bazë**

***"Migracioni ndikon edhe në vendin e lënë pas, edhe në vendin ku vendosen migrantët."***

Për nga natyra e tyre, migracioni ndërkombëtar dhe shpërngulja janë çështje ndërkombëtare në lidhje me Shtetet e origjinës dhe destinacionit, si dhe Shtetet përmes të cilave migrantët mund të udhëtojnë (shpesh të njohura si Shtete "tranziti") ose ku ata janë pritur pas shpërnguljes përtej kufijve kombëtarë.<sup>lx</sup>

Edhe pse qeverisja e migracionit historikisht ka ardhur nga sovraniteti i shteteve, pasi politikat dhe rregullat e shteteve për migracionin zakonisht hartohen dhe miratohen në nivelin kombëtar, gjatë dy dekadave të fundit,<sup>lxi</sup> praktikat e shteteve për çështjet e migracionit janë ndikuar dhe orientuar nga një sërë normash, procesesh dhe institucioneve të cilat janë zhvilluar dhe dakortësuara përtej nocionit të "shtetit komb" nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar.<sup>lxii</sup>

Në fakt qeverisja e migracionit ka qenë e lidhur ngushtë me sovranitetin e Shtetit. Shtetet ruajnë fuqinë për të vendosur për hyrjen dhe qëndrimin e jo-shtetasve sepse migracioni ndikon drejtpërdrejt në disa nga elementët përcaktues të një Shteti, si siguria e brendshme, rendi publik, shëndeti publik etj.<sup>lxiii</sup> Për shtetet, Migracioni prek shtyllat bazë të sovranitetit (kufijtë kombëtarë), thelbin e sistemeve politike demokratike (të drejtat e njeriut) dhe nevojat shoqërore ataviste (identiteti kombëtar).

Për rrjedhojë, migracioni mund të krijojë lidhje mes një numri parametrash: Sovraniteti i shtetit, siguria e kufirit, logjika ekonomike e globalizimit, integrimi dhe vlerat që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të migrantëve. Si i tillë, migracioni paraqet një sfidë të dyfishtë: balancimi i sigurisë dhe lirisë dhe harmonizimi i detyrimeve ndërkombëtare me ligjet e brendshme.

Së pari, nocioni i "menaxhimit të migracionit" u iniciua në fillim të viteve 1990 me synimin për të arritur një kuadër të ri ndërkombëtar për lëvizjen njerëzore globale dhe migracionin. Sipas Bankës Botërore, 'menaxhimi ka të bëjë me funksionimin e përditshëm të programit brenda kontekstit të strategjive, politikave, proceseve dhe procedurave që janë vendosur nga organi drejtues'.<sup>lxiv</sup>

Zhvillimet më të fundit kanë transformuar termin e menaxhimit të migracionit në "qeverisje të migracionit" që mund të kuptohet më gjerësisht se menaxhimi i migracionit.

Sipas IOM, "menaxhimi i migracionit" kryhet kryesisht nga shtetet, ndërsa termi "qeverisje" i referohet të gjitha kornizave, institucioneve dhe proceseve, në zhvillimin dhe krijimin e të cilave përfshihen shumë më tepër aktorë, sesa vetëm shtetet.<sup>lxv</sup>

### **A.3.1. Përkufizimi i qeverisjes së migracionit**

**IOM e përkufizon qeverisjen e migracionit si:**

'Kuatridi i kombinuar i normave ligjore, ligjeve dhe rregullore, politikave dhe traditave, si dhe strukturave organizative (nën-kombëtare, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare) dhe proceseve përkatëse që i japin formë dhe rregullojnë qasjet e shteteve në lidhje me migracionin në të gjitha format e tij, duke adresuar të drejta dhe përgjegjësi dhe duke promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar.<sup>lxvi</sup>

#### **Kutia 12. IOM për migracionin dhe qeverisjen**

Në fushën e migracionit ndërkombëtar, qeverisja merr një larmi formash, duke përfshirë politikën e migracionit dhe programet e vendeve individuale, diskutimet dhe marrëveshjet ndërshtetërore, forumet shumëpalëshe dhe proceset konsultative, aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, si dhe ligjet dhe normat.<sup>lxvii</sup>

#### **Kutia 13. Kuatridi i IOM-it për Qeverisjen e Migracionit (MiGOF) përkufizon politikën e migracionit**

"ligji dhe politika që ndikojnë në lëvizjen e njerëzve" dhe përfshin politikën për "udhëtimet dhe lëvizshmërinë e përkohshme, imigracionin, emigracionin, kombësinë, tregjet e punës, zhvillimin ekonomik dhe social, industrinë, tregtinë, kohezionin social, shërbimet sociale, shëndetësinë, arsimin, zbatimin e ligjit, politikën e jashtme, tregtinë dhe çështjet humanitare".<sup>lxviii</sup>

Prandaj, në vend që të përqendrohen në veprimtarinë e përditshme të politikave të tyre kombëtare të migracionit, Shtetet kanë zgjedhur një qasje më strukturore dhe strategjike ndaj migracionit me synimin për të adresuar çështje ekonomike, sociale, demografike dhe çështje të tjera të lidhura me to, në koordinim me të tjera, dhe veçanërisht vendet fqinje.

**Ndër të tjera, qëllimi i mundshëm i qeverisjes së migracionit është trajtimi i shkaqeve dhe pasojave të migracionit në mënyrë që të shndërrohet nga një lëvizje e parregulluar e njerëzve, në një proces më të rregullt dhe të parashikueshëm.** Që migracioni të jetë i dobishëm për të gjithë aktorët e interesuar dhe sidomos për vendet pritëse dhe të origjinës, si dhe për vetë migrantët, nevojitet "një hapje e rregulluar" ndaj ligjeve të nevojshme dhe përfituese të migracionit në aspektin ekonomik, dhe vazhdimi i rregullimeve ndaj migracionit të padëshiruar.<sup>lxix</sup> Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se u takon qeverive të përcaktojnë se cili është qëllimi i saktë i politikave të tyre në lidhje me menaxhimin e migracionit.

Prandaj, qeverisja merr një larmi formash, duke përfshirë politikën e migracionit dhe programet e çdo vendi, diskutimet dhe marrëveshjet ndërshtetërore, forumet shumëpalëshe dhe proceset konsultative dhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, si edhe standardet dhe normat përkatëse ndërkombëtare. Ai gjithashtu përpiqet të japë disa funksione në të mirë të vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit, dhe për vetë migrantët, siç janë zhvillimi normativ, ofrimi i shërbimeve dhe forumi për dialog.

Disa forma të migracionit, të tilla si lëvizjet e mëdha dhe të përziera të njerëzve, mund të menaxhohen vetëm me një kuadër të qeverisjes globale. Qasjet rajonale ndaj flukseve migratore nuk mjaftojnë.



**"Mosveprimi global ndaj migracionit përkeqëson katastrofat masive humanitare, skllavërinë moderne dhe trafikimin e qenieve njerëzore."**<sup>lxx</sup>

Është e qartë se në mungesë të një regjimi të unifikuar ndërkombëtar mbi migracionin, ngjarjet e papritura të migracionit në shkallë të gjerë, si dhe ngjarjet gjeopolitike sizmike, mund të kenë ndikime dramatike në mirëqenien e migrantëve dhe përmbushjen e të drejtave të tyre, si dhe në sigurinë e secilit shtet si edhe të rajoneve që preken. Ngjarje të tilla gjithashtu kanë sjellë në vëmendje boshllëqet që ekzistojnë brenda një kuadri të fragmentuar të qeverisjes globale të migracionit, dhe nevojën për më shumë veprime për të zhvilluar një qasje shumë më koherente ndërkombëtare ndaj migracionit për përmirësimin e shteteve, shoqërive dhe migrantëve.<sup>lxxi</sup>

### **A.3.2. Qasjet ndaj qeverisjes globale të migracionit**

Janë bërë përpjekje për të krijuar një kuadër gjithëpërfshirës globale për migracionin. Megjithatë, në shumë vende destinacioni, përpjekjet për të ndërtuar një kuadër gjithëpërfshirës për qeverisjen e migracionit kanë qenë të ndikuar nga debatet e dëmshme mbi çështjet e migracionit në tribunat politike kombëtare në shumë vende të destinacionit për shkak të rritjes së ndjenjave dhe lëvizjeve populiste nacionaliste kundër imigracionit.

Kështu tri qasje ndaj qeverisjes globale të migracionit global kanë dominuar arenën globale:<sup>lxxii</sup>

- **Qeverisja kombëtare/sovrane e migracionit**

Qeverisja kombëtare / sovrane e migracionit mbështetet në premisën që migracioni përbën kërcënim ndaj sigurisë dhe se prandaj kontrolli i migracionit është i një rëndësie kryesore strategjike. Ndërsa kjo është një çështje e vjetër në kohë, veçanërisht në kohë lufte dhe konflikti, siguri i migracionit ka marrë rëndësi që kur fundi i Luftës së Ftohtë, që shkaktoi shqetësime të reja ndaj sigurisë, dhe madje edhe më shumë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara.

- **Qeverisja globale kundër migrantëve**

Sipas këtij interpretimi, në mungesë të një regjimi ndërkombëtar, migracioni mbetet zyrtarisht nën sferën e sovranitetit të shtetit duke i lënë vendin një "Qeverisjeje globale kundër migrantëve" e cila orientohet ose drejt ndalimit të detyruar të lëvizshmërisë së njerëzve dhe/ose drejt shfrytëzimit të punës së migrantëve.

- **Qeverisja globale e migracionit e bazuar në të drejtat e njeriut**

Një qasje e tretë për qeverisjen globale të migracionit, që është më së shumti e pranuar si qasja kryesore në ditët e sotme, përqendrohet në standardet e të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë. Në pamje të parë, qeverisja globale e bazuar në të drejtat e migracionit qëndron mbi një themel të fortë. Sipas përkufizimit të tyre, të drejtat e njeriut janë krijuar për të mbrojtur të gjithë - dhe prandaj zbatohen edhe për migrantët, qoftë në situatë të rregullt apo të parregullt. Nga

#### **Kutia 14. Masa për qeverisjen globale të migracionit**

Në vitin 2015 dhe 2016, për shembull, lëvizja masive e më shumë se 1 milion njerëzve në dhe përmes Evropës (përfshirë Sirianët dhe refugjatët e tjerë) shërbeu si shtysë për Deklaratën e Nju Jorkut për Refugjatët dhe Migrantët (Deklarata e Nju Jorkut), të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në shtator 2016. Më pas u zhvilluan dy Paktet: Pakti Global për Migracionin e Sigurt dhe të Rregullt dhe Pakti Global për Refugjatët.

kjo rrjedh se legjislacioni për të drejtat e njeriut - dhe posaçërisht kodifikimi i tij në të drejtën ndërkombëtare - duhet të sigurojë një bazë të shëndoshë për qeverisjen e migracionit

Qeverisja globale e migracionit e bazuar në të drejta bazohet në standardet ndërkombëtare dhe në bashkëpunimin shumëpalësh si dhe në përfshirjen e organizatave ndërkombëtare, duke korresponduar kështu me një model standard të qeverisjes globale. Gjithashtu ajo mbështetet në bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), të cilat kanë rolin të sigurojnë që mbrojtja e të drejtave të njeriut është e mirë-pozicionuar. Sa i përket parimeve kryesore, qeverisja globale e migracionit e bazuar në të drejta mbështetet në rolin normativ të rëndësishëm të të drejtave të njeriut në qeverisjen migratore globale. Thënë kjo, abuzimet kryesore me të drejtat e njeriut që ndodhin në kontekstin e migracionit dëshmojnë për sfidat me të cilat përballlet qeverisja globale migratore e bazuar në të drejtat e njeriut.

### **A.3.3. Shtyllat bazë të mirëqeverisjes së migracionit:<sup>lxxiii</sup>**

Në përputhje me qasje të bazuar në të drejtat që me ngadalë ka filluar të hyjë në proceset globale dhe kombëtare të zhvillimit të qeverisjes së migracionit, gjejmë parimet e mëposhtme:

- ✓ Përgjegjësia e çdo dege administrative të qeverisë duhet të ushtrohet sipas një qasjeje të koordinuar të të gjithë qeverisë, ku të kuptohet që shqetësimet e popullatave migratore janë ato të të gjithë shoqërisë, prandaj do të ishte e nevojshme një qasje e të gjithë shoqërisë.
- ✓ Shqetësimi universal ndërmjet institucioneve të qeverisjes kërkon miratimin e legjislacionit të synuar dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve në përgatitjen e një kuadri koherent të politikave të migracionit, si në nivel qendror ashtu edhe vendor.
- ✓ Politika efektive dhe koherente kërkon konsultim të organizuar, koordinim dhe bashkëpunim mes të gjithë aktorëve të interesuar në të gjithë institucionet qeveritare ashtu edhe partnerëve socialë (aktorëve të tregut të punës), shoqërisë civile dhe komuniteteve të migrantëve dhe refugjatëve në formën e partneriteteve.
- ✓ Kohezioni social rrjedh nga ofrimi i të drejtave universale dhe të barabarta për të gjithë jo-shtetasit për shërbime publike dhe sociale, veçanërisht kujdes shëndetësor dhe arsim. Integrimi në tregun e punës lehtësohet nga njohja e kualifikimeve, arsimimit dhe trajnimit dhe përvojës, si dhe përputhja efektive e kërkesës dhe ofertës për punë.

Për ta përmbledhur, migracioni mund të sjellë përfitime socio-ekonomike dhe kulturore me një qeverisje që:

- Siguron njohjen dhe mbrojtjen e të gjithë migrantëve garantuar nga legjislacioni, politika dhe praktika e duhur.
- Kalon nga retorika negative për migrantët (konceptimi i gabuar, ksenofobia dhe shfaqjet e racizmit dhe/ose intolerancës) në ligj dhe në diskurs.
- Lehtëson lëvizshmërinë në përgjigje të tregut lokal të punës dhe nevojave të punëdhënësit.
- Zbaton standardet ndërkombëtare të punës për punë të denjë për të gjithë punëtorët vendas dhe të huaj.
- Siguron mbrojtje të plotë për gratë dhe vajzat migrante dhe refugjate, me legjislacionin dhe politikën e ndjeshme ndaj gjinisë.

- Garanton kohezionin social duke parandaluar ksenofobinë dhe duke lehtësuar integrimin
- Zgjeron mbrojtjen sociale dhe shëndetësore, si dhe të drejtën për sigurime shoqërore dhe mbartjen e tyre për migrantët.
- Përmirëson arsimimin, trajnimin dhe njohjen e kualifikimeve për aftësitë profesionale teknike dhe profesionale të nevojshme.
- Përkrah bashkimin e familjes dhe siguron mbështetje.
- Konsultohet dhe merr parasysh të gjithë aktorët e interesuar të shtetit, partnerët socialë, shoqërinë civile dhe komunitetet e refugjatëve.
- e mbështet legjislacionin, politikat dhe praktikat në standardet ndërkombëtare, praktikat më të mira dhe të dhëna të krahasueshme.

Gjithashtu, në vitin 2015, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) zhvilloi një Kuadër të Qeverisjes së Migracionit (MiGOF) për të ndihmuar shtetet anëtare të përcaktojnë se si mund të jetë "politika e migracionit e mirë-menaxhuar " në nivelin kombëtar. Shtetet Anëtare të IOM-it e mirëpritën MiGOF në të njëjtin vit. Treguesit e Qeverisjes së Migracionit (MGI) u zhvilluan për të ndihmuar vendet të operacionalizojnë MiGOF duke përdorur një grup standard prej afërsisht 90 treguesish që mund të zbatohen në gjashtë fusha kryesore të politikave. MGI është një mjet i bazuar në inputet e politikave, i cili ofron njohuri mbi shtysat e politikave që vendet mund të përdorin për të zhvilluar qeverisjen e tyre të migracionit. MGI nuk ka për qëllim të funksionojë si një matës i rezultateve që lidhen me politikat e migracionit dhe institucionet. Përkundrazi, MGI funksionon si kuadër krahasimi i bazuar në inpute që ofron njohuri mbi masat e politikave që vendi mund të përdorë për të forcuar qeverisjen e migracionit. <sup>lxxiv</sup>Për më tepër IOM ka miratuar vizionin strategjik 2019-2022 i cili nuk e zëvendëson Kuadrin e Qeverisjes së Migracionit të IOM-it (MiGOF), bazuar në një sërë objektivash dhe parimesh. Megjithatë, MiGOF nuk jep një orientim të përqendruar, gjë që synon ta bëjë Vizionin Strategjik. Tre shtyllat e Vizionit Strategjik përcaktojnë një seri përparësish strategjike bazuar në një vlerësim të asaj që do të sjellë dekada e ardhshme në drejtim të dinamikës së migracionit dhe nevojave të migrantëve:

- Përshtatshmëria: IOM do të duhet të përgatitet për një numër më të madh të njerëzve që lëvizin brenda dhe jashtë situatave të pambrojtura, që rrjedhin nga një sërë shtysat komplekse, përfshirë ndryshimin e klimës, paqëndrueshmërinë, varfërinë dhe shfrytëzimin. IOM do të përpiqet të ndjekë një qasje afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse për reagimin ndaj emergjencave, duke integruar objektivat e zhvillimit dhe duke njohur shtysat dhe vulnerabilitetet e ndryshueshme.

- Lëvizshmëria: Mënyrat se si lëvizin njerëzit ndryshojnë vazhdimisht. Ndërkohë që dinamika e migracionit evoluon, duhet të zhvillohen edhe mjetet që menaxhojnë lëvizjen, qofshin ato në lidhje me përzgjedhjen, identifikimin, hyrjen, qëndrimin apo kthimin. Në këtë drejtim, IOM do të ndjekë qasje novatore për hartimin dhe zbatimin e sistemeve për të menaxhuar migracionin, bazuar në njohuritë e tij ekzistuese se çfarë funksionon, ku, dhe për kë, dhe kontekste specifike rajonale dhe politike.

- Qeverisja: IOM është tashmë një partner i rëndësishëm për Shtetet Anëtare në drejtim të ofrimit të shërbimeve për migrantët të cilat vetë qeveritë nuk mund t'i ofrojnë. Sidoqoftë, me miratimin e Paktit Global, ka një mundësi të re për IOM-in që të mbështetë qeveritë

pjesëmarrëse për të forcuar kapacitetet për qeverisjen e migracionit dhe për të ofruar ndihmë për migrantët, dhe për të forcuar bashkëpunimin me agjencitë e tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kjo kërkon më shumë partneritete strategjike me një gamë të gjerë të palëve të interesuara dhe partnerëve, dhe zhvillimin e kërkimit, analizës dhe mbledhjes së të dhënave, për të mbështetur vendimmarrjen dhe politikat e mbështetura në gjetje, në një hapësirë shpesh të vështirë.<sup>lxxv</sup>

- **MiGOF që është kuadri i parë e miratuar ndërkombëtarisht për migracionin e mirë-qeverisur parashtron parimet dhe objektivat e mëposhtme që janë baza e shtyllës të qeverisjes së migracionit:**<sup>lxxvi</sup>

### **Parimi 1: Respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe realizimi i të drejtave të migrantëve**

Migracioni njerëzor dhe i rregullt duhet të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Detyrimi për të respektuar, mbrojtur dhe realizuar të drejtat e individëve është parësor dhe zbatohet për të gjithë individët brenda territorit të një Shteti, pavarësisht nga kombësia ose statusi i migracionit dhe pa diskriminim, në mënyrë që të ruhet siguria, integriteti fizik, mirëqenia dhe dinjiteti i tyre. Mbrojtja e të drejtave të individëve përfshin luftën kundër ksenofobisë, racizmit dhe diskriminimit, sigurimin e respektimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe sigurimin e mbrojtjes.

### **Parimi 2: Migracioni dhe politikat e ndërlidhura formulohen më së miri duke përdorur prova dhe qasjen e të gjithë shtetit**

Politika e migracionit shpesh është subjekt i debatit politik intensiv dhe mund të bazohet në ndjenjat populiste. Politika e migracionit duhet të bazohet në fakte dhe në një analizë të bazuar të përfitimeve dhe rreziqeve që paraqet lëvizja e njerëzve ndaj shtetit. Gjithashtu është e rëndësishme që ligji dhe politika të përfshijnë çështje në lidhje me udhëtimin dhe lëvizshmërinë e përkohshme, imigracionin, emigracionin, kombësinë, tregjet e punës, zhvillimin ekonomik dhe social, industrinë, tregtinë, kohezionin social, shërbimet sociale, shëndetësinë, arsimin, zbatimin e ligjit, politikën e jashtme, tregtinë dhe politikat humanitare. Prandaj, qeverisja e mirë e migracionit mbështetet në qasjet e të gjithë qeverisë, ku përfshihen të gjitha ministritë me përgjegjësi që prekin lëvizjen e njerëzve. Në këtë mënyrë, një shtet mund të sigurojë që politika e migracionit dhe lëvizjes të çojë përpara interesat e tij më të gjera.

### **Parimi 3: Qeverisja e mirë e migracionit mbështetet në partneritete të forta**

Për nga natyra e tyre, migracioni dhe lëvizshmëria përfshijnë aktorë të shumtë: Shtetet dhe fqinjët e tyre, autoritetet nën kombëtarë, komunitetet lokale, migrantët dhe familjet e tyre, diasporën, punëdhënësit dhe sindikatat. Përveç kësaj, ka dhjetëra organizata ndër-qeveritare dhe jo-qeveritare mandatet e të cilave prekin migracionin dhe masat humanitare. Mirëqeverisja e migracionit kërkon partneritete për të zgjeruar kuptimin e migracionit dhe për të zhvilluar qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive.

### **Objektivi 1: Qeverisja e mirë e migracionit dhe politika e lidhur me të duhet të kërkojnë të çojnë përpara mirëqenien socio-ekonomike të migrantëve dhe shoqërisë**

Varfëria, paqëndrueshmëria, mungesa e aksesit në arsim ose shërbime të tjera themelore janë vetëm disa nga faktorët që mund t'i shtyjnë individët të migrojnë. Ata që detyrohen të

migrojnë - ndryshe nga ata që zgjedhin të migrojnë - mund të kenë më shumë gjasa ta bëjnë këtë në kushte të padëshirueshme ose të rrezikshme, duke përfshirë hyrjen në shërbimet e rekrutuesve joetikë, kontrabandistëve ose trafikantëve. Prandaj, qeverisja e mirë e migracionit do të nënkuptonte nxitjen e stabilitetit, mundësive për arsimim dhe punësim dhe zvogëlimin e faktorëve të migrimit të detyruar, edhe duke nxitur rezistencën, duke u mundësuar kështu individëve të bëjnë zgjedhjen mes qëndrimit ose migrimit. Edhe nëse faktorët shtytës të migracionit të detyruar do të eliminoheshin, individët përsëri do të zgjidhnin të lëviznin, për shembull, për të kërkuar mundësi të ndryshme ose më të mira, ose për t'u bashkuar me familjet e tyre. Si rrjedhojë, ligjet dhe politikat migratore përkatëse duhet të hartohen për të nxitur gjithashtu rezultate të forta socio-ekonomike për migrantët dhe komunitetet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit.

### **Objektivi 2: Qeverisja e mirë e migracionit bazohet në përgjigjet efektive ndaj dimensioneve të lëvizshmërisë së krizave**

Krizat kanë efekte të konsiderueshme afatgjata mbi migrantët dhe shoqërinë. Prandaj, kërkohet një veprim i harmonizuar nga bashkësia ndërkombëtare për: parandalimin dhe përgatitjen për krizën; mbështetjen për migrantët, personat e zhvendosur dhe komunitetet e prekura nga krizat në përputhje me parimet humanitare; dhe nxitjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për t'i dhënë fund zhvendosjes. Adresimi i shkaqeve thelbësore të krizave dhe lëvizjeve të popullsisë duhet të jetë pjesë e qasjeve afatgjata drejt rimëkëmbjes, tranzicionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Për më tepër, bashkësia ndërkombëtare duhet t'i përgjigjet krizave me kuptimin se migracioni është një pasojë e pashmangshme dhe se përpjekjet për rimëkëmbjen dhe tranzicionin kërkojnë marrjen parasysht të nevojave të migrantëve dhe komuniteteve të tyre.

### **Objektivi 3: Migracioni duhet të zhvillohet në një mënyrë të sigurt, të rregullt dhe dinjitoze**

Të garantosh që migracioni të jetë i sigurt dhe i rregullt nënkupton gjithashtu zbutjen e rreziqeve që lidhen me lëvizjen e njerëzve. Kjo përfshin zbatimin e masave efektive shëndetësore ndërkufitare dhe forcimin e strategjive të shëndetit publik për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve dhe për të mbrojtur shëndetin e migrantëve dhe shoqërisë. Ruajtja e integritetit të skemave të migracionit dhe lëvizshmërisë kërkon një aftësi për të zbuluar migracionin e parregullt dhe për të ndaluar aktivitetin e paligjshëm ndërkufitar. Agjencitë e migracionit dhe kufirit duhet të punojnë me agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtësisë dhe të sigurisë për të mbledhur analiza dhe përdorin informacione të inteligjencës, duke përfshirë adresimin e terrorizmit, si dhe trafikimin e personave, kontrabandën me migrantë dhe veprimtari të tjera kriminale ndërkufitare.

## A.4. Migrantët në situatë vulnerabël dhe përcaktuesit e vulnerabilitetit të migrantit – pjesë e rëndësishme për krijimin e politikave të menaxhimit të migracionit

Me konceptin e vulnerabilitetit nënkuptohet që disa njerëz janë më të pambrojtur ndaj dëmtimeve, në krahasim me të tjerët, si rezultat i ekspozimit ndaj një forme rreziku. Lloji i dëmit ndaj të cilit janë më të ndjeshëm ndryshon: mund të jetë psikologjik, fizik, mjedisor, etj. Faktorët e rrezikut varen nga lloji i dëmit që analizohet dhe mund të mbivendosen ose jo.<sup>lxxvii</sup>

IOM përkufizon vulnerabilitetin si: **“brenda kontekstit të migracionit, vulnerabiliteti përkufizohet si aftësia e kufizuar për të shmangur, rezistuar, përballuar ose për t’u rikuperuar nga dhuna, shfrytëzimi dhe abuzimi.”**<sup>lxxviii</sup>

Megjithatë jo të gjithë migrantët janë të pambrojtur. Për shumë migrantë, migracioni është një përvojë pozitive dhe fuqizuese, por për disa të tjerë, kombinimi i risqeve që hasen dhe situatave që rezultojnë me faktorë riskut të lartë dhe faktorë mbrojtës të ulët, i bëjnë ata veçanërisht të pambrojtur dhe në nevojë për mbrojtje.

### A.4.1. Përcaktuesit e modelit të Vulnerabilitetit të Migrantit

IOM ka përgatitur një model që përpiqet të identifikojë vulnerabilitetet e migrantëve në të gjitha nivelet, pavarësisht nga situata. Ky model mund t’u shërbejë *inter alia* qeverive<sup>lxxix</sup> si një kuadër për analizimin dhe përgjigjen ndaj vulnerabiliteteve të migrantëve dhe mund të ndihmojë për krijimin e politikave të migracionit dhe në përmirësimin e proceseve të identifikimit. Modeli ka dy objektiva kryesore.

- Së pari, mbyllja e hendekut mes mbrojtjes që u ofrohet kategorive të njohura të migrantëve (p.sh. VT, refugjatë) dhe atyre që po përjetojnë dhunë, shfrytëzim, abuzim dhe/ose shkelje të të drejtave, por nuk janë brenda kategorive të mbrojtura të migrantëve.
- Së dyti, modeli synon të ofrojë një qasje të të gjithë shoqërisë për mbrojtjen e migrantëve dhe të kontribuojë me ndërhyrje më të qëndrueshme.

Modeli përkufizon Migrantët e pambrojtur nga dhuna, shfrytëzimi ose abuzimi si:

**Një migrant ose një grup migrantësh me aftësi të kufizuara për të shmangur, rezistuar, përballuar ose rikuperuar nga rreziqet ose përvojat e dhunës, shfrytëzimit ose abuzimit ndaj të cilave ata janë të ekspozuar ose të cilat ata i përjetojnë brenda një konteksti migracioni. Kjo aftësi e kufizuar është rezultat i ndërveprimit unik të karakteristikave dhe kushteve individuale, familjare, komunitare dhe strukturore.**

Modeli shqyrton faktorët në katër nivele: individual, familjar, komunitar dhe strukturor.

Secili faktor mund të krijojë rrezik ose mbrojtje. Vulnerabiliteti shihet si një shkallë, nga shumë e pambrojtur në të mbrojtur, bazuar në ndërveprimet unike të këtyre rreziqeve dhe faktorëve mbrojtës në nivele të ndryshme.

Figura 6 - Modeli i përcaktuesve të Vulnerabilitetit të Migrantit (DoMV)<sup>lxxx</sup>



**Faktorët individualë** i referohen karakteristikave fizike dhe biologjike të një migranti; statusit të tyre në shoqëri; historive dhe përvojave të tyre; bindjeve dhe qëndrimeve të tyre; dhe shëndetit dhe mirëqenies së tyre fizike dhe mendore. Disa shembuj të faktorëve individualë janë mosha, seksi, identitetet racore dhe / ose etnike, orientimi seksual, identiteti gjinor, historitë personale, shëndeti mendor dhe emocional dhe qasja në burime, të tilla si paratë, mallrat, mbështetja. Faktorët e riskut përfshijnë gjëra të tilla si historia e abuzimit me substanca dhe statusi i migracionit të parregullt. Faktorët mbrojtës mund të përfshijnë alfabetizimin dhe të qenit i rritur.

**Faktorët familjarë** janë të lidhur me rolin dhe pozicionin e individëve brenda familjes, si dhe historikun dhe përvojat familjare. Familjet janë të rëndësishme në përcaktimin e vulnerabilitetit, pasi ato zakonisht janë opsioni i parë për individët që kërkojnë mbështetje, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë. Familjet gjithashtu mund të informojnë vendimet për migracionin. Disa shembuj të faktorëve të familjes janë madhësia e familjes, statusi socio-ekonomik i familjes dhe historitë familjare të dhunës dhe abuzimit me substancat. Faktorët e riskut mund të përfshijnë dhunën ndër-personale dhe historikun e sjelljeve të migracionit të pasigurt ndërsa faktorët mbrojtës përfshijnë fitime të mjaftueshme për të përmbushur nevojat themelore dhe mundësitë e barabarta për djemtë dhe vajzat brenda familjes. Individët dhe familjet e tyre preken gjithashtu nga strukturat ekonomike, kulturore dhe sociale të komunitetit të tyre dhe pozicionet e tyre brenda këtyre strukturave. Shembuj të faktorëve të komunitetit përfshijnë aksesin në mundësi cilësore shkollimi, kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale; mundësitë e jetesës dhe gjenerimin e të ardhurave; mjedisin natyror; dhe normat dhe sjelljet

shoqërore. Disa faktorë komunitarë të riskut përfshijnë praktika të tilla si martesë me detyrim, ose prania e rreziqeve natyrore siç është thatësira. Faktorët komunitarë mbrojtës do të përfshinin një sistem të mirë arsimor për të gjithë, qasje të mjaftueshme në kujdesin shëndetësor cilësor dhe një sistem funksional të mbrojtjes sociale.

**Faktorët strukturorë** janë kushtet historike, gjeografike, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe institucionet në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar që ndikojnë në mjedisin e përgjithshëm ku ndodhen individët, familjet, komunitetet dhe grupet dhe që formojnë besimet, vendimet dhe sjelljet. Shembuj të faktorëve strukturorë përfshijnë historitë e kolonizimit dhe konfliktit, sistemet politike, politikat dhe qeverisjen e migracionit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Shembulli i faktorëve të riskut përfshin konfliktin dhe paqëndrueshmërinë dhe qeverisjen e dobët ndërsa faktorët mbrojtës përfshijnë paqen dhe sigurinë, politikat e forta të menaxhimit të migracionit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Situata e një migranti ose e familjes, komunitetit dhe / ose vendit mund të ndryshojë shpejt ose në një mënyrë të paparashikuar dhe kjo mund të rrisë ose të ulë ekspozimin ndaj dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit. Këta faktorë rrethorë janë të ndërthurur me katër faktorët e ndryshëm të përmendur më lart. Një shembull i një faktori rrethor rrezikut mund të jetë shpërthimi i konfliktit pasi ky e ekspozon komunitetin ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit, përfshirë trafikimit të personave.

**Modeli DoV është i dobishëm për programimin në menaxhimin e migracionit nga shtetet:**

Programimi që synon të adresojë faktorët strukturorë mund të përfshijë përmirësime të ligjeve dhe politikave kombëtare për t'u siguruar që ato të njohin të drejtat e migrantëve dhe të ofrojnë mbrojtje të përshtatshme për migrantët; zhvillimin dhe zbatimin e politikave për migracion të sigurt dhe të rregullt, përfshirë lëvizshmërinë e fuqisë punëtore; ndjekjen e politikave zhvillimore të barabarta dhe në favor të të varfërve; përmirësimet e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut; dhe pengesat ndaj diskriminimit kundër grupeve specifike.

Në nivelin strukturor, programimi ka tendencë të jetë më afatgjatë dhe zakonisht është fusha e qeverive dhe institucioneve rajonale ose ndërkombëtare. Përpjekjet drejt ndryshimit strukturor mund të kërkojnë më shumë kohë për t'u arritur; por gjithashtu ka të ngjarë të kenë ndikim të gjerë.

*Tabela 3 - Aktorët e përfshirë në programimin e nivelit strukturor*

Aktorët	Shembujt	Sektorët
Autoritetet shtetërore (përfshi edhe bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal)	Politikë bërësit dhe vendimmarrësit si anëtarët e ekzekutivit, parlamentit dhe kongresit; si edhe ata që miratojnë dhe zbatojnë politika dhe ligje, siç janë drejtuesit e qeverisjes vendore, inspektorët dhe punonjësit e policisë	Të gjithë



Organizatrat rajonale dhe shumëpalëshe	Agjencitë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe subjektet e koordinimit; bankat rajonale të zhvillimit, bashkimet politike, organet e të drejtave të njeriut dhe organizatat tregtare	Zhvillimi i kapaciteteve, avokatia, të dhëna dhe studime, politika dhe çështje të fushave brenda fushës së tyre specifike të kompetencës, që promovojnë integrimin e migrantit dhe luftojnë ksenofobinë dhe diskriminimin.
Shoqëria civile	Organizatrat dhe lëvizjet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore që synojnë të përfaqësojnë interesin e komunitetit, kategori të caktuara njerëzish dhe promovimin e grupeve dhe/ose të drejtave specifike	Zhvillimi i kapaciteteve, avokatia, të dhëna dhe studime, politika dhe çështje të fushave brenda fushës së tyre specifike të interesit, që promovojnë integrimin e migrantit dhe luftojnë ksenofobinë dhe diskriminimin.
Sektori privat	Biznese, punëdhënës dhe shoqata biznesi	Puna e denjë dhe përgjegjshmëria e sektorit privat, që promovon integrimin e migrantit dhe lufton ksenofobinë dhe diskriminimin.
Ofrues Shërbimi	Punonjës të kujdesit shëndetësor, edukatorë dhe këshilltarë punësimi	Promovimi i integritit të migrantëve dhe lufta kundër ksenofobisë dhe diskriminimit
Anëtarë të publikut	Avokatë, opinionistë dhe influencers, anëtarë të lëvizjeve sociale	Të gjithë

Në nivelin strukturor qeveritë në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm, në përputhje me qasjen e tërë shoqërisë duhet të krijojnë një mjedis mundësues për migrantët e pambrojtur përmes:

- Përmirësimin e politikave, kuadrit ligjor dhe rregullator
- Përmirësimin e marrëveshjeve institucionale dhe koordinimit (planet kombëtare të veprimit, mekanizmat kombëtarë të referimit);
- Zhvillimit të kapaciteteve;
- Avokatisë;
- Mbledhjes, analizës së të dhënave dhe studimeve;
- Qeverisjes së migracionit;
- Integritit të migracionit në politikën e zhvillimit shoqëror;
- Trajtimin të migracionit në kohë krizash;
- Luftës kundër trafikimit të personave dhe kontrabandimit të migrantëve;
- Mbrojtjes sociale;
- Promovimit të integritit të migrantëve dhe luftës kundër ksenofobisë dhe diskriminimit.

## A.5. Qeverisja e Migracionit dhe sfidat e COVID-19

Në përgjigje të shpërthimit të COVID-19, shumë vende kanë mbyllur përkohësisht kufijtë e tyre për shumicën e pasagjerëve ndërkombëtarë. Në disa raste, këto kufizime ishin masa të përkohshme ndërsa disa vende kishin norma më të ulëta infeksioni sesa fqinjët e tyre. Me kalimin e kohës, kufizimet e udhëtimeve ndërkombëtare kanë plotësuar kufizimet e përhapura në udhëtimet brenda vendeve.

Përhapja e shpejtë e infeksionit, shkalla e lartë e vdekshmërisë, shërbime të pamjaftueshme shëndetësore, dhe mungesa e vaksinës i kanë shtyrë shoqëritë të bllokojnë, të ulin orët e punës dhe të praktikojnë distancimin social. Një përgjigje ndaj shpërthimit të korona virusit në Kinë në dhjetor 2019 ishte vendosja e ndalimi ndaj udhëtimeve ndërkombëtare dhe karantinës për mbërritjet ndërkombëtare. Rrjedhimisht, shumica e vendeve kanë vendosur një ndalim në hyrjen jo vetëm të të huajve, por edhe të shtetasve të kthyer.<sup>lxxxii</sup>

Këto masa i kanë sjellë aktivitetet ekonomike globale afër një ngërçi. Pezullimi i tillë i njëkohshëm i aktiviteteve në të gjithë botën është i pashembullt në histori. Në të gjithë botën, shumë biznese, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe bizneset informale, janë ndalur. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ekonomia botërore pritet të tkurret me 3 për qind në vitin 2020 në skenarin bazë, një ndryshim prej gati 6 për qind krahasuar me vitin 2019.<sup>lxxxiii</sup>

Në këto realitete, tabela më poshtë shpjegon ndikimin e mundshëm të COVID-19 te migracioni dhe migrantët.

Tabela 4 - Disa nga veçoritë kryesore të migracionit dhe ndikimi i mundshëm i COVID-19<sup>lxxxiii</sup>

Veçoritë kryesore të migracionit	Ndikimet e COVID -19
<p><b>Remitancat</b> Për shumë njerëz në vendet dhe rajonet në zhvillim, remitancat janë një rrugë shpëtimi dhe luajnë një rol kritik në plotësimin e nevojave themelore të tilla si ushqimi dhe strehimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Miliona migrantë po përballen me humbjet e vendeve të punës, bllokimet dhe mbylljen e biznesit, ndërsa shumë prej tyre tani nuk janë në gjendje të dërgojnë para për familjet e tyre.</li> <li>Për vendet që varen shumë nga dërgesat e parave, ulja e remitancave do të ketë një ndikim shkatërrues në ekonomitë e tyre.</li> </ul>
<p><b>Punëtorët migrantë</b> Shumica e punëtorëve migrantë në botë banojnë në vende me të ardhura të larta (68%)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>COVID-19 ka pasur një ndikim shkatërrues në punëtorët migrantë, duke lënë shumë prej tyre pa punë, të bllokuar jashtë vendit dhe në rrezik më të madh të ekspozimit ndaj sëmundjes.</li> <li>Në disa vende, janë ngritur shqetësime për sigurinë e tyre, pasi shumë prej tyre jetojnë në kampe të mbipopulluara ku mungon higjiena, ndaj ata janë të pambrojtur ndaj sëmundjeve.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Migracioni i punës është pezulluar përkohësisht në disa vende ndërsa, në të tjera, migracioni, shqyrtimi dhe ndihma për azilkërkuesit po ngadalësohen.</li> <li>• Ekonomitë kontraktuese dhe rritja e papunësisë në vendet pritëse do të thotë që shumë migrantë do të duhet të kthehen në shtëpi, duke shtuar papunësinë në vendet e origjinës.</li> </ul>
<b>Popullsia e shpërngulur</b> Shumica e popullsisë të shpërngulura përfshirë refugjatët dhe IDP e kanë origjinën dhe priten në rajonet në zhvillim.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumë vende në zhvillim ku janë pritur shumica e popullsisë të zhvendosur kanë sisteme shëndetësore të mbingarkuara dhe me mungesa kapaciteti.</li> <li>• Shumë refugjatë dhe Persona të Zhvendosur brenda vendit jetojnë në vende të mbipopulluara dhe në kushte jo- higjienike ku distancimi social është i pamundur, duke rritur frikën se COVID-19 do të përhapet shpejt dhe do të jetë e vështirë të frenohet.</li> <li>• Kufizimet e udhëtimit për shkak të COVID-19 paraqesin vështirësi dhe ndikojnë në ofrimin e ndihmës humanitare.</li> <li>• Disa vende kanë mbyllur kufijtë për azilkërkuesit, ndërsa programet e vendosjes së refugjatëve janë pezulluar përkohësisht për shkak të kufizimeve të udhëtimit.</li> </ul>
<b>Katastrofat dhe konfliktet</b> Ndryshimi dhe katastrofat mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fokusi te COVID-19 i ka shqetësuar vendet duke i lënë ato të pa përgatitura për të adresuar katastrofat e mundshme nëse ndodhin.</li> <li>• Zhvendosjet e zgjatura, të tilla si konfliktet, veçanërisht në rastet kur proceset e paqes janë ndërprerë ose kur ndihma është tërhequr.</li> </ul>
<b>Migrantët e parregullt</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Migrantët e parregullt janë më të ndjeshëm ndaj ndikimit të COVID-19 për shkak të pamundësisë për akses në shërbimet shëndetësore, rrezikut të ndalimit dhe kushteve të këqija të punës / strehimit me rrezik më të madh ndaj ekspozimit.</li> <li>• Kufizimet e udhëtimit në lidhje me COVID -19 mund të rrisin migracionin e parregullt, pasi rrugët e hyrjes së rregullt janë mbyllur. Ato mund të ndryshojnë modelet migracionit të parregullt, duke zvogëluar aftësinë e shteteve për të kontrolluar të gjitha mbërritjet ndërkombëtare për COVID-19 dhe për të shmangur transmetimin e mundshëm të mëtejshëm të virusit.</li> </ul>

#### **Kutia 15. Praktikë më të mira për trajtimin e sfidave nga COVID-19 me të cilat përballen migrantët<sup>lxxxiv</sup>**

- Shërbimet Shëndetësore Irlandeze kanë përkthyer informacion për COVID-19 në 23 gjuhë për t'u siguruar që të gjithë anëtarët e shoqërisë, përfshirë migrantët, të informohen në mënyrën që u nevojitet për të qëndruar të shëndetshëm dhe për të ndjekur udhëzimet e karantinës.

- Kuvajti ka ofruar një periudhë amnistie që u mundëson punonjësve migrantë pa dokumente të udhëtojnë në shtëpi dhe ka njoftuar një numër masash për të mbrojtur punëtorët migrantë.
- Në Tajlandë, shtetasve të huaj, të cilëve më parë u ishte kërkuar të aplikonin për zgjatje të vizave përmes Zyrës së Emigracionit u është miratuar zgjatja automatike e vizave.
- Qeveria e Guatemalës po sigurohet që të miturit e pashoqëruar të kthyer gjatë krizës COVID-19 të kenë akses në kushte karantine të sigurt, dinjitoze dhe miqësore me fëmijët pas kthimit si ndihmë për ri integrimin, përfshirë testimin, salla individuale në streha për të shmangur përhapjen e virusit, dhe mbështetje psiko-sociale.
- Qeveria e Portugalisë vendosi që për të gjithë migrantët që ishin në pritje të pajisjes me leje qëndrimi (që nga 18 Mars 2020) t'u miratohet qëndrimi i përkohshëm dhe të sigurohen të njëjta të drejta si shtetasit, përfshirë mbështetje sociale. E njëjta masë u morr edhe për azilkërkuesit. **Qeveria ra dakord të lirojë personat e ndaluar për shkak të imigracionit pasi bëri vlerësime individuale rast pas rasti.**

## **Moduli B**

**TË DREJTAT E  
MIGRANTËVE DHE  
DETYRIMET E SHTETIT -  
STANDARDET  
NDËRKOMBËTARE DHE  
RAJONALE PËR  
MIGRACIONIN DHE  
QEVERISJEN E  
MIGRACIONIT**

## B.1. Legjislacioni ndërkombëtar për migracionin

*“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi.*

*Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër statusi. [...]*”

*Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, rezoluta e 217 A (III) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948, nenet 1 dhe 2.*<sup>lxxxv</sup>

Ekziston një tërësi mjaft e detajuar e rregullave ligjore, konventave shumëpalëshe dhe marrëveshjeve dypalëshe që rregullojnë dhe kanalizojnë autoritetin shtetëror mbi migracionin.<sup>lxxxvi</sup>

Këto norma janë krijuar përmes negociatave shtet me shtet, zakonisht përmes proceseve ndërkombëtare nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, ILO-s dhe institucioneve të tjera.

Disa degë të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare përfshijnë norma që u njohin të drejta migrantëve (përfshi edhe dhe refugjatëve) si çdo qenieje njerëzore, si edhe të drejta specifike, si edhe norma që trajtojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në rregullimin e migracionit. Këto përfshijnë:

- 1) të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, posaçërisht nëntë instrumente thelbësorë të të drejtave të njeriut, që përmbajnë dy Pakte përkatësisht për të Drejtat Politike dhe Civile dhe për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, së bashku me shtatë konventat ndërkombëtare bazë që trajtojnë situata dhe grupe specifike: diskriminimi racor, tortura, gratë, fëmijët, punëtorët migrantë dhe aftësitë e kufizuara.<sup>lxxxvii</sup>
- 2) Standardet Ndërkombëtare të Punës, në fakt që të gjitha, përveç rasteve të rralla kur përjashtohen punëtorë të huaj, dhe veçanërisht dy Konventat e posaçme të ILO-s për migracionin për motive punësimi.
- 3) të drejtën për refugjatët dhe azilin, veçanërisht Konventa e vitit 1951 dhe Protokollin i vitit 1967 mbi Statusin e Refugjatëve.
- 4) të drejtën ndërkombëtare penale, veçanërisht Protokollin për Trafikimin e Personave dhe Kontrabandimin e Migrantëve të Konventës Ndërkombëtare për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar.
- 5) të Drejtën Ndërkombëtare Konsullore, përkatësisht Konventa e Vjenës në lidhje me mbrojtjen e shtetasve të huaj nëpërmjet aksesit të përfaqësuesit e qeverive të tyre.
- 6) të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare.

Ky Manual përqendrohet në 4 degët e para, siç u diskutua më hollësisht në seksionet vijuese. Veçanërisht të rëndësishme mes këtyre degëve janë Instrumentet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe E drejta Ndërkombëtare e Punës, të dyja këto mund të konsiderohen si ligj për të drejtat e njeriut.

Instrumentet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut ofrojnë një kuadër të gjerë dhe të plotë normativ për mbrojtjen e migrantëve.

### B.1.1. Cilat janë detyrimet e shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut?

Kur shtetet bien dakord për traktatet ndërkombëtare (përmes një procesi të quajtur ratifikim), ato marrin përsipër detyrimet *për të respektuar*, *për të mbrojtur* dhe *për të realizuar* të drejtat e njeriut që përfshihen në këto traktate.<sup>lxxxviii</sup>

**Detyrimi për të respektuar** do të thotë që Shtetet duhet të mos ndërhyjnë ose të mos kufizojnë gëzimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu është përshkruar si një detyrim *negativ*, pasi shteti duhet të mos shkelë të drejtat e njeriut.<sup>lxxxix</sup>

Dy detyrimet e tjera përfshijnë detyra *pozitive*, që do të thotë se shteti duhet të marrë masa për të ofruar të drejtat.

**Detyrimi për të mbrojtur** kërkon që Shtetet të ndërhyjnë në mënyrë që të mbrojnë individët dhe grupet nga shkeljet e të drejtave të njeriut nga të tjerët, në veçanti nga aktorët privatë.<sup>xc</sup>

**Detyrimi për të realizuar** do të thotë që Shtetet duhet të marrin masa pozitive për të lehtësuar gëzimin e të drejtave të njeriut.<sup>xc</sup>

Përmes ratifikimit të traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, qeveritë marrin përsipër të zbatojnë masa dhe legjislacionin e brendshëm në përputhje me obligimet dhe detyrat e tyre në bazë të traktatit. Kur procedurat e brendshme ligjore nuk arrijnë të adresojnë abuzimet e të drejtave të njeriut, mekanizmat dhe procedurat për ankimimet individuale ose komunikimet mundësohen në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për të siguruar që standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të respektohen dhe të zbatohen në nivelin lokal.<sup>xcii</sup>

Figura 7 - Detyrimet e shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare në lidhje me migrantët dhe të drejtat e tyre të njeriut



Burimi: Migracioni dhe të drejtat e njeriut. Përmirësimi i qasjes bazuar në të drejta të njeriut për migracionin ndërkombëtar<sup>xciii</sup>

## **B.1.2. Instrumentet ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut të migrantëve**

### **B.1.2.a. Traktate të Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut**

**Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948**<sup>xciv</sup> paraqiti një seri gjithëpërfshirëse të parimeve universale të të drejtave të njeriut. Dy Konventat kryesore Ndërkombëtare i shtjelluan këto parime në standarde detyruese normative mbi të drejtat politike dhe civile dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore në vitin 1966. Këto Konventa, së bashku me DUDNJ, shpesh njihen si "E drejta ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut", dhe janë të zbatueshme për të gjitha qeniet njerëzore. Në aspektin juridik, Deklarata Universale është jo-detyruese; megjithatë, ajo zakonisht njihet sot si e drejtë zakonore ndërkombëtare, si norma që kanë marrë mbështetje të gjerë në praktikën e shtetit dhe përgjithësisht njihen nga shtetet si detyrime ligjore detyruese. Dispozitat e traktateve të tjera ndërkombëtare janë detyruese për Shtetet Palë dhe krijojnë detyrime për Shtetet ndaj Konventave përkatëse. Këto instrumente zakonisht ofrojnë mbrojtje të të drejtave të të gjitha qenieve njerëzore pavarësisht nga shtetësia dhe statusi i tyre ligjor.

**Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)**<sup>xcv</sup> përcakton të drejtat civile të të gjithë personave si: e drejta për jetë, liri dhe siguri; e drejta për të mos u mbajtur në skllavëri ose skllavëri; e drejta për të mos u nënshtruar torturave ose trajtimeve ose ndëshkimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese; e drejta për të mos u nënshtruar arrestimit, ndalimit ose internimit arbitrar; e drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje. Neni 2 specifikon që këto të drejtat u njihen pa dallime të çfarëdo lloji, të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, prona, lindja apo statusi tjetër.

**Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR)**<sup>xcvi</sup> garanton të drejtën për të punuar, zgjedhjen e lirë të punës dhe kushtet e drejta dhe të favorshme të punës.

Shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë të drejtën për të krijuar dhe për t'ju bashkuar sindikatave dhe të njohin të drejtën për sigurime shoqërore, përfshirë sigurimin shoqëror, një standard të duhur jetese, standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor, arsimin (e detyrueshëm dhe falas në nivelin fillor), dhe të marrin pjesë në jetën kulturore dhe të përfitojnë nga përparimi shkencor. ICESCR është frymëzues në shumë aspekte, me shtetet palë që zotohen të "të veprojnë, si në mënyrë të vetvetishme ashtu edhe nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos atë ekonomik e teknik, deri në maksimumin e burimeve të veta në dispozicion, për të siguruar progresivisht ushtrimin e plotë të të drejtave të njohura në këtë Pakt me të gjitha mjetet e përshtatshme, duke përfshirë sidomos miratimin e masave legjislative." Në një klauzolë që i referohet posaçërisht jo-shtetasve, ICESCR pranon që "Vendet në zhvillim, duke pasur parasysh, ashtu si duhet, të drejtat e njeriut dhe ekonominë e vet kombëtare, mund të përcaktojnë së në çfarë mase do t'i garantojnë të drejtat ekonomike të njohura në këtë Pakt për ata persona të cilët nuk janë shtetas të tyre"<sup>xcvii</sup> Të gjithë njerëzit nën juridiksionin e Shtetit në fjalë duhet të gëzojnë të drejtat e njohura nga Konventa. Kjo përfshin migrantët - pavarësisht nga statusi ligjor - përfshirë azilkërkuarit dhe refugjatët. Pa paragjykuar mundësinë që Shteti të urdhërojë që ata të largohen nga territori,



vetë prania e migrantëve të tillë [të parregullt] nën juridiksionin e tij i imponon Shtetit detyrime të caktuara.

Përmbajtja thelbësore minimale e secilës të drejtë duhet të ruhet në të gjitha rrethanat për të gjithë njerëzit pa përjashtim.

Detyrimet thelbësore përfshijnë detyrat për të siguruar lirinë nga uria, për të garantuar aksesin tek uji për të përmbushur nevojat themelore, qasjen në barnat thelbësore dhe qasjen në arsim në përputhje me "standardet minimale arsimore". Këto janë të drejta të patjetërsueshme, që do të thotë se ato vazhdojnë të ekzistojnë edhe në situata konflikti, emergjence ose katastrofe natyrore.

### ■ B.1.2.b. Traktate specifike për të drejtat e njeriut

Konventat specifike më pas përcaktuan detyrime të tjera shtesë për shtetet (si bartës të detyrimeve) dhe të drejtat përkuese për njerëzit (bartësit e të drejtave) në fusha të caktuara. Pra, diskriminimit racor është në fokus të Konventës për Eliminimin e Racizmit dhe Diskriminimit Racor (CERD), që ofron kështu mbrojtje ligjore shtesë për viktimat e diskriminimit mbi bazën e racës, përkatësisë etnike ose origjinës kombëtare. E njëjta gjë vlen për Konventën kundër Torturës (CAT), Konventën për Eliminimin e Diskriminimit kundër grave (CEDAW), Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Konventën e OKB-së e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e saj si edhe dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së Tyre (ICRMW).<sup>xcviii</sup>

**Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD)**<sup>xcix</sup> që mbron të gjithë njerëzit brenda juridiksionit të një Shteti nga diskriminimi dhe shfrytëzimi për shkak të racës, ngjyrës, prejardhjes ose origjinës kombëtare apo etnike është gjithashtu veçanërisht e rëndësishme.

**Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)**<sup>c</sup> në nenin 18, u bën thirrje Shteteve Palë të njohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për lirinë e lëvizjes, lirinë për të zgjedhur vendbanimin e tyre dhe për shtetësi, njësoj si të tjerët; neni 11 adreson posaçërisht mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara në situata të rrezikut, përfshirë konfliktin e armatosur, emergjencat humanitare dhe katastrofat natyrore.

Neni 9 i **Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave**<sup>ci</sup> specifikon që Shtetet Palë "ë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit në fushën e marrjes, ndërrimit ose mbajtjes së shtetësisë. Ato veçanërisht garantojnë që as martesë me një të huaj, e as ndërrimi i shtetësisë se burrit gjatë martesës nuk e ndërrojnë automatikisht shtetësinë e gruas, po ashtu nuk e bën atë pa shtetësi dhe nuk e detyron të marrë shtetësinë e burrit. "Ai gjithashtu thotë: "Shtetet palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit për sa i përket shtetësisë së fëmijëve të tyre". (Për më shumë detaje shih Seksionin B.3.1. Gjinia dhe migracioni).

Shtetet Palë në **Konventën e vitit 1984 kundër Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Degradues (CAT)**<sup>cii</sup> mbështesin parimin e "mos-kthimit" të

**personave që rrezikojnë të torturohen në Shtetin në të cilin do të dëbohen, kthehen ose ekstradohen. Ky parim gjendet në nenin 3 të saj.<sup>ciii</sup>**

**Konventa e OKB-së e vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe protokollin e saj<sup>civ</sup>** vendos detyrimin thelbësor ligjor të shteteve për mos-*kthim* (*non refoulement*) në rast persekutimi - shteti nuk duhet të kthejë me detyrim refugjatët në vendet ku ata do të përballen me persekutim. Shtetet nuk kanë detyrimin të ofrojnë azil ose të pranojnë refugjatë për vendosje të përhershme dhe ata mund të zhvendosin refugjatë në vende të treta të sigurta që janë të gatshëm t'i pranojnë ato. Konventa është interpretuar si e tillë që u kërkon Shteteve të përcaktojnë statusin e azilkërkuesve në kufirin e tyre ose brenda territoreve të tyre në mënyrë që të përcaktojnë nëse kërkesa e tyre për mbrojtje refugjati është e bazuar.<sup>cv</sup> Në praktikë, kjo shpesh nënkupton pranimin dhe azilin në vendin pritës për shqyrtimin individual të kërkesës për azil dhe status refugjati. Gjithashtu Konventa siguron që shtetet nuk mund të vendosin sanksione ndaj refugjatëve nëse ata hyjnë ose qëndrojnë në mënyrë të paligjshme, për sa kohë që refugjatët "paraqiten pa vonesë tek autoritetet dhe tregojnë arsye të bazuara për hyrjen ose praninë e tyre të ligjshme" (neni 31). Konventa specifikon dy zgjidhje të qëndrueshme për refugjatët: të kthehen vullnetarisht në vendin e tyre ("riatdhësimi vullnetar") ose të integrohen në vendin ku gjenden ("integrimi lokal").<sup>cvi</sup>

Hartuesit e Konventës pranuan që në mes popullsisë të refugjatëve do të kishte njerëz veprimet e të cilëve i bëjnë të padenjë për mbrojtje ndërkombëtare. Klauzolat e ashtuquajtura të "përjashtimit" të Konventës përcaktojnë dy lloje kryesore të këtyre njerëzve - shkelësit e të drejtave të njeriut dhe kriminelët (Neni 33). Prandaj, ata që kanë kryer një krim kundër paqes, krim lufte, krim kundër njerëzimit, ose krim të rëndë jo-politik përjashtohen nga mbrojtja ndërkombëtare sipas Konventës për Refugjatët. Pra, atyre nuk do t'u jepet statusi i refugjatit dhe përfitimet e që rrjedhin prej tij.<sup>cvi</sup> Sidoqoftë, mos-kthimi sipas konventës kundër torturës (CAT) ende qëndron, duke qenë se është një parim absolut dhe i patjetërsueshëm.

Konventa përcakton gjithashtu të drejtat e refugjatëve që janë pranuar në territorin e një vendi tjetër. Disa të drejta themelore të njeriut si liria e fesë (neni 4) dhe aksesin në gjykata (neni 16) garantohen se janë të paktë ato të drejta që u njihen shtetasve të shtetit pritës të refugjatit. Kështu nëse shtetasve u ofrohet ndihmë juridike, e njëjta gjë duhet t'u jepet refugjatëve (neni 16 (2)). Arsimi fillor u mundësohet gjithashtu refugjatëve njësoj shtetasve (neni 22 (1)). Refugjatëve që banojnë në mënyrë të ligjshme në një vend pritës u garantohen shërbime publike po njësoj (neni 23). Për më tepër, Konventa nuk mund të zbatohet në mënyrë diskriminuese për shkaqe që lidhen me racën, fenë dhe vendin e origjinës (neni 3).

Lidhur me përcaktimin e statusit të refugjatit, Konventa dhe Protokollin nuk japin asnjë të dhënë për procedurat që do të ndiqen për përcaktimin e statusit të refugjatit. I lihet secilit Shtet Kontraktues të vendosë procedurën që e konsideron më të përshtatshme, në përputhje me strukturën e tij të veçantë kushtetuese dhe administrative.<sup>cvi</sup>

**Konventa për të Drejtat e Fëmijëve<sup>cix</sup>** ndalon diskriminimin ndaj çdo fëmije për shkak të statusit të prindërve të tij/saj, duke përfshirë statusin e 'parregullt' (Art. 2 (1)), me të drejtë në shkollim dhe kujdes shëndetësor si fushat e shqetësimit kryesor.<sup>cx</sup> (Shihni me detaje seksionin B.3 të migracionit miqësor ndaj fëmijëve). Bazuar në këtë Konventë dhe në parimin e interesit më të mirë të fëmijës, ndalimi i fëmijëve gjatë imigrimit (vetëm apo me prindërit) konsiderohet në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Secili prej këtyre instrumenteve ka një mekanizëm përmes të cilit shtetet palë raportojnë për përparimin e tyre në zbatimin e standardeve të konventës. Organet e Monitorimit të Traktatit (TMB) para të cilave Shtetet Palë raportojnë janë Komiteti i të Drejtave të Njeriut (i cili monitoron zbatimin e ICCPR), Komiteti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimi ndaj grave, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, Komiteti për Torturën, si edhe Komiteti për mbrojtjen e të drejtave të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, dhe Komiteti për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

### **Protokolli për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht Grave dhe Fëmijëve dhe Protokolli kundër Kontrabandimit të Migrantëve nga toka, deti dhe ajri,**

(Protokollet e Palermos) të cilët të dy plotësojnë Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar hynë në fuqi në dhjetor 2003 dhe janar 2004 përkatësisht. Që nga miratimi i tyre, Protokolli për Trafikimin ka 117 palë nënshkruese dhe 178 shtete palë dhe Protokolli për Kontrabandimin 112 palë nënshkruese dhe 150 shtete palë.<sup>cxix</sup>

Protokolli për Trafikimin kërkon që Shtetet të marrin masa për kriminalizimin dhe ndëshkimin e trafikimit (neni 5), të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje për viktimat e trafikimit (neni 6), të ofrojnë ndihmë për riatdhesim për viktimat e trafikimit (neni 8) dhe të parandalojnë dhe të luftojnë kundër trafikimit (Neni 9).<sup>cxix</sup>

Protokolli në nenin 3 (a) përkufizon trafikimin si: "...rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtypjes, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pushtetit ose pozicionit të cënueshmërisë ose dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi do të përfshijë, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve;" gjithashtu, e konsideron pëlqimin e një viktime të trafikimit të personave për shfrytëzimin e synuar si të parëndësishëm kur janë përdorur ndonjë nga mjetet e përcaktuara në nën paragraf (Neni 3 (b)). Ai gjithashtu i konsideron fëmijët si viktime të trafikimit (Neni 3 (c)) kur vërehet: "Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi". Kjo do të konsiderohet "trafikim i personave" në rastin e fëmijëve, edhe pse nuk përfshin asnjë nga mënyrat e përcaktuara në nën paragrafin (a) të këtij neni".<sup>cxix</sup>

Protokolli i Kontrabandimit kërkon që shtetet të miratojnë masa për të parandaluar dhe kriminalizuar kontrabandimin (neni 7, 8, 11, 15), u kërkon shteteve të ruajnë dhe të mbrojnë të drejtat e migrantëve të cilët janë kontrabanduar (mos penalizimi në nenet 5 dhe 6; neni 16) dhe u kërkon shteteve të lehtësojnë kthimin e migrantëve (neni 18) në përputhje të plotë me parimin e moskthimit (*non-refoulement*). Këto instrumente kërkojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër kontrabandimit dhe trafikimit, një çështje që do të diskutohet më poshtë.

Miratimi i protokolleve të veçanta mbi trafikimin dhe kontrabandimin pasqyron nevojën për të dalluar qartë këto dy aktivitete. Ndërsa migrantët pa dokumente, pranojnë me dëshirë të paguajnë dhe të rrezikojnë të transportohen përmes kufijve për sigurinë e tyre dhe/ose në kërkim të mundësive më të mira të jetës, personat e trafikuar janë viktime të një krimi.

Sidoqoftë, ka disa dallime ndërmjet dy krimeve: çështja e pëlqimit - kontrabandimi i njerëzve gjithmonë përfshin pëlqimin nga personi i kontrabanduar; koncepti i kontrabandimit prezumon interesin e ndërsjellë nga të dy palët, ndërsa, për trafikimin pëlqimi mungon; kontrabandimi përfundon kur klienti kontrabandohet në vendin e dëshiruar, ndërsa në rastin e trafikimit të personave, për shkak të elementit të tij shfrytëzues, është e vështirë të përcaktohet përfundimi i tij; edhe pse kontrabandimi në të gjitha rastet dhe trafikimi në disa raste përfshijnë dëshirën për të migruar në mënyrë të parregullt, <sup>cxiv</sup> trafikimi nuk mund të bëhet kurrë kontrabandim ndërsa kontrabandimi mund të bëhet trafikim. Kjo mund të shpjegohet si: trafikimi në vetvete përcaktohet nga shfrytëzimi si qëllim i tij; me fjalë të tjera, marrëdhënia mes trafikantit dhe viktimës së trafikimit nuk përfundon me momentin e përfundimit të kalimit të parregullt të kufirit; vazhdon në shfrytëzim që mund të zgjasë pa ndonjë kufizim kohor të parashikueshëm. Duke qenë se synimi dhe pëlqimi për t'u kontrabanduar dhe për të kontrabanduar nga të dy palët mund të kthehet lehtësisht në synim pa pëlqimin për të shfrytëzuar personin e kontrabanduar, nuk cilësohet më si kontrabandim, por bëhet trafikim i njerëzve. Prandaj, mund të ketë një bashkim të dy këtyre krimeve. Kjo kërkon përdorim të kujdesshëm të këtyre termave dhe një dallim të kujdesshëm në parandalimin dhe përndjekjen e tyre.

### ■ B.1.2.c. Traktate të tjera në mbrojtje të punëtorëve migrantë

#### • Konventat e ILO-s

Që nga krijimi i tij, ILO ka vendosur që punëtorët migrantë meritojnë vëmendje të veçantë dhe mbrojtja e punëtorëve migrantë është përfshirë në Preambulën e Kushtetutës së ILO-s (recitali i dytë) si një nga fushat ku përmirësimi i kushteve të punës shihet si urgjent:

*"Ndërsa ekzistojnë kushtet e punës që përfshijnë padrejtësi, vështirësi dhe ndalimin e një numri të madh personash që të prodhojnë trazira kaq të mëdha sa që të rrezikohet paqja dhe harmonia e botës; dhe kërkohet urgjentisht një përmirësim i këtyre kushteve; si, për shembull, rregullimi i orëve të punës, sidomos duke vendosur një ditë dhe javë pune maksimale, rregullimi i ofertës së punës, parandalimi i papunësinë, sigurimi i një pagë të duhur për jetesë, mbrojtja e punëtorit kundër sëmundjes, dhe dëmtimit që rrjedhin nga punësimi i tij, mbrojtja e fëmijëve, të rinjve dhe grave, moshës së vjetër nga dëmtimi, mbrojtja e interesave të punëtorëve kur punojnë në vende të ndryshme nga vendi i tyre, njohja e parimit të shpërblimit të barabartë për punë me vlerë të barabartë, njohja e parimit të lirisë së organizimit, organizimi i formimit profesional dhe teknik dhe masa të tjera; [...] [Shtohet theksi]."*

Siç u përmend më lart, në parim, të gjitha standardet ndërkombëtare të punës, përveçse nëse përcaktohet ndryshe, janë të zbatueshme për të gjithë punëtorët migrantë. Këto standarde përfshijnë ato të përcaktuara në tetë konventat e ILO-s mbi të drejtat themelore të identifikuar në Deklaratën e ILO-s të vitit 1998 për Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë. Ato zbatohen për të gjithë punëtorët migrantë, pavarësisht nga statusi i tyre i migracionit.

Dy Konventa të ILO-s veçanërisht të rëndësishme për migracionin dhe që gjithashtu përfaqësojnë një konsensus për migracionin për motive punësimi janë:

Dyzet e dy vende kanë ratifikuar **Konventën për Migracionin për Motive Punësimi** (Rishikuar) (Nr. 97), e cila i detyron Shtetet të sigurojnë informacion falas dhe të saktë për migrantët (neni 2), të parandalojnë propagandë mashtruese (neni 3), të lehtësojnë largimin, udhëtimin dhe pritjen e migrantëve (neni 4), të parandalojnë diskriminimin ndaj migrantëve (neni 6) dhe të lejojnë remitancat (neni 9).<sup>cxv</sup>

Tetëmbëdhjetë vende kanë ratifikuar **Konventën në lidhje me migracionin në kushte abuzive dhe promovimin e barazisë së mundësive dhe trajtimit të punëtorëve migrantë** (nr. 143).<sup>cxvi</sup> Kjo Konventë kërkon që Shtetet të respektojnë të drejtat e njeriut të migrantëve (neni 1), të hetojnë, monitorojnë dhe shtypin trafikimin (neni 2, 3 dhe 6) dhe të ofrojnë barazi të mundësive dhe trajtimit në fushat e punësimit, sigurimeve shoqërore, sindikatave dhe të drejtave kulturore (neni 10).

Konventat e tjera të rëndësishme të ILO-s janë **Konventa në lidhje me Punën e Detyruar ose me Forcë** (Nr. 29),<sup>cxvii</sup> **Konventa për Heqjen e Punës së Detyruar** (Nr. 105),<sup>cxviii</sup> **Konventa për Shpërblim të Barabartë** (Nr. 100)<sup>cxix</sup> dhe **Konventa e Diskriminimit (Punësimi dhe Profesionit)** (Nr. 111).<sup>cxx</sup>

**Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre e OKB,**<sup>cxxi</sup> është ratifikuar deri më sot vetëm nga 56 shtete dhe është nënshkruar nga 12 shtete (duke shënuar shkallë shumë të ulët të ratifikimit), sepse shtetet druhen të krijojnë perceptimin tek shtetasit dhe elektorati i tyre se u japin më shumë të drejta migrantëve, ndërkohë që në realitet kjo konventë vetëm thekson më në detaje të drejtat njerëzore ekzistuese që janë të përcaktuara në instrumente të tjera ndërkombëtare.<sup>cxvii</sup> **Konventa** bazohet në konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, si edhe në instrumentet thelbësore të të drejtave të njeriut, të përmendura më lart.

Kjo konventë riafirmon normat themelore të të drejtave të njeriut dhe i përfshin ato në një instrument të zbatueshëm për punëtorët migrantë dhe familjet e tyre. Qëllimi themelor i Konventës është garantimi i të drejtave minimale për punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë në situatë të rregullt ose të pa dokumentuar / të parregullt.

Konventa është një element themelor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të migrantëve pasi ajo zbatohet në të gjitha aspektet e jetës së migrantëve, përfshirë familjen e migrantëve dhe situatën e grave dhe fëmijëve, dhe një shprehim të drejtat e migrantëve pa dokumente. Një element tjetër pozitiv i Konventës është vizioni i saj i gjerë për të drejtat; megjithëse synon të rregullojë të drejtat e punëtorëve, nuk kufizohet në kontekstin e punësimit, por rregullon të gjithë spektrin e të drejtave të punëtorëve.

Konventa artikulon edhe më gjerësisht parimin e barazisë së trajtimit ndërmjet migrantëve dhe shtetasve para gjykatave dhe tribunaleve, në lidhje me shpërblimin dhe kushtet e tjera të punës, si edhe në lidhje me aksesin e punëtorëve migrantë në ndihmë mjekësore (urgjente) për migrantët e parregullt dhe arsimim për fëmijët e tyre. Në Konventën e Punëtorëve Migrantë (ICRMW), barazia dhe mos-diskriminimi theksohen dhe janë parime transversale për të gjithë migrantët, pavarësisht statusit të tyre ligjor – ashtu si në traktate të tjera të së drejtës dhe në të drejtën zakonore.

Konventa shpreh qartë se të drejtat themelore të artikuluara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe të garantuara në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe traktate të tjera themelore të të drejtave të njeriut që zbatohen për të gjithë migrantët, përfshi edhe punëtorët migrantë.

Pjesa II e Konventës nënvizon zbatimin e parimit të mos-diskriminimit për të gjithë punëtorët migrantë, të cilët gëzojnë të drejtat e "pa dallim të çfarëdo lloji si seksi, race, ngjyre, gjuhe, feje ose bindjeje, politike apo mendimi tjetër, origjine kombëtare, etnike ose shoqërore, kombësie, moshe, gjendjeje ekonomike, prone, gjendjeje civile, lindjeje ose statusi tjetër "(neni 7).

Të drejtat e zbatueshme për të gjithë punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre, përfshirë të drejtat e atyre në një situatë të parregullt, renditen në Pjesën III (Nenet 8 deri 35) dhe përfshijnë lirinë për t'u larguar dhe për të hyrë në çdo shtet, përfshirë shtetin e origjinës (neni 8); e drejta për liri dhe siguri të personit dhe për mbrojtje nga dhuna, dëmtimi fizik, kërcënimet dhe frikësimi, qoftë nga zyrtarë publikë apo nga individë privatë, grupe ose institucione (neni 16); e drejta për barazi me shtetasit e shtetit në fjalë para gjykatave dhe tribunaleve (neni 18); ndalimi i dëbimit kolektiv dhe masat mbrojtëse në procesin e dëbimit (neni 22); e drejta e njohjes kudo si person para ligjit (neni 24); dhe e drejta për informim (neni 33). Të drejtat themelore sociale në lidhje me trajtimin e barabartë me shtetasit për shpërblimin dhe kushtet e tjera të punës dhe kushtet e punësimit (neni 25), sigurimet shoqërore (neni 27), e drejta për kujdes mjekësor (neni 28) dhe arsim (neni 30) mbrohen gjithashtu.

Pjesa IV e Konventës numëron të drejtat më specifike të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjes që janë në një situatë të dokumentuar ose të rregullt, të tilla si ato që adresojnë bashkimin familjar (neni 44) dhe hyrjen në tregun e punës (nenet 52 dhe 53). Pjesa V përmban një sërë dispozitash që kanë të bëjnë me kategori të veçanta të punëtorëve migrantë, të tillë si punëtorët kufitarë, punëtorët stinorë, punëtorët e lidhur me projekte dhe të vetëpunësuarit.

Pjesa VI promovon kushte të qëndrueshme, të drejta, njerëzore dhe të ligjshme në lidhje me migracionin ndërkombëtar të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, dhe përcakton parimet për konsultime dhe bashkëpunim ndërshtetëror për rregullimin e migracionit për motive punësimi.

Që nga 12 gushti 2015, 87 vende dhe territore - dy të tretat e rreth 130 vendeve dhe territoreve për të cilat migracioni ndërkombëtar është një tipar i rëndësishëm - detyrohen nga të paktën një nga këto tre konventa plotësuese. Ndërkohë që ICRMW nuk është ratifikuar ende nga asnjë vend i vetëm me të ardhura të larta, 11 Shtete Anëtare të BE-së (midis tyre shumica e vendeve më të mëdha të destinacionit të migrantëve), Izraeli, Norvegjia dhe Zelanda e Re kanë ratifikuar një ose të dyja konventat e ILO-së mbi punëtorët migrantë.

#### **Kutia 16. Të drejtat e migrantëve të mbrojtura nga Konventa ICRMW**

Neni 10 ndalon torturën ose trajtimin apo ndëshkimin mizore, çnjerëzor ose degradues.

Neni 11 ndalon skllavërinë ose robërinë dhe punën e detyruar ose të detyrueshme.

Neni 12 parashikon lirinë e mendimit, fesë dhe ndërgjegjes

Neni 13 parashikon të drejtën e shprehjes.

Neni 14 ndalon ndërhyrjet arbitrare ose të paligjshme në jetën private ose sulmet ndaj nderit dhe reputacionit.

Neni 15 ndalon mohimin arbitrar të pasurisë.

Neni 16 i jep të drejtën migrantëve "për mbrojtje efektive nga Shteti kundër dhunës, dëmtimit fizik, kërcënimeve dhe frikësimit, qoftë nga nëpunës publikë apo nga individë privatë, grupe ose institucione". Nenet 17 deri 21 kanë të bëjnë me të drejtat e migrantëve që janë ndaluar nga autoritetet shtetërore për imigracion dhe vepra penale.

Neni 22 ndalon dëbimin kolektiv dhe përcakton të drejtat e migrantëve në procedurat e dëbimit. Neni 23 parashikon të drejtën e të gjithë migrantëve për të kërkuar mbrojtjen dhe ndihmën e nëpunësve konsullorë ose diplomatikë të vendeve të tyre të origjinës.

Neni 25 i jep të drejtë të gjithë punëtorëve migrantë të "gëzojnë trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u ofrohet shtetasve të shtetit të punësimit në lidhje me shpërbllimin" dhe kushtet e tjera të punës.

Neni 26 ka të bëjë me të drejtën për t'u bashkuar me sindikatat.

Neni 27, në lidhje me sigurimet shoqërore, pranon që Shtetet mund të kufizojnë përfitimet për punëtorët migrantë, por inkurajon Shtetet "të shqyrtojnë mundësinë e rimbursimit të personave të interesuar në shumën e kontributeve të bëra prej tyre në lidhje me atë përfitim në bazë të trajtimit që i bëhet shtetasve të cilët janë në rrethana të ngjashme".

Neni 28 përcakton të drejtën e migrantëve dhe familjeve të tyre për kujdes shëndetësor "që kërkohet urgjentisht për ruajtjen e jetës së tyre ose shmangien e dëmtimit të pariparueshëm të shëndetit të tyre", si edhe trajtimin shëndetësor kurues, duke specifikuar që kujdesi mjekësor urgjent nuk duhet t'u refuzohet atyre në status të parregullt.

Neni 29 diskuton të drejtat e fëmijëve të migrantëve për emër, regjistrim të lindjes dhe shtetësi.

Neni 30 parashikon të drejtën për arsimin bazë, mbi baza të barabarta me shtetasit për migrantët e rregullt, dhe gjithashtu parashikon të drejtën e arsimit bazë që nuk mund të mohohet për shkak të statusit të parregullt të fëmijës ose prindërve të tij.

Neni 31 mbron identitetin kulturor të migrantëve dhe anëtarëve të familjes së tyre.

## **B.2. Legjislacioni dhe politika rajonale për migracionin**

### **B.2.1. Legjislacioni dhe politika rajonale për migracionin**

**Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>cxxiii</sup> edhe pse nuk merret në mënyrë specifike me migrantët** ofron një grup të përgjithshëm të të drejtave të njeriut që zbatohen edhe për migrantët. Mbrojtja që u jepet migrantëve përmes kësaj konvente është zhvilluar më tej përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Praktika gjyqësore ka të bëjë me disa fusha të mbrojtjes së të drejtave të migrantëve si: Hyrja në territor dhe procedurat (*Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë*),<sup>cxxiv</sup> hyrja në territorin e shtetit të paditur (*Thimothawes kundër Belgjikës dhe Abdi Mahamud kundër Maltës*),<sup>cxxv</sup> çështjet në lidhje me dwbimin e paligjshëm (*Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*),<sup>cxxvi</sup> çështjet në lidhje me dëbimin kolektiv (*Hirsi Jamaa e të tjerë kundër Italisë*),<sup>cxxvii</sup> çështje që lidhen me parimin e moskthimit (*N.D. dhe N.T kundër Spanjës*),<sup>cxxviii</sup> çështjet në lidhje me situatat para largimit dhe me largimin e migrantëve (*A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*),<sup>cxxix</sup> çështjet që konsiderojnë shtetësinë (*Hoti kundër Kroacisë*)<sup>cxxx</sup> e shumë të tjerë.

**Tre instrumente të tjerë specifikë në lidhje me mbrojtjen e migrantëve janë** miratuar nën kujdesin e Këshillit të Evropës, i cili përfshin 47 Shtete Anëtare.

**Karta Sociale Evropiane<sup>cxxxi</sup>** e miratuar në vitin 1961 dhe e rishikuar në vitin 1996, përmban nenin 18 për "të drejtën për t'u angazhuar në një profesion fitimprurës në territorin e palëve të tjera kontraktuese" dhe nenin 19 për "të drejtën e punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë", që zbatohen për punëtorët migrantë në mënyrë të ligjshme brenda vendeve në fjalë. Një sërë dispozitash të tjera në Kartë, në lidhje me ofrimin e kujdesit mjekësor, sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjen e të rinjve, janë gjithashtu me rëndësi të veçantë për migrantët.

**Konventa Evropiane e KiE mbi Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë<sup>cxxxi</sup>** e miratuar në vitin 1977 bazohet në premisën që "statusi ligjor i punëtorëve migrantë që janë shtetas të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës duhet të rregullohet në mënyrë që të sigurojë që sa më shumë të jetë e mundur ata të trajtohen në mënyrë jo më pak favorizuese se punëtorët që janë shtetas të Shtetit pritës në të gjitha aspektet e kushteve të jetesës dhe të punës "(Preambula).

**Konventa e KiE mbi pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivelin vendor<sup>cxxxi</sup>** synon të përmirësojë integrimin e banorëve të huajve në jetën e komunitetit. Zbatohet për të gjithë personat që nuk janë shtetas të Shtetit Palë dhe që janë banorë me qëndrim rregullt territorin e tij.

Konventa parashikon që Palët marrin përsipër t'u garantojnë banorëve të huaj, me të njëjtat kushte si për shtetasit e tyre, "të drejtat klasike" të lirisë së shprehjes, tubimit dhe organizimit, përfshirë të drejtën për të krijuar sindikata. Gjithashtu, Palët do të bëjnë përpjekje për të përfshirë banorët e huaj në proceset e konsultimit për çështjet vendore. Sipas disa kushteve të parashikuara me ligji, të drejtat e lirisë së shprehjes dhe tubimit mund të kufizohen.

**Konventa e KiE mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore<sup>cxxxiv</sup>** u miratua nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës më 3 maj 2005. Konventa hyri në fuqi më 1 shkurt



2008, pas ratifikimit të saj të 10-të. Bazuar në instrumentet ekzistuese ndërkombëtare, Konventa shkon përtej standardeve minimale të rëna dakord në to dhe forcon mbrojtjen që u ofrohet viktimave. Konventa ka një fushë gjithëpërfshirëse zbatimi, duke përfshirë të gjitha format e trafikimit (qoftë kombëtar ose ndërkombëtar, të lidhur ose jo me krimin e organizuar) dhe të gjithë personat që janë viktimë të trafikimit (gra, burra ose fëmijë). Format e shfrytëzimit që mbulon Konventa janë, minimalisht, shfrytëzimi seksual, puna ose shërbimet e detyruara, skllavëria ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, robëria dhe heqjen e organeve. Vlera kryesore e shtuar e Konventës është perspektiva e të drejtave të njeriut dhe fokusi në mbrojtjen e viktimave. Preambula e saj përkufizon trafikimin e qenieve njerëzore si shkelje e të drejtave të njeriut dhe shkelje e dinjitetit dhe integritetit të qenies njerëzore. Konventa parashikon një sërë të drejtash për viktimat e trafikimit, në veçanti të drejtën për t'u identifikuar si viktimë, për t'u mbrojtur dhe asistuar, për të pasur një periudhë rikuperimi dhe reflektimi prej të paktën 30 ditësh, për të marrë leje qëndrimi të rinovueshme, dhe për të marrë kompensim për dëmet e pësuar.

Gjithashtu një sërë masash jo-detyruese janë miratuar nën kujdesin e Këshillit të Evropës, sidomos nga Asambleja Parlamentare, e cila është një organ i përbërë nga parlamentarë nga Shtetet Anëtare që ka një Komitet për Migracionin, Refugjatët dhe Personat e Shpërngulur. Asambleja Parlamentare ka miratuar një sërë masash për të drejtat e njeriut të migrantëve, veçanërisht **Rezoluta 1509 (2006) mbi të drejtat e njeriut të migrantëve të parregullt, e cila numëron një grup minimal të të drejtave të njeriut të zbatueshme për këtë grup migrantësh.**<sup>cxxxv</sup> Kjo rezolutë e pranon që ka një numër gjithnjë në rritje të migrantëve të parregullt në Evropë, se secili shtet anëtar i Këshillit të Evropës ka të drejtë të rregullojë hyrjen e shtetasve të huaj dhe të kthejë migrantë të parregullt në vendin e tyre të origjinës në përputhje me ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të migrantëve të parregullt.

#### **Kutia 17. Të drejta civile dhe politike sipas Rezolutës 1509 (të përzgjedhura)**

Të drejtat minimale të mëposhtme meritojnë të theksohen:

- ✓ E drejta për të jetuar duhet të gëzohet dhe të respektohet. Forca e paarsyeshme nuk duhet të përdoret për të parandaluar hyrjen e jo-shtetasve në një vend. Autoritetet kanë për detyrë që të përpiqen të shpëtojnë ata, jeta e të cilëve mund të jetë në rrezik në përpyetje për të hyrë në një vend;
- ✓ Migrantët e parregullt duhet të mbrohen nga tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi çnjerëzor ose degradues. Procesi i kthimit të migrantëve të parregullt duhet të kryhet duke respektuar plotësisht të drejtën e dinjitetit të të kthyerve, duke marrë parasysh, ndër të tjera, moshën e tyre, seksin, gjendjen shëndetësore dhe aftësitë e kufizuara eventuale. Masat shtrënguese gjatë dëbimit duhet të mbahen në minimumin absolut;
- ✓ Migrantët e parregullt duhet të mbrohen nga skllavëria dhe puna e detyruar, dhe viktimave të trafikimit duhet t'u jepen të drejta specifike në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore ndalimi i migrantëve të parregullt duhet të përdoret vetëm si një mundësi e fundit dhe jo për një periudhë të zgjatur kohe.
- ✓ Kur është e nevojshme, migrantët e parregullt duhet të mbahen në ambiente të veçanta ndalimi dhe veçmas nga të burgosurit e dënuar. Fëmijët duhet të ndalohen vetëm si masë e fundit dhe më pas për një periudhë sa më të shkurtër të mundshme.<sup>cxxxvi</sup> Ndalimi ose mbajtja e personave të tjerë të pambrojtur (gratë shtatzëna, nënat me fëmijë të vegjël, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara) duhet të shmangët kur

është e mundur. Akomodim i përshtatshëm duhet të ofrohet për familjet, por përndryshe burrat dhe gratë duhet të akomodohen veçmas. Të ndaluarit duhet të kenë të drejtën të kontaktojnë këdo që zgjedhin vetë (avokatët, anëtarët e familjes, OJQ-të, UNHCR, etj.), të marrin kujdesin e duhur mjekësor dhe të kenë një përkthyes dhe ndihmë juridike falas kur është e përshtatshme;

- ✓ Duhet të respektohet e drejta për azil dhe mos-kthim;
- ✓ Një migrant i parregullt që largohet nga vendi ka të drejtën t'i drejtohet në mënyrë efektive Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut duke paraqitur një kërkesë individuale në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ✓ Duhet të respektohet e drejta për jetën private dhe familjare. Largimi nuk duhet të ndodhë kur personi i parregullt në fjalë ka lidhje veçanërisht të forta familjare ose shoqërore me vendin që kërkon ta largojë atë dhe kur largimi ka të ngjarë të çojë në përfundimin se dëbimi do të cenonte të drejtën për jetën private dhe / ose familjare të personit në fjalë.

## **B.2.2. Legjislacioni dhe politika e BE-së për migracionin**

Politika dhe legjislacioni i BE-së për migracionin janë zhvilluar rreth disa fushave kryesore midis të cilave:

- Politika dhe Legjislacioni për Azilin
- Politika dhe Legjislacioni për imigracionin
- Menaxhimi i kufijve të jashtëm

### **• Politika dhe Legjislacioni për Azilin**

- Nenet 67 (2), 78 dhe 80 të Traktatit për Funkcionimin e BE-së;<sup>cxxxvi</sup>
- Neni 18 i Kartës të të Drejtave Themelore
- Traktati i Lisbonës 2009, i cili hyri në fuqi në dhjetor 2009,<sup>cxxxviii</sup> ndryshoi situatën duke transformuar masat mbi azilin nga krijimi e standardeve minimale në krijimin e një sistemi të përbashkët që përfshin status uniform dhe procedura uniforme.

Ky sistem i përbashkët duhet të përfshijë:

- Një status uniform të azilit;
- Një status uniform të mbrojtjes plotësuese;
- Një sistem të përbashkët të mbrojtjes së përkohshme;
- Procedurat e zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e azilit uniform ose statusit të mbrojtjes plotësuese;
- Kriteret dhe mekanizmat për të përcaktuar se cili shtet anëtar është përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë;
- Standardet në lidhje me kushtet e pritjes;
- Partneritet dhe bashkëpunim me vendet e treta.

### ➤ **Direktivat në lidhje me azilin**

**Direktiva për Procedurat e Azilit (e rishikuar)**<sup>cxxxix</sup> synon të krijojë një sistem koherent për të siguruar që vendimet për kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare të merren në mënyrë efektive dhe të drejtë, ndërsa:

- përcakton rregulla të qarta për regjistrimin dhe depozitimin e kërkesave, duke u siguruar që të gjithë ata që dëshirojnë të kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare mund ta bëjnë shpejt dhe në mënyrë efektive
- cakton një afat kohor për shqyrtimin e kërkesave (në parim gjashtë muaj në fazën administrative), ndërsa parashikon mundësinë e përsheptimit për kërkesa që mund të jenë të pabazuara ose të bëra me keqbesim
- lejon koncepte për procedurat kufitare dhe vendet e sigurta (përcakton rregulla të qarta për verifikimin e pranueshmërisë dhe për zbatimin e koncepteve të shtetit të tretë të sigurtë dhe vendit të parë të azilit, përcaktimi kombëtar i vendeve të treta si vende të sigurta të origjinës, konceptin e vendit të tretë dhe konceptin e vendit të sigurt Evropian).
- trajnon vendimmarrësit dhe ofron mundësinë për ndihmë juridike
- ofron mbështetjen e duhur për ata që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë - për shembull për shkak të moshës së tyre, paaftësisë, sëmundjes – sidomos siguron që atyre t'u lihet koha e mjaftueshme për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurë.
- parashikon rregulla për të drejtën e qëndrimit dhe ankimimet para gjykatave ose tribunaleve.

**Direktiva 2001/55 /KE e 20 korrikut 2001 mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rast të një fluksi masiv të personave të shpërngulur dhe për masat** promovon një ekuilibër të përpjekjeve ndërmjet Shteteve Anëtare për pritjen e këtyre personave dhe për mbajtjen e pasojave të saj dhe u hartua si një kornizë për menaxhimin e fluksit masiv të papritur të personave të zhvendosur dhe për t'i dhënë atyre mbrojtje të menjëhershme.<sup>cxl</sup>

#### **Kutia 18. Rregullorja e Dublinit e Bashkimit Evropian<sup>cxli</sup>**

Rregullorja e Dublinit III hyri në fuqi në korrik 2013. Rregullorja e Dublinit përcakton se cili shtet anëtar i BE-së është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për azil të një azilkërkuesi. Rregullorja krijon një bazë të dhënash për gjurmët e gishtërinjve të azilkërkuesve, të quajtur EURODAC. Azilkërkuesit duhet të aplikojnë për azil në vendin e parë të BE-së ku arrijnë dhe ku u merren shenjat e gishtërinjve. Azilkërkuesit mund të kthehen në një shtet tjetër anëtar të BE-së nëse mund të provohet se ata ose kanë hyrë në BE (nga ajri, deti ose toka) ose kanë bërë një kërkesë për azil në atë shtet tjetër. Territori i Rregullores së Dublinit u shtri në disa vende jo të BE-së si Norvegjia, Islanda dhe Zvicra. Ky sistem vë në tension të madh disa vende të BE-së, të cilat gjeografikisht ka më shumë të ngjarë të jenë vendi i hyrjes së parë për azilkërkuesit (si Greqia, Italia, Spanja, etj.).

Elementet kryesore të Rregullores aktuale të Dublinit:

- një mekanizëm i paralajmërimit të hershëm, gjendjes së gatishmërisë dhe menaxhimit të krizave, i orientuar drejt adresimit të shkaqeve themelore disfunktionale të sistemeve kombëtare të azilit ose problemeve që burojnë nga presione të veçanta,
- një sërë dispozitash për mbrojtjen e aplikantëve, të tilla si intervista e detyrueshme personale, garancitë për fëmijët migrantë (përfshirë një përkrahje të hollësishme të faktorëve që duhet të jenë në themel të vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijës) dhe mundësitë e zgjeruara të ribashkimit të tyre me të afërmit e tyre,

- mundësia që ankimimet të pezullojnë ekzekutimin e transferimit për periudhën kur e ankimimit në pritje, së bashku me garantimin e të drejtës që një person të qëndrojë në territor në pritje të vendimit të gjykatës për pezullimin e transferimit në pritje të ankimimit,
- detyrimin për të ofruar ndihmë juridike falas sipas kërkesës,
- një shkak të vetëm për ndalim në rast rreziku të ikjes; kufizim i rreptë i kohëzgjatjes së ndalimit,
- mundësia që azilkërkuesit të cilët në disa raste mund të konsiderohen migrantë të parregullt dhe të kthehen sipas Direktivës së Kthimit, të trajtohen sipas procedurës së Dublinit - duke u dhënë kështu këtyre personave më shumë mbrojtje se Direktiva e Kthimit,
- detyrimin për të garantuar të drejtën e ankimimit të një vendimi transferimi përpara një gjykate dhe qartësi më të madhe ligjore të procedurave midis Shteteve Anëtare - p.sh. afate shteruese dhe më të qarta.

E gjithë procedura e Dublinit nuk mund të zgjasë më shumë se 11 muaj për të marrë në ngarkim një person, ose 9 muaj për ta kthyer atë (me përjashtim të arratisjes, ose kur personi është i ndaluar). **Rishikimi 20 i Rregullores Dublin III i referohet parimit bazë që një person nuk duhet të mbahet i ndaluar për arsyen e vetme se kërkon mbrojtje ndërkombëtare.**

**Do të konsiderohet e përshtatshme që të ndalohej një individ për të siguruar transferimin në një shtet tjetër të Dublinit kur paraqet 'një rrezik domethënës për t'u arratisur'. Më 15 Mars 2017 Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian pohoi në çështjen C-528/15 Al Chodor<sup>cxlii</sup> që ekzistenca e praktikës gjyqësore që konfirmon praktikën e qëndrueshme administrative nga autoritetet kombëtare në lidhje me kriteret për një 'rrezik domethënës të arratisjes' nuk ishte e mjaftueshme për të përmbushur nenin 28. Gjykata vendosi që kriteret objektive për të përcaktuar një 'rrezik të arratisjes' duhet të përcaktohen në një dispozitë detyruese e ligjit kombëtar. Kur merret parasysh nëse do të ndalohej ose jo një individ në mënyrë që të sigurohet transferimi sipas Dublinit, duhet të zbatohen dispozitat në Rregulloret e Transferimit për Përcaktimin e një Kërkese për Mbrojtje Ndërkombëtare (Ndalim) (Kriteret për Rrezik të Rëndësishëm për Arratisje) e vitit 2017.**

Më 23 shtator 2020, Komisioni Evropian prezantoi **Paktin e Ri mbi Migracionin dhe Azilin<sup>cxliii</sup>** pas konsultimeve me Parlamentin Evropian, Shtetet Anëtare dhe palë të ndryshme të interesit. Pakti i Ri përfshin të gjithë elementët e ndryshëm të nevojshëm për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj migracionit. Në veçanti, Pakti i Ri pranon që asnjë Shtet Anëtar nuk duhet të marrë përsipër një përgjegjësi disproporcionale dhe që të gjitha Shtetet Anëtare duhet të kontribuojnë për solidaritet në baza të vazhdueshme.

- **Politika dhe Legjislacioni për imigracionin**

- Neni 78 dhe 80 të traktatit për funksionimin e BE-së
- Direktivat në lidhje me imigracionin

Që nga viti 2008, një sërë direktivash të rëndësishme për imigracionin janë miratuar dhe disa janë rishikuar tashmë.

1. Migracioni i rregullt

Pas vështirësive të hasura në miratimin e një dispozite të përgjithshme që mbulon të gjithë imigracionin për motive punësimi në BE, qasja aktuale konsiston në miratimin e legjislacionit sektorial, sipas kategorisë së migrantëve, me qëllim krijimin e një politike të rregullt të imigracionit në nivelin e BE-së.

**Direktiva 2009/50 / EC mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime të punësimit shumë të kualifikuar krijoi “kartën blu të BE-së”,** një procedurë e shpejtë për dhënien e një leje të veçantë qëndrimi dhe pune në kushte më tërheqëse, t'u mundësojë punëtorëve të vendeve të treta fillimin e një pune shumë të kualifikuar në Shtetet Anëtare.<sup>cxliv</sup>

#### **Kutia 19. Direktiva e Kartës Blu<sup>cxliv</sup>**

Kjo direktivë ka për qëllim të kontribuojë në arritjen e këtyre qëllimeve dhe të adresojë mungesat e fuqisë punëtore duke nxitur pranimin dhe lëvizshmërinë - për qëllime të punësimit shumë të kualifikuar - të shtetasve të vendeve të treta për qëndrime më shumë se tre muaj, në mënyrë që të bëjë Komunitetin më tërheqës për punëtorë të tillë nga e gjithë bota dhe për të mbështetur konkurrencën e saj dhe rritjen ekonomike. Për të arritur këto qëllime, është e nevojshme të lehtësohet pranimi i punëtorëve shumë të kualifikuar dhe familjeve të tyre duke krijuar një procedurë të shpejtë të pranimit dhe duke u dhënë atyre të drejta të barabarta sociale dhe ekonomike si shtetas të Shtetit Anëtar pritës në një sërë fushash. Gjithashtu është e nevojshme të merren parasysh përparësitë, nevojat e tregut të punës dhe kapacitetet pritëse të Shteteve Anëtare. Kjo Direktivë duhet të mos cenojë kompetencën e Shteteve Anëtare për të mbajtur ose për të prezantuar leje të reja kombëtare qëndrimi për ndonjë motiv punësimi. Shtetasit e vendeve të treta në fjalë duhet të kenë mundësinë të aplikojnë për një Kartë Blu të BE-së ose për një leje qëndrimi kombëtare. Për më tepër, kjo Direktivë nuk duhet të ndikojë në mundësinë që një mbajtës i Kartës Blu të BE-së të gëzojë të drejta dhe përfitime shtesë që mund të sigurohen nga legjislacioni kombëtar dhe që janë në përputhje me këtë Direktivë.

**Direktiva e Lejes Unike (2011/98/BE)** përcakton një procedurë të përbashkët, të thjeshtuar për shtetasit e vendeve të treta që aplikojnë për një leje qëndrimi dhe pune në një Shtet Anëtar, si dhe një grup të përbashkët të të drejtave që duhet t'u jepen imigrantëve të rregullt. Ai përmban dispozita për një procedurë të vetme aplikimi që çon në një titull të kombinuar që përfshin lejet e qëndrimit dhe të punës brenda një akti të vetëm administrativ duke kontribuar në thjeshtimin dhe harmonizimin e rregullave të zbatueshme aktualisht në Shtetet Anëtare. Ky thjeshtim procedural është prezantuar tashmë nga disa Shtete Anëtare dhe ka krijuar një procedurë më efikase si për migrantët ashtu edhe për punëdhënësit e tyre, dhe ka mundësuar kontrolle më të lehta të ligjshmërisë së vendbanimit dhe punësimit të tyre. Kështu, në mënyrë që të lejohet hyrja fillestare në territorin e tyre, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të japin një leje të vetme ose, nëse lëshojnë leje të vetme vetëm pas hyrjes, ato duhet të japin vetëm një vizë. Shtetet Anëtare duhet të japin leje të vetme ose viza të vetme në kohën e duhur.<sup>cxlv</sup>

**Direktiva 2014/36 / BE, e miratuar në shkurt 2014, rregullon kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllimet e punësimit si punëtorë stinorë.** Punëtorëve migrantë stinorë u lejohet të qëndrojnë ligjërisht dhe përkohësisht në BE për një periudhë maksimale ndërmjet pesë dhe nëntë muaj (në varësi të Shtetit Anëtar) për të kryer

një veprimtari që varet nga stinët, duke ruajtur vendbanimin e tyre kryesor në një vend të tretë. Gjithashtu Direktiva sqaron tërësinë e të drejtave të cilat i gëzojnë këta punëtorë migrantë.<sup>cxlvi</sup> Direktiva e Punëtorëve Stinorë është e zbatueshme për shtetasit e vendeve të treta që banojnë jashtë BE-së në kohën e aplikimit për vizë, të cilët dëshirojnë të qëndrojnë përkohësisht në një Shtet Anëtar të BE-së për të filluar punë stinore në atë Shtet Anëtar - me punën stinore që përcaktohet në Direktivë si një aktivitet që lidhet me një periudhë të caktuar të vitit nga një ngjarje ose model i përsëritur i ngjarjeve të lidhura me kushtet sezonale.<sup>cxlviii</sup>

**Direktiva (BE) 2016/801 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime kërkimi, studimi, trajnimi, shërbimi vullnetar, skeme të shkëmbimit të nxënësve ose projekti arsimor dhe *au pair* u miratua në 11 maj 2016.**<sup>cxlix</sup>

Në fund, **statusi i shtetasve të vendeve të treta që janë banorë afatgjatë në Bashkimin Evropian rregullohet akoma nga Direktiva e Këshillit 2003/109 /KE, e ndryshuar në 2011 për të shtrirë fushën e saj të veprimit për refugjatët dhe përfituesit e tjerë të mbrojtjes ndërkombëtare.** Raporti i zbatimit i marsit 2019 tregoi se, në vend që të promovimit në mënyrë aktive të statusit të qëndrimit afatgjatë Evropian, Shtetet Anëtare duhet të japin kryesisht leje kombëtare për qëndrim afatgjatë.<sup>cl</sup>

## 2. Integrimi

**Direktiva e Këshillit 2003/86 /KE që përcakton dispozitat mbi të drejtën e bashkimit familjar**<sup>cli</sup> dhe njih ekzistencën e të drejtë për bashkim familjar. Vendos një detyrim pozitiv mbi Shtetet Anëtare, duke i kërkuar atyre në rastet e përcaktuara nga Direktiva që të autorizojnë bashkimin familjar të anëtarëve të caktuar të familjes së sponsorit dhe duke mos u lënë liri veprimi në këtë drejtim.

### **Kutia 20. Bashkimi familjar dhe integrimi në BE**<sup>clii</sup>

Në shumë shtete anëtare, bashkimi familjar përbën një pjesë të madhe të migracionit të rregullt. Në vitin 2008, Komisioni publikoi Raportin e tij të parë mbi zbatimin e Direktivës, duke nënvizuar zgjedhjet e ndryshme të politikave të ndjekura nga Shtetet Anëtare se si të menaxhojnë në mënyrë të efektshme fluksin e madh të migrantëve për arsye të bashkimit familjar. Në vitet e fundit, shumë Shtete Anëtare kanë prezantuar ose rishikuar në veçanti rregullat e bashkimit familjar për refugjatët (dhe gjithashtu për përfituesit e mbrojtjes plotësuese, të cilët janë të përjashtuar nga fushëveprimi i Direktivës). Pavarësisht sfidave të fundit migratore dhe numrit të lartë të aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare, përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare kanë vazhduar të përfitojnë nga rregullat më të favorshme të bashkimit të familjes krahasuar me kategoritë e tjera të shtetasve të vendeve të treta dhe përfituesit e mbrojtjes plotësuese përfitojnë në përgjithësi nga një nivel i ngjashëm i mbrojtjes të siguruar ligjërisht si refugjatë.<sup>cliii</sup>

Kompetenca e BE-së në fushën e integritimit është e kufizuar. Në korrik 2011, Komisioni miratoi Agjendën Evropiane për Integrimin e Shtetasve të Vendeve të Treta.<sup>cliv</sup> Kohët e fundit, në qershor 2016, Komisioni paraqiti një plan veprimi, që përcaktonte një kuadër politik dhe hapa praktikë për të ndihmuar Shtetet Anëtare që të integrojnë 20 milion shtetas jo të BE-së që janë banorë me qëndrim të rregullt në BE. Instrumentet ekzistuese përfshijnë Forumin Evropian për Migracionin; Faqja e Internetit për Integrimin; dhe Rrjeti Evropian i Integritimit.

### 3. Imigracioni i Parregullt

BE ka miratuar disa pjesë kryesore të legjislacionit për të luftuar imigracionin e parregullt:

**Direktiva e Këshillit 2002/90/KE**, përcakton një përkufizim të përbashkët të krimit të lehtësimit të hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar dhe **Vendimi Kuadër 2002/946 /DPB, që vendos sanksione penale për këtë sjellje.**<sup>clv</sup>

**Trafikimi adresohet nga Direktiva 2011/36 /BE mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij.** Paketa plotësohet me Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, që parashikon dhënien e një leje qëndrimi për personat e trafikuar ose të kontrabanduar të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente.<sup>clvi</sup> Direktiva merr një qasje të përqendruar te viktima, duke përfshirë një perspektivë gjinore, për të mbuluar masa në fusha të ndryshme siç janë: dispozitat e ligjit penal, ndjekja penale e shkelësve të ligjit, mbështetja e viktimave dhe të drejtat e viktimave në proceset penale, parandalimi dhe monitorimi i zbatimit.

**Direktiva e Kthimit '(2008/115 / KE) përcakton standardet dhe procedurat e përbashkëta të BE-së për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt.**<sup>clvii</sup> Në shtator 2018, Komisioni propozoi një rishikim të synuar të Direktivës së Kthimit, duke përfshirë një procedurë të re kufi për aplikantët për azil, procedura dhe rregulla më të qarta për të parandaluar abuzimet, krijimin e programeve efikase të kthimit vullnetar në Shtetet Anëtare dhe rregulla më të qarta për ndalimin. Me fjale të tjera Direktiva e ndryshuar që është në proces negociimi është një 'rishikim i targetuar' që synon të përshpejtojë procedurat e kthimit, të krijojë më shumë lidhje ndërmjet procedurave të azilit dhe kthimit dhe të ulë rrezikun e arratisjes, duke mbrojtur të drejtat themelore të njeriut.

#### **Kutia 21. Direktiva e kthimit**<sup>clviii</sup>

Çështjet e mëposhtme janë disa aspekte kritike të Direktivës së Kthimit:

Direktiva përcakton se ndalimi për qëllimin e largimit do të përdoret vetëm nëse masa të tjera të mjaftueshme, por më pak shtrënguese nuk mund të zbatohen në mënyrë efektive në një rast specifik, veçanërisht kur ekziston rreziku i arratisjes, ose personi fjalë shmang ose pengon përgatitjen e kthimit ose procesin i largimit. Një nga aspektet më të debatuar të Direktivës së Kthimit ka të bëjë me ndalimin e shtetasve të vendeve të treta sipas urdhrit për kthim. Duhet të theksohet se, me dispozitat e prezantuara nga Direktiva e Kthimit, në veçanti masa që vendos një afat kohor të ndalimit prej 6 muajsh, i cili mund të zgjatet përjashtimisht në maksimumi 18 muaj ndaj migrantëve është bërë kryesisht një pjesë sistematike e menaxhimit të migracionit në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së - edhe pse duhet përdorur si alternativë e fundit sipas të drejtës rajonale/Evropiane. Si pjesë e zbatimit të Direktivës, 11 Shtete Anëtare kanë zbatuar kufirin maksimal të ndalimit prej 18 muajsh dhe dhjetë Shtete Anëtare kanë zgjatur afatet maksimale të ligjshme të ndalimit.<sup>clix</sup>

**Direktiva 2009/52/KE specifikon sanksionet dhe masat që do të zbatohen në Shtetet Anëtare kundër punëdhënësve të shtetasve të parregullt të vendeve të treta.**<sup>clx</sup>

Që nga viti 2001, Shtetet Anëtare kanë njohur reciprokisht **vendimet e tyre përkatëse të dëbimit (Direktiva 2001/40)**, sipas të cilave respektohet dhe zbatohet një vendim nga një

Shtet Anëtar për të dëbuar një shtetas jo-anëtar të BE-së të pranishëm në një shtet tjetër anëtar.<sup>clxi</sup>

- **Menaxhimi i kufijve të jashtëm, politika dhe legjislacioni**

- Neni 3.2 i Traktatit për BE-në;
- Nenet 67 dhe 77 të traktatit për funksionimin e BE-së;
- Acquis për kufijtë e jashtëm të Shengen-it;

Marrëveshjet e Shengen (1985, 1990) parashikojnë lëvizje të lirë dhe udhëtime të pakufizuara për shtetasit e shteteve të Shengen (aktualisht përfshijnë 22 shtete anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe Islandën, Norvegjinë, Lihtenshtajnin dhe Zvicrën), të cilët mund të jetojnë, të studiojnë ose të punojnë kudo që dëshirojnë në ato shtete.<sup>clxii</sup>

Të jesh pjesë e zonës pa kontrolle të kufirit të brendshëm do të thotë që këto vende:

- të mos kryejnë kontrolle kufitare në kufijtë e tyre të brendshëm (d.m.th. kufijtë mes dy shteteve Shengen);
- të kryejnë kontrolle të harmonizuara, bazuar në kritere të përcaktuara qartë, në kufijtë e tyre të jashtëm (d.m.th. kufijtë mes një shteti Shengen dhe një shteti jo Shengen).

Për rrjedhojë, shtetasit e BE-së dhe shtetasit e atyre vendeve që janë pjesë e zonës Shengen, dhe pjesëtarët e familjeve të tyre, kanë të drejtë të hyjnë në territorin e Shteteve Anëtare të BE pa autorizim paraprak nëse përmbushin kërkesat e Kodit Kufitar Shengen (Neni 6). Ata mund të përjashtohen mbi bazën e politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik. Sipas ligjit evropian, shtetasit nga vendet e renditura në Shtojcën 1 të Rregullores së Listës së Vizave (Rregullorja (EU) 2018/1806, e ndryshuar) mund të hyjnë në territorin e BE me vizë të lëshuar përpara hyrjes.



### **B.3. E ardhmja në qeverisjen e migracionit: Pakti Global për Migracion të Sigurt të organizuar dhe të Rregullt dhe Zbatimi i Objektivave të Zhvillimit të qëndrueshëm (SDG)**

#### **B.3.1. Pakti Global për Migracion të Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt**

Lëvizjet globale të refugjatëve dhe migrantëve paraqet sfida, mundësi dhe detyrime për vendet në të gjithë botën.

Me miratimin e Deklaratës së Nju Jorkut për Refugjatët dhe Migrantët, 193 Shtetet Anëtare të OKB-së njohën nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj lëvizshmërisë së njerëzve dhe bashkëpunimit të zgjeruar në nivelin global në 2016.<sup>clxiii</sup> Kjo deklaratë u miratua gjerësisht, duke përfshirë edhe Bashkimin Evropian (BE).

Aneksi II i Deklaratës së Nju Jorkut vuri në lëvizje një proces të konsultimeve ndërqeveritare dhe negociatave drejt zhvillimit të një Pakti Global për Migracionin e Sigurt të organizuar dhe të Rregullt (GCM ose Pakti). Ky proces përfundoi më 10 dhjetor 2018 me miratimin e Paktit Global nga shumica e Shteteve Anëtare të OKB-së në një Konferencë Ndërqeveritare në Marrakesh, Marok, të ndjekur nga afër për miratimin zyrtar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në 19 dhjetor.<sup>clxiv</sup>

Pakti është një moment historik i kërkuar prej kohësh në historinë e dialogut global dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për migracionin. Ai shpreh angazhimin kolektiv nga më shumë se 170 qeveri për të përmirësuar qeverisjen e migracionit; për të forcuar kontributin e migrantëve dhe migracionit në zhvillimin e qëndrueshëm; dhe për të kapërcyer sfidat e ndërlydhura duke mbledhur përfitimet e migracionit ndërkombëtar.<sup>clxv</sup>

Përveç miratimit të Paktit Global për Migracionin e Sigurt të Organizuar dhe të Rregullt, në vitin 2018 u miratua edhe një Pakt Global për Refugjatët. Kjo përmbledhje do të përqendrohet në Paktin Global për Migracionin e Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt cila u miratua nga 164 vende.

Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), agjencia e OKB-së për migracionin e ngarkuar për të qenë Sekretariati për Paktin , këto pakte 'ofrojnë mundësinë për të ecur përpara me forcimin e normave, parimeve, rregullave dhe proceset e vendimmarrjes që do të lejojnë një bashkëpunim më efektiv ndërkombëtar në përgjigje të asaj që është një çështje përcaktuese.' Ofrimi i mbështetjes së vazhdueshme institucionale për adresimin e këtyre çështjeve dhe zbatimin e rezultateve të pakteve globale do të ishte një sfidë.<sup>clxvi</sup>

Pakti global ofron një mundësi të konsiderueshme për të përmirësuar qeverisjen e migracionit, për të adresuar sfidat që lidhen me lëvizjet moderne të migracionit dhe për të forcuar kontributin e migrantëve dhe migracionit në zhvillimin e qëndrueshëm.<sup>clxvii</sup> Këto vëzhgime mund të bëhen në lidhje me GCM:

- synon të kapërcejë copëtimin e qeverisjes së migracionit duke adresuar të gjitha çështjet e ndryshme të ngritura nga migracioni. Ai bazohet në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, zhvillimin, ndryshimin e klimës, mbrojtjen e punës, ose kontrabandimin / trafikimin dhe adreson mënyrat e shumta se si migracioni lidhet me këto.
- GCM është për bashkëpunim, si mes shteteve, ashtu edhe ndërmjet shteteve dhe aktorëve jo-shtetërorë. Për shkak se 'asnjë shtet nuk mund të trajtojë migracionin i vetëm', GCM propozon një "kuadër bashkëpunimi" dhe bën thirrje për "bashkëpunim ndërkombëtar midis të gjithë aktorëve përkatës për migracionin" (para 7).
- GCM bën thirrje për një 'qasje të të gjithë shoqërisë' dhe rekomandon 'partneritete me shumë aktorë' që mbledhin së bashku 'migrantët, diasporën, komunitetet lokale, shoqërinë civile, akademinë, sektorin privat, parlamentarët, sindikatat, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, median dhe palët e tjera të interesuara në qeverisjen e migracionit'.<sup>clxviii</sup>
- GCM njeh dhe respekton plotësisht kuadrin ekzistues ndërkombëtar të të drejtave të njeriut si kuadri autoritar i mbrojtjes për të gjithë migrantët. Që të sigurojë migracion të sigurt dhe të rregullt dhe të jetë besnik ndaj qëllimeve dhe angazhimeve të Deklaratës së Nju Jorkut, Pakti Global riafirmton, respekton dhe zbaton angazhimet dhe detyrimet ekzistuese të Shtetit për të mbrojtur të drejtat e njeriut, sigurinë dhe dinjitetin e të gjithëve njerëzit në lëvizje, pavarësisht nga statusi i tyre i migracionit. Shtetet duhet të sigurohen që të gjithë migrantët, pavarësisht nga statusi i tyre, të ushtrojnë të drejtat e tyre themelore civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

#### **Kutia 22. Objektivat për Migracion të Sigurt dhe të Rregullt**

- (1) të mblidhen dhe të përdoren të dhëna të sakta dhe të ndara si bazë për politikën e bazuar në prova
- (2) të minimizohen shtysat e pafavorshme dhe faktorët strukturorë që i detyrojnë njerëzit të largohen nga vendi i tyre i origjinës
- (3) të jepet informacion i saktë dhe në kohë në të gjitha fazat e migracionit
- (4) të sigurohet që të gjithë migrantët të kenë vërtetim të identitetit ligjor dhe dokumentacion e duhur;
- (5) të rritet disponueshmëria dhe fleksibiliteti i rrugëve për migracion të rregullt;
- (6) të lehtësohen kushtet e rekrutimit të drejtë dhe etik dhe garancitë që sigurojnë punë të denjë;
- (7) të trajtohen dhe pakësohen dobësitë në migracion
- (8) të shpëtohen jetë dhe të bëhen përpjekje të koordinuara ndërkombëtare për migrantët e zhdukur;
- (9) të përmirësohet reagimi ndërkombëtar ndaj kontrabandimit të migrantëve
- (10) të parandalohet, të luftohet kundër dhe të goditet trafikimi i personave në kontekstin e migracionit ndërkombëtar;
- (11) të menaxhohen kufijtë në një mënyrë të integruar, të sigurt dhe të koordinuar;
- (12) të forcohet siguria dhe parashikueshmëria në procedurat e migracionit për shqyrtimin, vlerësimin dhe referimin e duhur;
- (13) të përdoret ndalimi vetëm si një masë të fundit dhe të synohet drejt alternativave
- (14) të përmirësohet mbrojtja, ndihma dhe bashkëpunimi konsullor gjatë gjithë ciklit të migracionit
- (15) të sigurohet e drejta për shërbimet themelore për migrantët
- (16) të fuqizohen migrantët dhe shoqëritë për të realizuar përfshirjen e plotë dhe kohezionin shoqëror;

- (17) të eliminohen të gjitha format e diskriminimit dhe të promovohet diskursi publik i bazuar në prova për të formuar perceptimet e migracionit
- (18) të investohet në zhvillimin e aftësive dhe të lehtësohet njohja reciproke e aftësive, kualifikimeve dhe kompetencave
- (19) të krijohet kushte që migrantët dhe diaspora të kontribuojnë plotësisht në zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha vendet
- (20) të promovohet transferimi më i shpejtë, më i sigurt dhe më i lirë i remitancave dhe të nxitet përfshirja financiare e migrantëve
- (21) të bashkëpunohet për lehtësimin e kthimit dhe ripranimit të sigurt dhe dinjitoz, si dhe riintegrimin e qëndrueshëm;
- (22) të krijohen mekanizmat për mbartjen e të drejtave të sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve të fituara;
- (23) të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneritetet globale për migracionin e sigurt dhe të rregullt

**Edhe pse nuk është ligjrisht i detyrueshëm, Pakti Global për Migracionin përfaqëson një risi në qeverisjen globale të migracionit, duke qenë se bazohet në instrumente ekzistuese ligjrisht të detyrueshme dhe detyrimet e shteteve.**

Pakti Global shënon një fazë të re në bashkëpunimin ndërkombëtar për të menaxhuar dhe për t'ju përgjigjur lëvizjes së njerëzve. Ai përfaqëson një konsensus gati-universal për çështjet që kërkojnë bashkëpunim dhe për veprimet për të ecur drejt arritjes së objektivave të përcaktuara në Pakt.

Shtetet Anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara hartuan Paktin Global për Migracionin me perspektivë afatgjatë, por ai tashmë ka një arritje për meritat e tij: ka sjellë një nga çështjet e fundit të pazgjidhura globale në Kombet e Bashkuara në një mënyrë zyrtare, të negociuar. Për dekada, sistemi ndërkombëtar ka pasur standarde dhe institucione për të lehtësuar bashkëpunimin dhe ruajtjen e rendit për çështjet e financave dhe tregtisë, kontrollit të armëve dhe refugjatëve, dhe shumë çështje të tjera. Kohët e fundit, ai ka zhvilluar një kuadër për trajtimin e ndryshimit të klimës. Por migracioni ndërkombëtar mbeti një gërshetim i politikave dypalëshe dhe rajonale, të konsideruara për shumë kohë përçarëse në debatin e përgjithshëm brenda Kombeve të Bashkuara si një çështje më vete përtej ndërlidhjes së tij me zhvillimin.<sup>cixix</sup>

Me Paktin Global për Migracionin, më në fund është shfaqur një kuadër i pritshmërive dhe angazhimeve të përbashkëta.

Drafti i parë i Paktit Global për Migracionin identifikoi një "sistem koherent të OKB" si të nevojshëm për zbatimin efektiv. **Siç u përmend, Pakti mirëpriti vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm për të zëvendësuar Grupin Global të Migracionit të agjencive të Kombeve të Bashkuara, me një Rrjet të Migracionit të Kombeve të Bashkuara me drejtim më të qartë dhe të qëndrueshëm të IOM-it dhe një grupi të vogël të organeve të Kombeve të Bashkuara të cilat lëvizjen e njerëzve e kanë pjesë të rëndësishme e mandatit ose kapaciteteve të tyre.** Marrëveshja që solli IOM-in në sistemin e Kombeve të Bashkuara si një organizatë përkatëse në vitin 2016 i jep sistemit të Kombeve të Bashkuara kapacitet të paprecedent për të ndihmuar anëtarët e saj në adresimin e çështjeve të migracionit. **Kombet e Bashkuara gjithashtu kanë forcuar kapacitetin e tyre duke krijuar Rrjetin për**

**Migracionin.** Me këtë strukturë të krijuar që nga dhjetori 2018, sistemi i Kombeve të Bashkuara duhet të pozicionohet për të ofruar mbështetje koherente dhe gjithëpërfshirëse për Shtetet ndërsa ata vendosin të zbatojnë angazhimet e tyre për migracion të sigurt dhe të rregullt.<sup>clxx</sup>

Pakti Global për Migracionin mund të interpretohet si një "angazhim politik" që krijon pritshmëri të zbatimit.

**Pakti është marrëveshja e parë ndërshtetërore për migracionin që është negociuar në nivelin global dhe paralajmëron një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimit ndërkombëtar.**

### **B.3.2. Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm**

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Agjenda 2030) në shtator 2015. Agjenda përbëhet nga 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe 169 objektiva shoqëruese. Këto objektiva dhe synime u formuluan përmes një procesi pjesëmarrës dhe me shumë aktorë që përfshinte shtetet, shoqërinë civile globale dhe shumë aktorë të tjerë.<sup>clxxi</sup>

Agjenda 2030 e njuh migracionin si një konsideratë thelbësore të zhvillimit, e cila shënon herën e parë që migracion integrohet në mënyrë të qartë në agjendën e zhvillimit global. Agjenda është e rëndësishme për të gjitha popullatat lëvizëse, pavarësisht nëse janë të brendshme ose ndërkufitare, të shpërngulur apo jo: "qëllimet dhe synimet do të përmbushen për të gjitha kombet dhe popujt dhe të gjitha segmentet e shoqërisë". Ajo njuh gratë, burrat dhe fëmijët migrantë si një grup i pambrojtur që duhet të mbrohet dhe si agjentë të zhvillimit. Të gjitha llojet e migracionit gjithashtu duhet të merren parasysh, duke përfshirë shpërnguljen.<sup>clxxii</sup>

Referenca qendrore për migracionin jepet në Qëllimin 10.7 nën objektivin "Ulja e pabarazisë në dhe midis vendeve", duke bërë thirrje për "lehtësimin e migracionit të rregullt, të sigurt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmërinë e njerëzve, sidomos përmes zbatimit të politikave të migracionit të planifikuar dhe të mirë-menaxhuar." Shumë qëllime të tjerë gjithashtu referojnë drejtpërdrejt re migracioni, dhe për të tjerat migracioni është një çështje e tërthortë që duhet të merret parasysh. Zbatimi i SDG-ve ofron një mundësi për të mbrojtur dhe fuqizuar popullatat lëvizëse që të përmbushin potencialin e tyre të zhvillimit dhe në të mirë të individëve, komuniteteve dhe vendeve të botës.<sup>clxxiii</sup>

Përfshirja e migracionit në SDG gjithashtu hap rrugën drejt bashkëpunimit më të madh mes migracionit dhe sektorëve të zhvillimit dhe, përmes tyre, drejt koherencës më të madhe të politikave. Agjenda 2030 është quajtur "deklaratë e ndërvarësisë" (Kombet e Bashkuara, 2016). Ajo inkurajon që të shkohet përtej qeverisjes si zakonisht dhe sipas synimit 17.14 bën thirrje që "të ndiqet koherenca e politikave dhe një mjedis që mundëson zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha nivelet dhe nga të gjithë aktorët".<sup>clxxiv</sup> Agjenda kërkon që palët e interesuara të kalojnë në një qasje të të gjithë qeverisë për të arritur koherencën e politikave për qeverisjen e migracionit. Lidhjet migracion-SDG arrijnë përtej zbatimit të politikave të migracionit dhe përfshijnë integrimin e migracionit në të gjithë sektorët e qeverisjes. Duke

forcuar koherencën mes agjendave të migracionit dhe zhvillimit, politikat e migracionit mund të përmirësojnë rezultatet e zhvillimit dhe politikat e zhvillimit mund të përmirësojnë rezultatet e migracionit.<sup>clxxv</sup>

Rëndësia e migracionit në kontekstin e zhvillimit është e rrënjësor fort në prezantimin e Agjendës 2030:

*“Ne e njohim kontributin pozitiv të migrantëve për rritjen gjithëpërfshirëse dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ne gjithashtu e pranojmë që migracioni ndërkombëtar është një realitet shumëdimensional me rëndësi të madhe për zhvillimin e vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit, i cili kërkon përgjigje koherente dhe gjithëpërfshirëse. Ne do të bashkëpunojmë ndërkombëtarisht për të siguruar migracion të sigurt dhe të rregullt që përfshin respektimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe trajtimin njerëzor të migrantëve pavarësisht nga statusi i migracionit, refugjatëve dhe personave të shpërngulur. Një bashkëpunim i tillë duhet gjithashtu të forcojë qëndrueshmërinë e komuniteteve që strehojnë refugjatë, veçanërisht në vendet në zhvillim. Ne nënvizojmë të drejtën e migrantëve për t'u kthyer në shtetin e tyre të shtetësisë dhe kujtojmë që shtetet duhet të sigurojnë që shtetasit e tyre të kthyer të pranohen siç duhet.”*<sup>clxxvi</sup>

(Kombet e Bashkuara, 2015)


Kjo tregon se si "migracioni nuk është një 'problem' zhvillimi për t'u zgjidhur, por një mekanizëm që mund të kontribuojë në arritjen e shumë prej Objektivave.<sup>clxxvii</sup>"



Po kështu, Drejtori i Përgjithshëm i IOM ka deklaruar:


*“Pjesa e madhe e ... migracionit është e sigurt, e ligjshme, e rregullt - dhe është jo vetëm e pashmangshme, por e dobishme; jeta e migrantëve të panumërt, familjeve të tyre dhe vendeve të lindjes dhe komuniteteve pritëse përmirësohen. IOM fuqimisht beson se ne duhet ta përqafojmë këtë realitet dhe së bashku të kërkojmë mënyra për të shfrytëzuar pozitivisht përfitimet nga migracioni. Pra, ne nuk duhet t'i përqendrojmë përpjekjet në ndalimin e migracionit, por përkundrazi në krijimin e kushteve ku migracioni është një zgjedhje dhe jo një domosdoshmëri, zhvillohet përgjatë rrugëve ligjore dhe vepron si katalizator për zhvillimin.”*<sup>clxxviii</sup>



Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) përmbajnë disa qëllime që i bëjnë drejtpërdrejt referencë migracionit, siç renditet më poshtë:<sup>clxxix</sup>

**Tabela 5 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe migracioni**<sup>clxxx</sup>

<p><b>Lëvizshmëria e studentëve</b></p>	<p>⇒ Rritja e lëvizshmërisë ndërkombëtare të studentëve Bën thirrje për rritjen e numrit të bursave ndërkufitare në dispozicion. Promovimi i lëvizshmërisë së studentëve ofron një mundësi për të rritur numrin e migrantëve të arsimuar, duke rritur kështu mundësitë e arsimit të lartë për njerëzit nga vendet më pak të zhvilluara dhe në zona me më pak shërbime.</p>	<p>4.B</p> 
---	--	--

<p><b>Trafikimi dhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore</b></p>	<p>⇒ Lufta kundër të gjitha llojeve të trafikimit dhe shfrytëzimit</p> <p>⇒ Adresimi i trafikimit dhe shfrytëzimit të grave dhe fëmijëve</p> <p><i>Qëllimi 8.7 mund të ndihmojë Shtetet të punojnë drejt forcimit të mbrojtjes së individëve të shfrytëzuar dhe të trafikuar, parandalimit të trafikimit dhe shfrytëzimit, dhe ndjekjes penale dhe dëmshpërblimit që lidhet me këto krime. Arritja e këtij qëllimi mund të përfshijë vendet që zhvillojnë politika dhe partneritete në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, që forcojnë kuadrin ligjor dhe të politikave, që promovojnë dialogun dhe bashkëpunimin në luftën kundër trafikimit, që zhvillojnë mekanizmat të identifikimit dhe ndihmës ndaj viktimave dhe që lehtësojnë mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për trafikimin e njerëzve.</i></p> <p><i>SDG adresojnë trafikimin e grave dhe fëmijëve përmes Qëllimeve 5.2 dhe 16.2, duke inkurajuar aktorët të përdorin një këndvështrim gjinor dhe të ndjeshme ndaj moshës kur trajtojnë trafikimin njerëzor. Kjo do t'u lejojë aktorëve të përqendrohen në lloje të caktuara të trafikimit ku gratë, vajzat dhe djemtë mund të jenë veçanërisht të pambrojtur, si trafikimi për shfrytëzim seksual, martesë me detyrim ose trafikimi i fëmijëve për lypje me detyrim.</i></p>	<p>5.2, 8.7, 16.2</p> 
<p><b>Migracioni për motive punësimi dhe Punësimi</b></p>	<p>⇒ Promovimi i punës së denjë</p> <p>⇒ Lufta kundër punës së fëmijëve dhe formave më të këqija të punës së fëmijëve</p> <p>⇒ Lufta kundër trafikimit për punë të detyruar</p> <p>⇒ Adresimi i feminizmit të migracionit</p> <p>⇒ Përmirësimi i qeverisjes së migracionit për motive punësimi</p> <p><i>Promovimi i punës së denjë (Qëllimi 8.5 përfshin shumë lidhje të drejtpërdrejta me migracionin për motive punësimi. Disa qëllime të SDG theksojnë drejtpërdrejt çështjet e vazhdueshme, në zhvillim dhe mbizotëruese të lëvizshmërisë së punës dhe shumë të tjera adresojnë faktorët që krijojnë dinamikën e migracionit për motive punësimi</i></p> <p><i>Qëllimi 8.7 adreson punën e detyruar, trafikimin për punë të detyruar, punën e fëmijëve dhe të gjitha llojet e tjera të shfrytëzimit të punës.</i></p> <p><i>Qëllimi 8.8 kërkon mbrojtjen e të drejtave të të gjitha llojeve të punëtorëve migrantë. Mbatja e qasjes së bazuar në të drejta që promovon kuadrin ndërkombëtare të të drejtave, sidomos standardet e punës, do të ndihmonte në përmirësimin e situatës së shumë punëtorëve migrantë që</i></p>	<p>8.5, 8.7, 8.8</p> 

	<p><i>përballen me vulnerabilitete duke ndihmuar në adresimin e sfidave të përbashkëta, sidomos ato që lidhen me kushtet e punës, pagat, mbrojtjen sociale, sigurinë në punë, statusin e migracionit dhe të drejtën për kujdes shëndetësor (përfshirë të drejtën për shëndetin seksual dhe riprodhues). Duke forcuar praktikat etike të rekrutimit dhe duke ndihmuar në eliminimin e tarifave të rekrutimit, arritja e këtij qëllimi do të ndihmonte gjithashtu në adresimin e trafikimit të njerëzve, skllavërisë së borxheve dhe punës së detyruar.</i></p> <p><i>SDG-të e pranojnë që numri në rritje i punëtorëve migrantë janë femra ("feminizimi i migracionit") duke theksuar nevojën për të mbrojtur punëtorët migrantë shtëpiakë (qëllimi 5.4). Duke punuar në një sektor kryesisht informal dhe të parregulluar, gratë punëtore migrante zakonisht i nënshtrohen shfrytëzimit dhe abuzimit të punës.</i></p> <p><i>Duke njohur shumësinë e çështjeve të migracionit për motive punësimi, duke inkurajuar një qasje të shumë aktorëve dhe duke bërë thirrje për qeverisje të përmirësuar të migracionit sipas qëllimit 10.7, SDG-të gjithashtu në mënyrë indirekte bëjnë thirrje për përmirësimin e qeverisjes së migracionit për motive punësimi. Kjo përfshin sisteme efektive, të bazuara në të drejtat e njeriut dhe gjinore, të migracionit për motive punësimi, të cilat përfshijnë institucione, aktorë dhe procese për të mbrojtur të drejtat e të gjithë punëtorëve migrantë, në të njëjtën kohë duke marrë parasysh punësimin, tregun e punës, aftësitë dhe faktorët e kërkesës. Qeverisja e përmirësuar mund të sjellë gjithashtu një bashkëpunim më të madh ndërkombëtar, për shembull përmes iniciativave rajonale dhe partneriteteve midis vendeve përmes, për shembull, marrëveshjeve dypalëshe të punësimit dhe bashkëpunimit për rekrutimin etik, të drejtat e punës, njohjen e aftësive dhe/ose mbartjen e përfitimeve sociale.</i></p>	
<p><b>Qeverisje e Migracionit</b></p>	<p>⇒ Lehtësimi i migracionit të rregullt, të sigurt dhe të përgjegjshëm</p> <p>⇒ Zbatimi i planifikuar dhe i mirë-menaxhuar i migracionit dhe lëvizshmërisë</p> <p><i>Lehtësimi i migracionit të rregullt, të sigurt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmërisë</i></p> <p><i>Targeti 10.7, nën Objektivin 10 Ulja e pabarazisë brenda dhe midis vendeve, vlerëson që qeverisja efektive e migracionit është thelbësore për migracionin më të sigurt dhe më të rregullt. Ai gjithashtu pranon nevojën për regjime globale, rajonale dhe kombëtare të migracionit dhe kuadër gjithëpërfshirës të politikave për të menaxhuar migracionin për të mirën e të gjithëve. Kjo përfshin</i></p>	<p>10.7</p> 

	<p><i>promovimin e migracionit të rregullt që respekton të drejtat e të gjithë migrantëve dhe përfitimin nga ndikimi pozitiv i zhvillimit të migracionit për vetë migrantët, si dhe për të gjitha komunitetet dhe vendet.</i></p> <p><i>Në praktikë, menaxhimi gjithëpërfshirës dhe efektiv i migracionit përfshin një gamë të gjerë fushash veprimi. Kjo përfshin, por jo vetëm, integrimin e migracionit dhe forcimin e kapaciteteve, mbrojtjen të drejtave të migrantëve dhe promovimin e mirëqenies së të gjithë migrantëve, përmirësimin e integritit të migrantëve në komunitetet pritëse.</i></p>	
<b>Remitancat</b>	<p>⇒ Ulja e kostove të transaksioneve të remitancave</p> <p><i>Kostot e transaksionit të remitancave mund të jenë të larta, gjë që ul ndikimin e remitancave, ngarkon migrantët dhe mund të dekurajojë dërgimin e tyre përmes kanaleve formale. Kjo mund të ndikojë në veçanti tek gratë migrante, pasi ato shpesh dërgojnë shuma më të vogla parash se burrat migrantë, megjithëse më rregullisht. Qëllimi 10.C synon të ulë këto kosto duke vendosur një tavan për tarifatat e transaksioneve.</i></p>	<p>10.C</p> 
<b>Të dhënat e migracionit</b>	<p>⇒ Përmirësimi i të dhënave për temat e migracionit</p> <p><i>Ka boshllëqe të konsiderueshme në sasinë, saktësinë, periudhën kohore, krahasueshmërinë (me kalimin e kohës dhe në të gjithë vendet) dhe mundësinë e përdorimit të të dhënave të migracionit. SDG të krijojnë një nevojë të menjëhershme për një sasi dhe cilësi më të madhe të të dhënave të migracionit. I tillë është rasti në të gjitha fushat e çështjeve të migracionit, si qeverisja e migracionit, migracioni për motive punësimi, trafikimi i qenieve njerëzore dhe shumë më tepër. Matja e qëllimeve të SDG të lidhura me migracionin është sfidë e vështirë, veçanërisht pasi treguesit ekzistues në nivelin global për këto qëllime janë të vështira për t'u operacionalizuar dhe shumica nuk kanë metodologji të mirë-përcaktuar</i></p> <p>⇒ Përmirësimi i zberthimit të të dhënave sipas statusit migrator dhe variableve të tjera</p> <p><i>Një fokus kryesor i procesit të zbatimit të SDG është promovimi i zberthimit më të madh në monitorimin e të dhënave në mënyrë që t'u shërbejë më mirë grupeve të caktuara të pambrojtura. Kjo përfshin zberthimin e të dhënave sipas statusit migrator dhe variabli tjetër siç është mosha dhe seksi të paktën.</i></p>	<p>17.18</p> 



## B.4. Migracioni i ndjeshëm ndaj gjinisë dhe miqësor me të miturin

### B.4.1. Migracioni i ndjeshëm ndaj gjinisë

Gratë përbëjnë afërsisht gjysmën e të gjithë migrantëve ndërkombëtarë në të gjithë botën. Rolet, marrëdhëniet dhe pabarazitë gjinore ndikojnë te kush migron dhe pse, si merret vendimi, ndikimet mbi vetë migrantët, në zonat dërguese dhe në zonat pritëse. Përvoja tregon se migracioni mund të ofrojë mundësi të reja për të përmirësuar jetën e grave dhe për të ndryshuar marrëdhëniet shtypëse gjinore - madje edhe shpërngulja si rezultat i konfliktit mund të çojë në zhvendosje të roleve gjinore dhe përgjegjësive në avantazh të grave.<sup>clxxxii</sup> Megjithatë, migracioni mund të krijojë role tradicionale dhe pabarazi dhe t'i ekspozojë gratë ndaj vulnerabiliteteve të reja si rezultat i udhëtimit të rrezikshëm, statusit të pasigurt ligjor, përjashtimit dhe izolimit.<sup>clxxxii</sup>

#### B.4.1.1. Kuadri ligjor ekzistues ndërkombëtar dhe rajonal në lidhje me gjininë dhe migracionin

*"Risku i dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore është i lartë ..." ku gratë dhe vajzat gjithashtu përballen me sfida të tjera, veçanërisht në tranzit, të stresit psiko-social dhe traumës, komplikimeve shëndetësore, dëmtimit fizik, lëndimit dhe të gjitha formave të shfrytëzimit, përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore. Gratë dhe vajzat migrante zakonisht u nënshtrohen formave të shumëfishta dhe të ndërthurura të diskriminimit, bazuar në seksin dhe në shkaqe shtesë si raca, feja apo etnia.*<sup>clxxxiii</sup>

**Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW)**, e cila u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së gati 35 vjet më parë është një akt ndërkombëtar i të drejtave për gratë.<sup>clxxxiv</sup> Në mënyrë të veçantë, Konventa përcakton se çfarë përbën diskriminim ndaj grave dhe përcakton një agjendë për veprim kombëtar për t'i dhënë fund një diskriminimi të tillë. Edhe pse Konventa nuk është specifike për gratë refugjate ose migrante, ajo gjen zbatim për to ashtu si gjen zbatim për çdo grua, qoftë edhe thjesht për aspektin njerëzor. Gjithashtu është një dokument dinamik ligjor që ndjek zhvillimet ndërkombëtare dhe tendencat në fushën e të drejtave të njeriut dhe adreson të drejtat e grave migrante përmes rekomandimit të Përgjithshëm të Komitetit CEDAW Nr. 32 mbi dimensionet e lidhura me gjininë për statusin e refugjatit, azilin, kombësisë dhe pashtetësisë së grave në 2014 dhe rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 26 për gratë punëtore migrante në vitin 2008.<sup>clxxxv</sup>

CEDAW përkufizon në mënyrë gjithëpërfshirëse diskriminimin ndaj grave si "çdo dallim, përjashtim ose kufizim i bërë në bazë të seksit që ka efektin ose qëllimin e dëmtimit ose zhvlerësimit të njohjes, gëzimit ose ushtrimit nga gratë ... të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ..."<sup>clxxxvi</sup>

Neni 3 i CEDAW kërkon që Shtetet Anëtare të marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin për të garantuar ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga gratë mbi bazën e barazisë me burrat.

Neni 11 adreson posaçërisht eliminimin e diskriminimit në fushën e punësimit; neni 12 për të drejta të barabartë në shërbimet e kujdesit shëndetësor, përfshirë ato që lidhen me planifikimin familjar dhe neni 15 u jep burrave dhe grave të njëjtat të drejta në lidhje me lëvizjen e personave dhe lirinë për të zgjedhur vendbanimin dhe vendqëndrimin e tyre.

Rekomandimi i Përgjithshëm 26 mbi Punëtoret Migrante ofron një kuadër të fuqishëm për të mbështetur ligjërisht formulimin e politikave të migracionit të ndjeshme ndaj gjinisë, të bazuara në të drejta.

Në veçanti, rekomandimi i Përgjithshëm 26, paragrafi 23 parashikon që CEDAW dhe Rekomandimi i Përgjithshëm 26 duhet të përdoren për të hartuar politika, bazuar në barazi dhe mosdiskriminim, që rregullojnë dhe administrojnë të gjitha aspektet dhe fazat e migracionit në një mënyrë që lehtëson përdorimin e mundësive të grave punëtore migrante për të punuar jashtë vendit, duke promovuar migracionin e sigurt dhe duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre.<sup>clxxxvii</sup>

Rekomandimi jep udhëzime më specifike për Shtetet Palë se si të respektojnë, të mbrojnë dhe të realizojnë të drejtat e njeriut të grave punëtore migrante, duke dhënë rekomandime specifike për vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit. Fusha e veprimit të Rekomandimit të Përgjithshëm 26 shtrihet te gratë punëtore migrante që migrojnë në mënyrë të pavarur, ato që bashkohen me bashkëshortet e tyre ose anëtarët e tjerë të familjeve të tyre që janë gjithashtu punëtore, si edhe gratë punëtore migrante pa dokumente.

Gjithashtu, paragrafi 23 i Rekomandimit të Përgjithshëm 26 përcakton përgjegjësitë e mëposhtme të përbashkëta të vendeve të origjinës dhe destinacionit:

- ✓ formulimi i politikës së migracionit që merr parasysh gjinisë;
- ✓ përfshirja aktive e grave punëtore migrante në formulimin e politikave; dhe
- ✓ ndërmarrja e kërkimit sasior dhe cilësor, mbledhja dhe analizimi i të dhënave për të siguruar që politikat të jenë përgjegjshme ndaj gjinisë.<sup>clxxxviii</sup>

Në nivelin evropian, Konventa e Stambollit ofron **MASA TË VEÇANTA PËR MBROJTJEN E GRAVE MIGRANTE**.<sup>clxxxix</sup>

- ✓ Prezanton mundësinë për t'u dhënë grave migrante leje qëndrimi autonome nëse ato janë bllokuar në një marrëdhënie abuzive, sepse statusi i tyre i qëndrimit varet nga ai i bashkëshortit ose partnerit të tyre abuzues.
- ✓ I kërkon Shteteve Palë të sigurohen që dhuna me bazë gjinore ndaj grave të njihet si një formë persekutimi sipas kuptimit të Konventës së Refugjatëve të vitit 1951 (neni 60, paragrafi 1)
- ✓ Gjithashtu kërkon që shtetet palë të sigurojnë që arsyet për azil të renditura në Konventën e Refugjatëve të vitit 1951 të interpretohen në një mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë (neni 60, paragrafi 2).
- ✓ Përcakton detyrimin për të prezantuar procedura të ndjeshme ndaj gjinisë, udhëzime dhe shërbime mbështetëse në procesin e azilit (neni 60, paragrafi 3).

**MOSKTHIMI**

- ✓ Krijon detyrimin për t'u siguruar që viktimat e dhunës kundër grave që kanë nevojë për mbrojtje, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, të mos kthehen në asnjë vend ku jeta e tyre do të rrezikohej ose ku ato mund t'i nënshtrohen torturës ose trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues.

**Platforma e Veprimit e Pekinit e Konferencës së Katërt Botërore për Gratë në vitin 1995<sup>cxc</sup>** përshkruan qasje tredimensionale të bazuar në të drejta që i referohet marrjes në konsideratë të tre dimensioneve të të drejtave kur zhvillohen tregues cilësorë në lidhje me proceset e sigurta dhe të drejta të migracionit të grave për motive punësimi. Këto janë:

- ✓ **Të drejtat e grave në lidhje me mundësitë për migracionin e ligjshëm:** Sigurimi i qasjes së grave dhe pjesëmarrja e grave, mundësi të punësimit të sigurt dhe ligjor dhe mbrojtja e tyre nga shfrytëzimi dhe dhuna;
- ✓ **Të drejtat brenda procesit të migracionit:** Sigurimi i rekrutimit, udhëtimit, shpërblimit të sigurt, kontrollit mbi fitimet, kushteve të denja për punë, strehim dhe kushte të denja jetese, të drejtës për jetën familjare, shërbime ligjore, vendimmarrje, kujdes shëndetësor dhe informacion; dhe
- ✓ **Të drejtat e realizuara përmes migracionit:** Lehtësimi dhe inkurajimi i rezultateve potencialisht pozitive të migracionit për gratë, p.sh. përmes autonomisë të rritur dhe fuqisë për të negociuar kushtet e tyre të punës në vendin e destinacionit, duke pasur kontroll mbi fitimet e tyre dhe më shumë vendimmarrje në nivelin e familjes në vendin e origjinës.

#### **B.4.1.3. Gjinia dhe migracioni në kontekstin e zhvillimit**

Ndërsa migracioni njihet si një tipar i pandarë i botës së sotme, **situata dhe kontributet e grave migrante duhet të njihen në mënyrën e duhur gjithashtu.**

Punëtoret migrante femra janë **kontribuuese aktive në zhvillimin socio-ekonomik** të:

- ✓ vendit të tyre të origjinës (kryesisht përmes dërgimit të remitancave, por edhe përmes ndarjes së aftësive dhe njohurive të marra jashtë vendit me komunitetet e tyre në vendet e tyre të origjinës dhe duke mbështetur arsimimin e fëmijëve të tyre) dhe
- ✓ vendeve të destinacionit (duke siguruar burime njerëzore dhe ekonomike).

Në atë aspekt, rëndësia e remitancave nuk duhet të nënvlerësohet, pasi ato kontribuojnë në zhvillimin kombëtar dhe ekonominë ndërkombëtare.

Remitancat e dërguara në shtëpi nga

gratë migrante janë mjaft të konsiderueshme, megjithëse shumat e dërguara çdo herë prirën të jenë më të vogla se shumat e dërguara nga burrat, kryesisht sepse gratë shpesh paguhen më pak.<sup>cxcii</sup> Gjithsesi gratë dërgojnë një përqindje më të lartë të fitimeve të tyre dhe bëjnë këtë më shpesh.

Kutia 23. Për shembull, një studim i kryer në vitin 2000 tregoi se gratë nga Bangladeshi që punojnë në Lindjen e Mesme dërguan në shtëpi mesatarisht 77 për qind të të ardhurave të tyre.

Sipas UN-Women, gratë ka më shumë të ngjarë të marrin remitanca, pavarësisht nga seksi i dërguesit. Si shembull, në një sondazh të kryer në Republikën Dominikane në vitin 2004, 57 përqind e atyre që marrin remitanca janë gra, dhe 58 përqind e atyre që dërgojnë remitanca janë gra.<sup>cxcii</sup>

Gratë ka më shumë të ngjarë të investojnë remitanca në arsimimin dhe shëndetin e fëmijëve.<sup>cxciii</sup>

Kutia 24. Një studim i kryer në vitin 2008, tregoi se remitancat kishin rritur regjistrimin në shkollës në Ekuador mesatarisht me 2.6 për qind, ku ndikimi ishte edhe më i lartë tek vajzat, në zonat rurale dhe mes më të varfërve.

Po kështu, studimet e kryera në Guatemala, Meksikë dhe Marok treguan se fëmijët kishin shëndet më të mirë dhe shkallë më të ulët të vdekshmërisë pasi nënat e tyre u kthyen për shkak të njohurive të reja dhe të përmirësuar për kujdesin shëndetësor dhe rritja e mjeteve financiare në dispozicion të familjes.

#### **Kutia 25. Shënim i rëndësishëm në lidhje me migracionin e grave dhe rrjedhjen e trurit**

Është e rëndësishme të theksohet se migracioni i grave dhe ai i burrave, gjithashtu lë boshllëqe në vendet e tyre të origjinës. Në vitin 2011, Banka Botërore vuri në dukje se mjekët dhe infermierët ishin profesionistët që migronin më shpesh. Prandaj nuk është për t'u habitur që sipas një studimi, vendet sub-Sahariane po përjetojnë një mungesë prej 600,000 infermierësh. Në një studim tjetër u zbuluar që nga viti 1999 deri në vitin 2001, 60 përqind e infermiereve të regjistruar lanë spitalet terciare në Malavi, mundësisht për të migruar. Për rrjedhojë, 64 përqind e pozicioneve të infermiereve (të dominuara nga gratë) mbeten të paplotësuara, me qendrat mjekësore që funksionojnë pa infermiere ose me punonjës që kanë më pak se 10 javë trajnim mjekësor. Ndërsa Qeveria e Malavit është përpjekur të rrisë burimet dhe pagat për profesionistët shëndetësorë për të kompensuar rrjedhjen e trurit, ajo nuk ka qenë në gjendje të konkurrojë me pagat e ofruara në vendet e tjera.<sup>cxciv</sup>

Migracioni në Shqipëri ka ekzistuar që në kohërat e hershme. Duke ndjekur zhvillimet e tij, ai mund të ndahet në katër periudha: (i) Mesjeta deri në Shekullin 19; (ii) Shekulli 19 deri më 1945; (iii) gjatë Regjimit Komunist; (iv) Migracioni post-komunist. Sidomos faza e fundit ka kaluar **3 dekada**, e karakterizuar nga disa tipare shumë specifike dhe vijon në vitet në vijim deri tani.<sup>ccxxxvii</sup> Flukset migratore të Shqipërisë mund të karakterizohen si intensive, të shtyra ekonomikisht, të parregullta dhe në zhvillim të shpejtë, me një tendencë dominuese të brezit më të ri që ëndërron të ndërtojë një të ardhme jashtë vendit.<sup>ccxxxviii</sup> Karakteristikat specifike dhe të dallueshme janë si më poshtë:<sup>ccxxxix</sup>



**Shqipëria mbetet kryesisht një vend emigracioni.** Emigracioni i shtetasve shqiptarë, në veçanti drejt vendeve të Bashkimit Evropian (BE) vazhdon pavarësisht nga përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të jetesës në vend, një rritje neto e qëndrueshme e ekonomisë shqiptare dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë publike.


Në vitin 2018, Shqipëria kishte rreth 1.5 milion shtetas jashtë territorit të saj, ose rreth gjysmën e popullsisë së vendit. Shumica e komuniteteve të migrantëve janë të pranishëm jo vetëm në vendet fqinje si Italia dhe Greqia (përkatësisht 46% dhe 45%), por edhe në Gjermani (5%), ndjekur nga Mbretëria e Bashkuar, Belgjika, Franca, Australia, Spanja dhe Austria. Ndërkohë që ekziston një tendencë në rritje e shqiptarëve që qëndrojnë në shtete të tjera anëtare të Bashkimit Evropian, si edhe në Amerikën e Veriut dhe Kanada.<sup>ccxli</sup>

**Migracioni ndërkombëtar i Shqipërisë mund të analizohet me faktorët thelbësorë shtytës dhe tërheqës që karakterizojnë fenomenin.** *Papunësia*, veçanërisht tek të rinjtë, identifikohet si **faktori kryesor shtytës**. Shqipëria ka akoma një potencial të lartë migracioni të favorizuar nga afërsia kulturore, gjuhësore dhe gjeografike, kosto e ulët e emigracionit në vendet fqinje përfshirë Italinë dhe Greqinë, si dhe mundësi ligjore për bashkimin e familjes në vendet kryesore pritëse të emigrantëve. Shkalla e lartë e emigracionit të personave të kualifikuar është një tjetër karakteristikë e migracionit shqiptar, veçanërisht në fushën e shëndetësisë.<sup>ccxlii</sup> Faktorë të tjerë shtytës që ndikojnë në vendimet dhe përvojat migratore

janë kushtet e këqija të jetesës, mungesa e sigurisë individuale dhe e sigurisë politike, si dhe shpresa për një të ardhme më të mirë dhe perspektivat për migrantin individual dhe familjen e tij ose të saj. Nxitësit kryesorë të emigracionit shqiptar mbeten përmirësimi i standardit të jetesës, papunësia, pagat e ulëta dhe kushtet e punës, skemat e sigurimeve shoqërore dhe borxhet.<sup>ccxlii</sup> Remitancat përfaqësojnë një tipar kryesor të migracionit ndërkombëtar shqiptar.

Për më tepër, mangësitë e shërbimeve publike kanë shërbyer si **faktorë shtytës**, duke ndikuar negativisht në përpjekjet dhe mundësitë e migrantëve për t'u kthyer dhe për t'u vendosur në Shqipëri. "Humbja" e njerëzve të kualifikuar dhe të arsimuar, e njohur si fenomeni "Rrjedhje e trurit" konsiderohet në dëm të zhvillimit socio-ekonomik të një vendit sepse ata janë forca lëvizëse e çdo vendi.<sup>ccxliii</sup> Dy kategoritë e personave - *të rinjtë dhe gratë* - e kanë parë situatën në tregun lokal të punës veçanërisht të vështirë.

**Figura 8 Faktorët e emigracionit të shtetasve shqiptarë**




**Kthimi i migrantëve shqiptarë është një fenomen tjetër, që është për shkak të :** *i) kthimit vullnetar; ii) kthimit të detyruar.* Kthimi vullnetar përfshin kategori të ndryshme si migrantët me status të rregullt në vendet pritëse, por edhe ata të cilëve u është mohuar azili, që zgjedhin të kthehen më dëshirë në Shqipëri pas refuzimit përfundimtar të kësaj kërkesë, si dhe migrantë të parregullt të cilët nuk kanë kërkuar azil por ende kanë zgjedhur të kthehen vullnetarisht.. Të gjithë migrantët shqiptarë me status qëndrimi të parregullt përfshirë azilkërkuesit kërkesa e të cilëve për kthim vullnetar në Shqipëri nuk është pranuar bëjnë pjesë në kthimin e detyruar, i cili kryesisht ndodh në kuadër të marrëveshjeve të ripranimit që ka nënshkruar Shqipëria me vendet pritëse. Kthimi i të miturve të pashoqëruar vazhdon të qëndrojë në nivele të larta, sidomos nga Franca dhe Gjermania, që gjatë dekadave të fundit kanë qenë mes vendeve kryesore të azilkërkuesve nga shtetasit shqiptarë për arsye ekonomike apo jetese më të mirë. Duhet theksuar se Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje ripranimi me BE-në, në fuqi që në vitin 2006 për shtetasit shqiptarë dhe që në vitin 2008 për shtetasit e vendeve të treta.<sup>ccxliv</sup>

**Migracioni në kontekstin shqiptar karakterizohet më shumë nga emigracioni ndërkombëtar i popullsisë vendase dhe më pak nga imigracioni i të huajve në vend.** Në përgjithësi, Shqipëria konsiderohet ende një vend i origjinës për emigrantët ekonomikë, vend tranzit dhe destinacioni për imigrantët për qëllime punësimi, azilkërkuesit dhe

refugjatët.<sup>ccxlv</sup> Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, modelet e migracionit dhe qëndrimi i shqiptarëve ndaj tyre kanë ndryshuar për shkak të politikave të rrepta të vendeve pritëse dhe intensifikimit të luftës kundër migracionit të parregullt nga autoritetet shqiptare.<sup>ccxlv</sup>

**Shqipëria po bëhet gjithnjë e më shumë një vend destinacioni** për një sërë kategorish të huajsh, megjithëse numrat janë relativisht të vegjël. Ashtu si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, **Shqipëria gjithashtu është prekur nga flukset e përziera të popullsisë**, të cilat nxiten jo vetëm nga aspekti socio-ekonomik, por edhe nga konfliktet. Gjatë dekadës së fundit, numri i përgjithshëm i të huajve që banojnë në Shqipëri ka mbetur afërsisht në 0.3% të popullsisë vendase dhe origjina e imigrantëve të ligjshëm nuk tregon ndonjë ndryshim të rëndësishëm.<sup>ccxlvii</sup>

**Figura 9 Llojet e migrantëve në Shqipëri**



Disa nga të huajt - si refugjatët dhe azilkërkuesit, migrantët, viktimat e trafikimit, të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, dhe personat pa shtetësi - bëjnë pjesë në më shumë se një nga kategoritë e lartpërmendura. Ata përbëjnë shtetësi të ndryshme - shumica janë siriane dhe afgane, të cilët shpesh hyjnë në vend në mënyrë të parregullt. Në shumicën e rasteve, përfshihet të paktën një shkallë vulnerabiliteti, qoftë kjo si rezultat i situatës në vendet e origjinës, ose për shkak të kushteve të vështira ose shfrytëzimit dhe abuzimit të pësuar përgjatë rrugëve. Këta individë kërkojnë kryesisht kalim tranzit në Shqipëri përpara se të lëvizin dhe të hyjnë në vendet e BE-së.

Në përmbledhje, analizat dhe tiparet e migracionit ndërkombëtar të Shqiptar, çojnë në disa gjetje:

- Fenomeni prek kryesisht popullatën e re në moshë pune dhe është më i përhapur tek meshkujt;
- Përvojat migratore ndikohen nga faktorë të tillë si papunësia, varfëria, mungesa e sigurisë individuale dhe kolektive (faktorët shtytës) si dhe aspiratat ekonomike, arsimore dhe aspiratat për një cilësi më të mirë të jetës (faktorët tërheqës);
- Migracioni ndërkombëtar mund të shfaqet si një ndërmarrje individuale dhe më vonë të bëhet një fenomen i bazuar në familje, ku anëtarët e familjes bashkohen me migrantin individual pas një periudhe fillestare të jetesës jashtë vendit;
- Shqiptarët vazhdojnë të kërkojnë azil në vendet anëtare të BE-së për arsye ekonomike, ndërsa migracioni i fëmijëve të pashoqëruar mbetet problematik për shkak të numrit në rritje;



- Ndikon tek ekonomia/tregu i punës, si dhe struktura e popullsisë shqiptare, rritja e saj dhe ndryshimet demografike;
- Shqiptarëve të kthyer që u ofrohen shërbime nga Sportelet e Migracionit mbeten të pakët në numër;
- Remitancat janë një karakteristikë kryesore e migracionit shqiptar, burimet e të cilit ndikojnë në mirëqenien e menjëhershme të anëtarëve të familjes dhe indirekt në ekonominë e vendit.<sup>ccxlviii</sup>

## C.2. Aktorët e rëndësishëm për qeverisjen e migracionit - gasja e qeverisjes qendrore dhe vendore

**Figura 10 Shtyllat e qeverisjes së migracionit**



Forcimi i kapaciteteve institucionale është thelbësor për menaxhimin efektiv të migracionit. Ky proces do të jetë gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm për arritje thelbësore. Një faktor kyç që çon në sigurimin e pronësisë institucionale është **qartësia për sa i përket roleve dhe përgjegjësi të institucioneve për qeverisjen e migracionit - si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal**. Një ndarje e qartë e kompetencave mes Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shtetit për Diasporën, Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë, ministrive të tjera të linjës dhe institucioneve vartëse është thelbësore për të avancuar agjendën e migracionit. Një faktor tjetër kryesor për rritjen e pronësisë institucionale është **koordinimi i mirë institucional në nivelin qendror dhe lokal për zbatimin e politikave të lidhura me migracionin**.

**Tabela 7 Kuadri Institucional për menaxhimin e migracionit paraqitet në tabelën më poshtë**

**Ministria e Punëve të Brendshme** është autoriteti kryesor që mbikëqyr kontrollin kombëtar të kufirit, menaxhimin e imigracionit, integrimin e të huajve dhe koordinimin e përpjekjeve kundër trafikimit të qenieve njerëzore në nivel kombëtar dhe lokal së bashku me aktorë të tjerë. E bën këtë përmes Drejtorisë Antitrafik dhe Drejtorisë së Migracionit, Policisë së Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Drejtorisë për Azilin, etj.

- o *Departamenti për Kufirin dhe Migracionin* pranë Policisë së Shtetit, si autoriteti përgjegjës për trajtimin e të huajve që hyjnë, kalojnë tranzit ose qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, i organizuar në nivel kombëtar dhe lokal, është përgjegjës për kontrollin e të huajve dhe merr vendime në lidhje me procedurat e aplikimit për vizë nga të huajt që synojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë; kontrollin kufitar duke zbatuar kushtet dhe kriteret e hyrjes, qëndrimit dhe tranzitit në Republikën e Shqipërisë; pajisjen e të huajve me leje qëndrimi ose shtyrjen e afatit të qëndrimit etj.

- *Drejtoria Antitrafik* merret vetëm me monitorimin, koordinimin, promovimin dhe orientimin e veprimtarisë së strukturave qendrore / vendore në çështjet e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme** është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së vizave dhe negocimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit dhe për mbështetjen e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, organizimin e diasporës shqiptare etj.

- *Drejtoria e Çështjeve Konsullore* është struktura përgjegjëse për trajtimin e të huajve, për hartimin e politikave të hyrjes dhe qëndrimit të tyre në RSH. Kjo drejtori harton politikat e veprimtarisë së shërbimit konsullor, monitoron dhe drejton këtë veprimtari.

**Ministri i Shtetit për Diasporën** është përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikës për Diasporën në koordinim me ministritë e tjera të linjës.

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** përmes Drejtorive të saj dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, kryen veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e zhvillimit dhe monitorimit të politikave shtetërore për emigracionin në lidhje me punësimin, arsimin dhe formimin profesional, standardet sociale, pensionet, familjen, politikat për fëmijët dhe të rinjtë, etj. Ky institucion është përgjegjës për lejimin e të huajve që të punësohen në çdo kohë, sidomos profesionet.

- *Drejtoria e politikave të punësimit dhe formimit profesional;*
- *Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;*
- *Inspektorati Kombëtar i Punësimit.*

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë** është ministria përgjegjëse për qeverisjen e migracionit për motive punësimi në vend në bashkëpunim me ministri të tjera (krijimin dhe zbatimin e skemave të migracionit për motive punësimi, si edhe negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të punësimit). Ajo gjithashtu monitoron funksionimin e agjencive të rekrutimit që të sigurohet për rekrutimin etik të punëtorëve migrantë dhe mbikëqyr punën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit sidomos të Sporteleve të Migracionit.

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** mbikëqyr punën e Shërbimit Social Shtetëror, i cili ofron shërbime thelbësore për kategoritë e pambrojtura, sidomos migrantë të tillë si Viktimat e Trafikimit dhe të miturit e pashoqëruar.

- *Drejtoria e Politikave dhe Strategjive për Zhvillimin e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale.*

**Ministria e Drejtësisë**

- *Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;*<sup>ccxlix</sup>
- *Drejtoria e Kodifikimit dhe Hartimit të Legjislacionit.*

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Rinisë**

- *Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve*

**INSTAT** është përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe ndarjen e të dhënave administrative si dhe sigurimin e statistikave për migracionin.

- *Departamenti i Statistikave Sociale.*

**Kryeministria**


- *Drejtoria e Politikave dhe Prioriteteve për Zhvillim.*
- *Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.*

**Avokati i Popullit** mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme jo vetëm të shtetasve shqiptarë, por edhe të migrantëve të rregullt apo të parregullt, duke dhënë rekomandime, duke bërë kërkesa për përmirësime legislative ose propozime për mbrojtjen e të drejtave të shkelura.

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** është një institucion i pavarur publik, përgjegjës për mbrojtjen e efektshme nga diskriminimi si edhe çdo lloj sjelljeje që promovon diskriminimin. KMD kryen hetime administrative dhe merr vendime duke vendosur gjopa për moszbatim të vendimit ose mungesë bashkëpunimi nga subjekte të tjera private ose publike.

### C.3. Vështrim i përgjithshëm i legjislacionit parësor, dytësor dhe i politikave

Figura 8 - Hierarkia e akteve ligjore në Shqipëri



Një kuadër i fortë ligjor siguron mbrojtjen e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, si dhe të imigrantëve në Shqipëri. Legjislacioni për migracionin (parësor dhe dytësor) vazhdon të përafrohet me *acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare ku Shqipëria ka aderuar. Hierarkia e akteve normative siguron që garancitë themelore kushtetuese dhe mekanizmat e mbrojtjes të formësohen më tej nga një kuadër kompleks ligjor që pëson përmirësime dinamike pozitive.

#### Parimet kushtetuese që rregullojnë migracionin janë:

- Liria e lëvizjes (neni 16 & 38);
- Parimi i mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë dhe të denjë (neni 18);
- Mbrojtja e shtetasve shqiptarë jashtë vendit (neni 8);
- Ndalimi i dëbimit të shtetasve dhe dëbimit kolektiv të të huajve (neni 39);
- E drejta e ankimit (neni 43);
- E drejta për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale.

#### Kuadri ligjor i zbatueshëm përfshin:

- *Ligji Nr. 9668/2006 "Për Emigracionin e Shtetasve Shqiptarë për qëllime punësimi", i ndryshuar, si edhe:*
  - o Urdhër Nr. 1772 / 2007 për formatin, përmbajtjen dhe procedurën e marrjes së statusit të emigrantit;
  - o Urdhër Nr. 2086/2007 për formatin dhe përmbajtjen e Regjistrimit të Emigrantëve dhe procedurat e regjistrimit;
  - o Udhëzim Nr. 44, datë 21.08.2013 për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", i ndryshuar me udhëzimin nr. 30, datë 29.12.2017;
  - o Udhëzim Nr. 11/2010 i Ministrit të Arsimit për kriteret e njohjes së shkollave të mesme dhe regjistrimin në provimin shtetëror të shkollës së mesme në 2010.
- *Ligji nr. 108/2013 "Për të Huajt", i ndryshuar dhe aktet normative në zbatimin e ligjit është përmirësuar disa herë në lidhje me procedurat për dokumentet e udhëtimit, vizat, punësimin, qëndrimin, bashkimin familjar etj.*
  - o Udhëzim i Përbashkët Nr. 264, datë 11.01.2016 për bashkëpunimin e strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të

Jashtme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror mbi procedurën e lëshimit të vizave për të huajt.

- *Ligji nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë":*
  - o Udhëzim Nr. 2393/2015 i Ministrit të Brendshëm për procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në Shqipëri;
  - o Urdhër Nr. 1146/2014 i Ministrit të Brendshëm për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin Nr. 851/2009 për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Kufirin dhe Migracionin.
- *Ligji Nr. 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit",*
- *Ligji Nr. 16/2018 "Për Diasporën Shqiptare",*
- *Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre",*
- *Ligji Nr. 14/2016 "Për identifikimin dhe regjistrimin e adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë",*
- *Ligji Nr.23 / 2015 "Për Shërbimet Konsullore;"*
- *Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;"*
- *Ligji nr.9861, datë 24.01.2008 "Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror", etj.*

**Dokumentet strategjike** synojnë të sigurojnë qasje ndër-sektoriale për qeverisjen e migracionit dhe përpiqen të adresojnë sfidat në lidhje me lëvizjet e përziera (migracioni parregullt, azilkërkues dhe refugjatë, UASC etj.) duke rritur ndikimin e migracionit në zhvillim (investimet, zhvillimi njerëzor, novacioni, etj.).

**Në Shqipëri, që nga viti 2004, janë zbatuar dhe rishikuar disa dokumente të politikave strategjike mbi migracionin, si më poshtë:**

#### **Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit (2015-2010)**

#### **Plani i Veprimit për Remitancat (2007-2010)**

#### **Strategjia për Kthimin dhe Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë (2010-2015)**

#### **Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Fëmijëve (2014-2017)**

**Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2014-2020 dhe plani i saj i veprimit, në lidhje me migrantët, synon veçanërisht:**

- të forcojë kapacitetet informuese dhe këshilluese për emigracionin e rregullt për motive punësimi;
- të përmirësojë infrastrukturën për ofrimin e shërbimeve për emigrantët;
- të forcojë agjencitë private të punësimit për të pasur një performancë më të mirë dhe për t'u siguruar që të drejtat të zbatohen.
- të rrisë bashkëpunimin me vendet e tjera për menaxhimin e emigracionit për punësim përmes marrëveshjeve dypalëshe të punësimit;
- të njohë kualifikimin profesional dhe trajnimin e fituar jashtë vendit;
- të përafrojë rregullisht legjislacionin për imigracionin për motive e punësimi me atë të BE-së.

#### **Strategjia për Punësimin dhe Aftësitë (2014-2020)**

Të merren masa dhe të zhvillohen aktivitete që synojnë menaxhimin e migracionit të rregullt për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, migracionin e kthimit, si dhe imigracionin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë. (p.sh. trajnimi profesional

falas sipas identifikimit të nevojave të tyre, nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Shtetëror)

#### **Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (2014-2020)**

#### **Strategjia për Biznesin dhe Investimet (2014-2020)**

#### **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe Përfshirjen Sociale (2019-2022)**

- Të avancojë Programin e Mbrojtjes Sociale të Ndhmës Ekonomike, Vlerësimin Bio-Psiko-social dhe Pagesat e Aftësisë së Kufizuar, dhe Shërbimet Sociale,
- Të forcojë bashkëpunimin të qeverisjes qendrore dhe vendore.
- Të ndërhyjë dhe riintegrojë fëmijët në familje dhe komunitet dhe të ofrojë shërbime të integruara.
- T'i japë përparësi sigurimit të burimeve të nevojshme për grupet më të pambrojtura (përfshirë migrantët).

#### **Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (2016-2020)**

- Të harmonizohen më tej politikat dhe praktikat e BE-së.
- Të forcohet bashkëpunimi dypalësh operacional ndërkufitar (krijimi i patrullave të përbashkëta) si dhe pjesëmarrja në projekte dhe iniciativa rajonale.

#### **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2016-2020**

Të krijohet një sistemi efektiv të qeverisjes së migracionit në Shqipëri, përmes arritjes së objektivave të mëposhtëm strategjikë:

- Të promovohen rrugë të sigurta dhe të rregullta të migracionit në Shqipëri për të parandaluar migracionin e parregullt, në mënyrë që të orientohet 70% e migracionit nga Shqipëria përmes marrëveshjeve të rregullta dypalëshe (ekzistuese dhe marrëveshje të reja me BE dhe vendet anëtarë të BE;
- Të rritet ndikimi i emigracionit në zhvillim duke krijuar mekanizma favorizues ligjorë dhe institucionalë;
- Të rritet qëndrueshmëria e migracionit të kthimit duke mbështetur ri-integrimin e emigrantëve të kthyer;
- Të zbatohet, në një nivel të përparuar, politika e migracionit, për të siguruar trajtim të barabartë të shtetasve të vendeve të treta dhe integrimin e tyre në Shqipëri, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Të konsolidohet politika e migracionit, kuadri ligjor, strukturat e menaxhimit dhe koordinimit, për të siguruar një përgjigje më të mirë ndaj sfidave të migracionit.

#### **Strategjia e Diasporës (2018-2024), synon:**

- rritjen e bashkëpunimit të institucioneve shtetërore me komunitetet shqiptare jashtë vendit;
- krijimin e bazës së të dhënave për migrantët;
- promovimin e politikave me vendet pritëse për integrim;
- nxitjen e mësimin të gjuhës shqipe;
- marrjen e shtetësisë;
- Trajnim në fushën e migracionit mbi legjislacionin, të drejtat e tyre, etj.

#### **Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2018-2020 synon:**

- forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve përkatëse dhe OShC-ve të specializuara në këtë fushë, si dhe përmirësimin e harmonizimit të politikave kombëtare;

- 
- Vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së migrantëve të parregullt, veçanërisht mbrojtjes së grupeve të pambrojtura dhe përmirësimit të identifikimit të viktimave të trafikimit mes migrantëve.

**Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019-2022 synon:**

- Qeverisje strategjike të migracionit nga institucionet shqiptare;
- Migracion të sigurt dhe të rregullt nga, përmes, dhe drejt Shqipërisë;
- Politika të efektshme të migracionit për motive punësimi dhe ndikimin e migracionit në zhvillimin lokal;
- Integrimin e migrantëve dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.

## C.4 Hyrja, Vizat, Lëvizja dhe Qëndrimi i të Huajve

***Migracioni i sigurt, i rregullt dhe dinjitoz është një nga objektivat kryesore strategjike që shtetet dëshirojnë të arrijnë.***

Shqipëria vazhdon të marrë masat e kërkuara për të siguruar, ndër të tjera, politika të efektshme të hyrjes dhe qëndrimit. Shqipëria ka kompetenca sovrane tepër të gjera për sa i përket pranimit të të huajve në territorin e saj. Edhe pse drejta kombëtare dhe ndërkombëtare e njeh parimin e lirisë së lëvizjes, fusha e saj e zbatimit është relativisht e ngushtë.<sup>ccl</sup> Gjithashtu, arsyet legjitime për **refuzimin e pranimit** janë shumë të gjera dhe përfshihen në nocionet e rendit publik (p.sh. arsye të bazuara në dënime të mëparshme penale, shkelje të mëparshme të legjislacionit të imigracionit, risk i imigracionit të parregullt, shkaqe ekonomike), sigurisë kombëtare dhe shëndetit publik.<sup>ccli</sup>

Hyrja e të huajve në Shqipëri ndodh vetëm në pikat e kalimit të njohura dhe të përcaktuara me ligji dhe bazuar në dokumentacionin e plotë dhe të pranueshëm për autoritetet shqiptare si më poshtë.

**Kërkesat për hyrje, në përputhje me specifikat e *Acquis Communautaire* janë:**

- Dokument i vlefshëm udhëtimi;
- Vizë hyrjeje ose leje qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente shqiptare;
- Mjete financiare, sipas parashikimeve të akteve nënligjore;
- I huaji të mos jetë subjekt i një urdhri largimi ose refuzimi.<sup>cclii</sup>

Lëvizjet hyrëse në dhe dalëse nga Shqipëria i nënshtrohen monitorimit, si dhe garancive ligjore. Komponentët kryesorë për një kuadër të menaxhimit të kufirit janë të dhënat, teknologjia, stafi i trajnuar, aftësia kundër mashtrimit dhe e kontrollit, si edhe partneritetet strategjike.

*Teknologjia* mund të përmirësojë proceset e menaxhimit efektiv të kufirit, por nuk zëvendëson legjislacionin e duhur, procedurat e hartuara mirë dhe stafin e trajnuar dhe me përvojë që mund të kryejë funksionet kryesore. *Të dhënat* përdoren për të përshkruar, reflektuar dhe kuptuar më mirë tendencat e migracionit dhe për të marrë vendime më të informuara të politikave në lidhje me të gjitha aspektet e migracionit. Të dhënat bruto mbledhen, përpunohen dhe analizohen për të nxjerrë informacion domethënës që është i dobishme për politikëbërësit dhe profesionistët në fushën e migracionit. Megjithatë, të dhënat e sakta dhe të përditësuara të migracionit janë gjerësisht të pamjaftueshme në ditët e sotme. Mbledhja e të dhënave operacionale të besueshme dhe të përdorshme kërkon vëmendje të kujdesshme për përputhshmëri ndërmjet përkufizimeve të të dhënave dhe metodave të mbledhjes së të dhënave. Të dhënat duhet të jenë koherente në mënyrë që të shkëmbehen në mënyrë të dobishme mes sistemeve të ndryshme të të dhënave. Të dhënat operacionale janë të nevojshme për:

- të alokuar dhe menaxhuar burimet e aplikuara për menaxhimin e migracionit;
- të mbështetur analizën e inteligjencës së migracionit;
- të përcaktuar masën në të cilën politikat po bëjnë atë që supozohet të bëjnë; dhe
- të përcaktuar masën në të cilën shmangen pasojat e padëshiruara negative.

Të dhënat operacionale nuk janë vetëm një burim kombëtar. Shkëmbimi dhe ndarja e të dhënave mes vendeve mund t'i shtohet ndjeshëm aftësisë për të menaxhuar migracionin.<sup>ccliii</sup>



Të dhënat mbi migracionin mbliidhen dhe publikohen rregullisht nga Instituti Kombëtar i Statistikave, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Total, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përafrimit dhe Drejtoria e Azilit.

**Monitorimi** sigurohet përmes Sistemit Total të Menaxhimit të Informacionit (TIMS) dhe Regjistrat Elektronik për të Huaj (FER). Sistemi i bazës së të dhënave TIMS është i lidhur me sistemin e Interpolit, duke bërë të mundur që policia kufitare të identifikojë personat e kërkuar ndërkombëtarisht, automjetet e vjedhura dhe dokumentet e udhëtimit të humbura/vjedhura. Shqipëria është e para nga vendet e Ballkanit Perëndimor ku Marrëveshja e Statusit të Kufirit dhe Rojës Bregdetare Evropiane me BE ka hyrë në fuqi në maj 2019. Operacionet e përbashkëta me Frontex, ku skuadrat vendosen së bashku me rojet kufitare shqiptare në kufirin Greko-Shqiptar, kanë rezultuar të suksesshme në forcimin e kontrolleve kufitare, rritjen e sigurisë në kufijtë e jashtëm të BE-së dhe luftën kundër kontrabandimit të migrantëve.

**Garancitë ligjore** sigurohen nga një kuadër ligjor shumë gjithëpërfshirëse që përfshin **Ligjin për të Huajt, Ligjin për Azilin** dhe aktet nënligjore përkatëse, si akte kryesore ligjore që rregullojnë procedurën për përzgjedhjen e të huajve me synim diferencimin mes kategorive të ndryshme të personave në lëvizje, siç janë azilkërkuesit, të miturit e pashoqëruar, viktimat ose viktimat të mundshme të trafikimit dhe migrantët pa dokumente, në mënyrë që atyre t'u jepet ndihma e duhur. Gjithashtu, dy akte ligjore, përkatësisht **Ligji Nr. 18/2017 për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Ligji Nr. 121/2016 për Shërbimet Sociale** parashikojnë masa specifike mbrojtëse për fëmijët dhe personat në nevojë për mbrojtje / kategori të pambrojtura. Ndër parimet e përgjithshme dhe garancitë mund të përmenden parimi i moskthimit, mbrojtja nga persekutimi, njohja e mbrojtjes ndërkombëtare ose statusi i mbrojtjes plotësuese, ndihma juridike, shërbimet e përkthimit, interesi më i mirë i fëmijës, informacione dhe këshilla në pikat e kalimit të kufirit dhe në institucionet për ekzekutimin e dënimeve penale në lidhje me aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare, etj.

### **C.4.1. Regjimi i vizave**

Politika e vizave luan një rol të rëndësishëm në uljen e incidencës së migracionit të parregullt në Shqipëri.

**Sistemi E-Visa** funksionon për të regjistruar të gjithë shtetasit e huaj që aplikojnë për vizë kur hyjnë në vend. Sistemi është funksional brenda sistemit TIMS dhe lejon që i gjithë procesi i aplikimit të përfundojë në internet. Një instrument tjetër që ndihmon në mbajtjen në minimum të qëndrimit dhe tranzitit të parregullt është aplikimi i kontrolleve të synuara dhe përdorimi efektiv i masave për qëndrim të parregullt.

Vizat lëshohen nga:

- **Ministria e Punëve të Jashtme**, si institucioni përgjegjës për lëshimin e vizave për të huajt, të cilëve u kërkohet të kenë një vizë për hyrje, qëndrim ose kalim tranzit përmes Republikës së Shqipërisë.<sup>ccliv</sup>

- **Përfaqësuesit e vendeve të treta**, të cilët bazuar në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe do t'u lëshojnë vizë të huajve për hyrje, qëndrim ose kalim tranzit përmes Republikës së Shqipërisë.
- **Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin**, i cili, në raste të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj, do t'u lëshojë të huajve viza kufitare për hyrje, qëndrim dhe kalim tranzit përmes Shqipërisë në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara nga ligji për të Huajt.

Kohëzgjatja e vizës mund të shtyhet vetëm për shkak të forcës madhore ose për arsye humanitare. Gjithashtu mund të anulohet ose të refuzohet.

Figura 9 - Llojet e vizave në RSH

<p><b>Viza tipi "A"</b> është viza transit në aeroport që i jep të drejtën mbajtësit të</p> <p>hyjë dhe të qëndrojnë në zonën për qarkullim ndërkombëtar të aeroportit deri në nisjen e fluturimit për në vendin e destinacionit. Vlefshmëria e kësaj vize jepet në përputhje me kohën dhe rezervimet e biletave për udhëtimin/et, në të cilin/at aplikuesi parashikon të kalojë transit.</p> <p><b>Kohëzgjatja:</b> me një, dy ose shumë hyrje. Periudha e vlefshmërisë nuk është më shumë se 6 muaj.</p>	<p><b>Viza tipi "C"</b> e cila i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë deri në 90 ditë brenda 180 ditëve, duke filluar nga data e hyrjes së parë.</p> <p><b>Kohëzgjatja:</b> me një, dy ose shumë hyrje. Periudha e vlefshmërisë nuk është më shumë se 5 vjet.</p>	<p><b>Viza tipi "D"</b> e cila jepet për shtetas të huaj, të cilët kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë për 180 ditë dhe kur, për t'u pajisur me leje qëndrimi, për këta shtetas kërkohet vizë.</p> <p><b>Qëllimi i hyrjes:</b> vizë për veprimtari ekonomike, profesionale, tregtare, veprimtari punësimi, qëllime studimi, bashkim familjar, veprimtari humanitare ose fetare, vizë diplomatike ose vizë shërbimi, vizë për qëllime punësimi stinor, vizë për motive humanitare.</p>
--	--	--

## C.4.2 Qëndrimi i shtetasve të huaj

I huaji mund të qëndrojë në Shqipëri për një periudhë afatshkurtër, për një periudhë të përkohshme, si dhe të përhershme.

Ligji për të Huajt ka pësuar përmirësime të vazhdueshme, duke prekur aspekte të ndryshme të procedurave të qëndrimit, vizave dhe lejes së punës për punonjësit e huaj dhe të vetëpunësuarit në Shqipëri.

Qëndrimi për një periudhë afatshkurtër nuk mund të kalojë afatin 90 ditë për 180 ditë, në bazë të vizës së lëshuar apo hyrjes pa vizë, përjashtuar kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj ose në marrëveshje të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëndrimi për një periudhë të përkohshme dhe të përhershme mund të realizohet vetëm nëpërmjet pajisjes së të huajit me leje qëndrimi.

### Llojet e lejeve të qëndrimit

Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis me njërin nga llojet e lejeve të qëndrimit të mëposhtme të huajt, të cilët kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për një afat më shumë se 90 ditë në 180 ditë dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin për të huajt:

- **Leje qëndrimi e tipit “A”**, jo e ripërtëritshme, e cila i jep të drejtën mbajtësit të qëndrojë në Shqipëri brenda afatit kohor për të cilën ajo lëshohet;
- **Leje qëndrimi e tipit “B”**, e cila lëshohet me afat të përcaktuar dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Shqipëria brenda afateve të përcaktuara në të;
- **Leje qëndrimi e tipit “C”**, e cila lëshohet me afat të përhershëm dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Shqipëria;
- **Leje qëndrimi e tipit “S”**, e ripërtëritshme pas një ndërprerjeje 6-mujore, e cila lëshohet për punëtorët stinorë dhe i jep të drejtë mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Shqipëria brenda afateve të përcaktuara në të;
- **Leje qëndrimi “Kartë Blu AL”**, e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Shqipëria brenda afateve të përcaktuara në të;

**Leje qëndrimi “Kartë Blu AL-C”**, e cila lëshohet me afat të përhershëm vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Shqipëria.

Tabela 5 - Lloje specifike të lejeve (nenet 47-60)

<b>Punësim stinor</b>	Me afat jo më shumë se 6 muaj brenda një viti kalendarik, me të drejtë ripërtëritje deri në 5 vite radhazi, njëri pas tjetrit, me kusht që koha nga një leje në tjetrën të kalojë afatin 6 muaj.
<b>Të trajnuar pa pagesë</b>	Me afat jo më shumë se 1 vit, kur vlerësohet se dokumentacioni i paraqitur plotëson kërkesat për marrjen e një lejeje qëndrimi dhe vetëm kur rezulton se aktiviteti i synuar është i lidhur ngushtësisht me rritjen e aftësive, kualifikimin e të huajit dhe i kufizuar në kohëzgjatje.
<b>Shkëmbime rinore</b>	Me afat jo më shumë se 1 vit, vetëm kur aktiviteti i synuar është i lidhur ngushtësisht me shkëmbimin rinor apo skemën e lëvizshmërisë rinore, të parashikuar në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe i kufizuar me kohëzgjatje.
<b>Shërbime vullnetare</b>	Me afat jo më shumë se 1 vit, vetëm kur aktiviteti i synuar është i lidhur ngushtësisht me skemën e shërbimit vullnetar, ligjërisht të njohur në Republikën e Shqipërisë dhe i kufizuar në kohëzgjatje, si

	dhe kur plotëson kërkesat për marrjen e “lejes së qëndrimit për shërbime vullnetare”.
<b>Kërkim shkencor</b>	Me afat jo më shumë se 1 vit, të huajin i cili ka lidhur një marrëveshje me një institucion shqiptar për këtë qëllim dhe që plotëson kushtet e përgjithshme për pajisje me leje qëndrimi.
<b>Qëllime studimi</b>	Pranë një institucioni arsimor publik apo privat të njohur nga shteti shqiptar, ka të drejtë të aplikojë për leje qëndrimi me afat jo më shumë se një vit, kur lëshohet për herë të parë dhe mund të shtyhet çdo herë me një vit deri në përfundimin e shkollës, të studimeve ose të praktikës.
<b>Leje e përkohshme qëndrimi e tipit “A” për arsye humanitare</b>	Leja e qëndrimit në këto raste është e kufizuar dhe nuk mund të kalojë në kohë afatin 6 muaj dhe nuk mund të rinovohet. Leja e qëndrimit e lëshuar për këtë motiv shërben vetëm për qëndrimin e të huajit dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rast se i huaji del nga territori.
<b>Leje e përkohshme qëndrimi e tipit "A", për viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit</b>	Për një afat 3-mujor, të huajin, pavarësisht nga vullneti i tij/saj <b>për të bashkëpunuar me drejtësinë</b> , kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se i huaji është <b>viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit</b> , e identifikuar si e tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit. Kjo leje qëndrimi i jepet viktimës ose viktimës së mundshme të trafikimit me qëllim që të rimarrë veten, si dhe të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë.
<b>Leje qëndrimi tipi "B" për të huajin viktimë të trafikimit</b>	të identifikuar si të tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit, në njërën ose tjetrën prej dy situatave të mëposhtme ose në të dyja këto situata: a) vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për shkak të situatës sociale dhe personale; b) vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për qëllim të bashkëpunimit me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal.
<b>I huaji, i cili është anëtar i familjes së një shtetasi/e shqiptar/e.</b>	Pajiset me leje qëndrimi me afat jo më shumë se një vit për herë të parë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në marrëveshje apo në këtë ligj. Leja e qëndrimit ripërtërihet më pas për një periudhë dyvjeçare. Ky përcaktim vlen edhe për të miturin, i cili nuk është i martuar dhe për të cilin i huaji është kujdestar ligjor.
I huaji nuk pajiset me leje qëndrimi ose leja e qëndrimit i anulohet, nëse vërtetohet se martesë është fiktive.	

**Leja e qëndrimit lëshohet pas paraqitjes së aplikimit nga i huaji personalisht, dhe kohëzgjatja e saj është si më poshtë:**

- 3 muaj, 6 muaj ose 1 vit që mund të rinovohet jo më shumë se 5 herë radhazi;
- 2 vjet, që mund të rinovohet jo më shumë se një herë;
- 5 vjet, sipas dispozitave të këtij ligji;
- e përhershme, në rast se i huaji është me qëndrim të ligjshëm për 5 vjet rresht në Shqipëri dhe ka lidhje ose aktivitete të qëndrueshme në vend. (Neni 34)

**Lëshimi - Rinovimi - Refuzimi i Lejes– Arsyet e anulimit:**

- I huaji **nuk ka arritur të paraqesë kërkesën ose të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të caktuar** dhe nuk paraqet arsye të besueshme për të justifikuar mos kryerjen e këtij veprimi
- I huaji **nuk është në gjendje të provojë se i plotëson ose nuk i plotëson më kushtet** e kërkuara për qëndrim, sipas kritereve të kërkuara;
- I huaji është **objekt i largimit nga territori** i Shqipërisë;
- **Martesa është zgjidhur**, në rast se i huaji ka marrë lejen e qëndrimit për shkak të bashkimit familjar;
- **Arsyet për të cilat është lëshuar leja e qëndrimit nuk ekzistojnë më**, përveç në rrethana të jashtëzakonshme, nëse qëllimi i qëndrimit nuk ekziston më ose ka ndryshuar për shkak të trajtimit shëndetësor, ndërprerja e të cilit kërcënon humbjen e jetës, bashkimit familjar ose për arsye humanitare.

Refuzimi i lëshimit, ripërtëritjes, apo anulimit të lejes së qëndrimit i **njoftohet kërkuesit/mbajtësit me shkrim**, dhe duhet të përmbajë, *ndër të tjera*, **arsyen e refuzimit**, detyrimet që rrjedhin për të huajin, si pasojë e refuzimit të lëshimit, ripërtëritjes, apo anulimit të lejes së qëndrimit. Kundër vendimit negativ, i huaji ka të drejtën e ankimit - administrativ tek autoriteti epror i

drejtpërdrejtë i autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, si dhe në rrugë gjyqësore. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ dhe ajo gjyqësor **nuk duhet të kalojë më shumë se 60 ditë** nga dita e njohjes së të huajit me urdhrin e refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo të anulimit të lejes së qëndrimit.

Për arsye shëndetësore të provuara apo humanitare, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund të shtyjë afatin e ekzekutimit të masave detyruese ndaj të huajit, subjekt i urdhrin të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo të anulimit të lejes së qëndrimit, apo të akteve të tjera të nxjerra në vijim të këtij urdhri.

## C.5. Migracioni i Parregullt

**Forcimi i përgjegjes ndaj migracionit të parregullt nga, në dhe përmes Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian mbetet një objektiv strategjik.**

Migracioni i parregullt paraqet sfida të shumta për vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit, si dhe për vetë migrantët. Ulja e migracionit të parregullt kërkon zhvillimin e politikës për kthimin, si dhe kontrollin e kufirit, me legjislacion specifik gjithashtu për krijimin e rrugëve ligjore dhe të sigurta për migracionin, si dhe fokusimin në qëndrimin/punësimin, si mënyra e vetme për të balancuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive flukset migratore.<sup>cclv</sup>

Migracioni përmes rrugëve të parregullta është një fenomen ekzistues në Shqipëri, ku bëhen përpjekje të vazhdueshme gjithëpërfshirëse për të zvogëluar migracionin e parregullt. **Autoritetet përgjegjëse** në fushat e migracionit të parregullt janë **Ministria e Punëve të Brendshme** përmes strukturave përfshirë **Policinë e Shtetit, Departamentin e Kufirit dhe Migracionit, Departamentin kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, Drejtorinë e Azilit, Drejtorinë Anti-trafik.**

**Departamenti për Kufirin dhe Migracionin** përmes strukturave të tij qendrore dhe lokale është përgjegjës për:

- parandalimin dhe luftën kundër migracionit të parregullt përmes menaxhimit të integruar të kufirit;
- kontrollin e ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor dhe marrjen e masave të largimit vullnetar, dëbimit, ndalimit të të huajve të parregullt në territor dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës ose vendin tranzit nga vijnë;
- zbatimin e Marrëveshjeve të Ripranimit me vendet e tjera; pritjen, intervistimin e qytetarëve të kthyer në kufi dhe informimin e tyre mbi mundësitë e riintegritimit në vend;
- bashkëpunimin rajonal dhe më të gjerë në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin e parregullt dhe paralajmërimin e hershëm; kontrollin e të huajve të parregullt në kufi ose në brendësi dhe referimin e tyre në mekanizmin përkatës;
- identifikimin dhe trajtimin e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit të personave në zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin, referimin dhe ndihmën për viktimat e mundshme të trafikimit; përfshirë të miturit e pashoqëruar në lidhje me luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të personave.

Kontrulli efektiv dhe menaxhimi i migracionit të parregullt arrihet përmes bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet Departamentit për Kufirin dhe Migracionin me **Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë**, autoritetin vendimmarrës përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe përgjegjës për trajtimin e kërkesave, përpunimin, zhvillimin e seancave dëgjimore dhe mbledhjen e të dhënave të tjera të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për secilën kërkesë për azil.

**Drejtoria Antitrafik** merret vetëm me monitorimin, koordinimin, promovimin dhe orientimin e veprimtarisë së strukturave qendrore / vendore në çështjet e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

**Kuadri ligjor i zbatueshëm që adreson** migracionin e parregullt është përmirësuar vazhdimisht. Fillimisht rregullohej nga **ligji nr. 9668, datë 18.12.2006 "Për emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi"**, i ndryshuar, i cili përkufizonte "migrant i parregullt" si çdo shtetas shqiptar që nuk plotëson të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara nga vendi pritës për hyrje, tranzit, qëndrim dhe ushtrim të një aktiviteti të përkohshëm, jotregtar ose publik në territorin e këtij të fundit".<sup>cclvi</sup>

**Ligji nr. 108/2013 "Për të huajt"**, i ndryshuar në vitin 2020 dhe aktet në zbatim të tij, ka shënuar shumë përmirësime edhe në lidhje me procedurat për trajtimin e të huajve të parregullt, përfshirë luftën kundër migracionit të parregullt, si dhe të miturve të pashoqëruar, hyrjen e paligjshme, qëndrimin, punësimin, martesat fiktive, përgjegjësitë e transportuesve etj.

**Ligji nr. 10/2021 "Për azilin"**, i cili është në përputhje me disa Direktiva të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, paraqet kushtet dhe procedurat për dhënien dhe anulimin e azilit, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkesve, refugjatëve dhe personave në mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, të drejtat për ribashkimin e familjes dhe gjithashtu përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve dhe personave nën mbrojtje plotësuese në Shqipëri.

**Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"** synon të luftojë migracionin e parregullt duke krijuar mundësi punësimi në vend.

Për të ndëshkuar dhe parandaluar emigracionin e parregullt, veprat penale të përfshira në **Kodin Penal** janë: *Trafikimi i personave të rritur (neni 110 / a)*, *Trafikimi i grave (neni 114 / b)*, *Trafikimi i të miturve (neni 128 / b)*, *Falsifikimi i dokumenteve të identitetit, pasaportave ose vizave (neni 189)* *Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetërorë (neni 297)*, *Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve (neni 298)*.

**Shtetasit e huaj që kapen nga policia shqiptare në kufi ose në vend i nënshtrohen procedurave të posaçme të pritjes, intervistimit dhe më pas kontrollit.** Një nga qëllimet e procesit është **vlerësimi i vulnerabiliteteve dhe nevojave specifike, ose identifikimi i treguesve** të trafikimit të genieve njerëzore.

Kthimi në vendin e lindjes mund të jetë vullnetar ose i detyruar. Kthimi vullnetar mund të jetë spontan ose i ndihmuar.

Kthimi Vullnetar i Asistuar dhe Riintegrimi (KVAR) është mbështetja administrative, logjistike ose financiare, përfshirë ndihmën për riintegrim, për migrantët që nuk janë në gjendje ose të gatshëm të qëndrojnë në vendin pritës ose vendin e tranzitit dhe të cilët vendosin të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

"Kthimi i detyruar një lëvizje migratore që edhe pse shtysat mund të jenë të ndryshme, karakterizohet nga një element force, detyruës, ose shtrëngues." cclvii

Individët që kanë të drejtë për ndihmë për kthim përfshijnë migrantë në një situatë të parregullt të kapur nga autoritetet shqiptare, migrantë të parregullt të bllokuar në Shqipëri që kërkojnë vullnetarisht të kthehen në vendin e tyre të origjinës dhe azilkërkuës kërkesa e të cilëve është refuzuar dhe nuk kanë asnjë mënyrë për t'u kthyer në vendin e tyre. Një **paketë standarde** u jepet të kthyerve sidomos informacion, ndihmë psikologjike, pritje para kthimit dhe transport.<sup>cclviii</sup>

### ■ C.5.1 Refuzimi i hyrjes

Ligji për të Huajt përcakton "Ndalimin e hyrjes" si një masë administrative kufizuese ndaj një të huaji, të deklaruar në një vendim administrativ ose gjyqësor, i cili ndalon hyrjen dhe qëndrimin në Republikën e Shqipërisë për një periudhë të caktuar kohe (neni 3, seksioni 24).

I huaji që synon të hyjë, qëndrojë dhe tranzitojë dhe të dalë nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve të azilit dhe kur përcaktohet ndryshe nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe, duhet të paraqitet personalisht në pikën e kalimit kufitar pas përmbushjes së kushteve siç përcaktohet në nenin 6 të Ligjit për të Huajt:

- të mbajë një dokument të vlefshëm udhëtimi të njohur nga Republika e Shqipërisë me një periudhë vlefshmërie të paktën 3 muaj para datës së skadimit të tij;
- të jetë pajisur me një vizë të vlefshme hyrjeje nëse kërkohet ose leje qëndrimi e vlefshme e lëshuar nga autoritetet kompetente shqiptare, ose e lëshuar nga vende të tjera dhe e njohur nga Republika e Shqipërisë;
- të mos jetë kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera;
- të mos ketë vërejtje në regjistrin elektronik kombëtar që ndalojnë hyrjen e të huajit;
- të mos përbëjë kërcënim për shëndetin publik në Republikën e Shqipërisë;
- të mos jetë debtor për shkak të masave administrative të vendosura ndaj tij, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- bazuar në vlerësimin rast pas rasti, nga i huaji mund të kërkohet të paraqesë dokumente të tjera shtesë, të cilat lloji miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Hyra e një të huaji në territorin e Shqipërisë bëhet edhe për arsye të deklarimit "persona non grata" me një urdher të motivuar të Ministrit të Brendshëm (Art.9).

Urdhri lëshohet kur i huaji:

- vepron ose propagandon kundër sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, sigurisë kombëtare, rendit kushtetues dhe rendit dhe sigurisë publike;
- është anëtar i organizatave terroriste ose mbështet dhe ndërmerr veprime anarkiste kundër sundimit të ligjit;
- është një kërcënim për vendin ose kërcënon marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera;
- dyshohet se ka hyrë dhe qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë për të kryer një krim ose veprime që paraqesin kërcënim për Republikën e Shqipërisë;



- përfshihet në krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore, drogës dhe çdo trafikimi tjetër të paligjshëm, bazuar në informacionin e marrë nga institucionet përgjegjëse të sigurisë kombëtare.

Përpara se të vendosin të refuzojnë hyrjen e një shtetasi të huaj, autoritetet kufitare shqiptare përmes procesit të shqyrtimit paraprak të përbërë nga kontrolli i dokumentacionit dhe intervista paraprake, përcaktojnë statusin e migrantit ose si azilkërkues, një fëmijë i pashoqëruar, një viktimë e mundshme e trafikimit, një migrant i parregullt, ose si subjekt i ndalimit të hyrjes. Intervista zhvillohet në gjuhën e të huajit ose në gjuhën e njohur prej tij / saj. Intervista me një fëmijë kryhet në prani të të rriturve që e shoqërojnë atë, si dhe në prani të një psikologu ose punonjësi social. Gratë intervistohen nga një oficer policie.

Kjo procedurë kryhet në kufi ose brenda territorit të Shqipërisë dhe do të përfundojë brenda 10 orësh nga momenti i shoqërimit të të huajit. Nëse për arsye të justifikuara, procedura e përzgjedhjes nuk përfundon brenda afatit të caktuar, një njoftim u dërgohet autoriteteve rajonale / lokale përgjegjëse për trajtimin e të huajve dhe një shënim i veçantë bëhet në regjistrin elektronik nën seksionin "Të Huajt e Parregullt". Shënimet bëhen në seksione të tjera të regjistrit bazuar në kategorinë e të huajve kombëtar.

Për më tepër, kur refuzon hyrjen, zyrtari përgjegjës, ndër procedurat e tjera, duhet:

- të plotësojë një formular standard për refuzimin e hyrjes;
- t'i japë një kopje të formularit shtetasit të huaj që është subjekt i vendimit;
- të vendosë një vulë hyrëse në pasaportë, anuluar me një kryq të zehtë që nuk fshihet;
- hollësitë e çështjes janë futur në sistemin e kontrollit kufitar TIMS;
Shqipëri - Synon rritjen e investimeve në bujqësi dhe turizëm përmes zhvillimit të agroturizmit, rritjes dhe zhvillimit të bizneseve agro-përpunuese. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mund të lehtësojë thithjen e fondeve të BE-së nga të gjithë shtetasit shqiptarë, përfshirë migrantët, përmes projekteve që promovojnë investime në bujqësi (fondet IPARD dhe SARED) ose uljes së taksave për makineritë bujqësore.

Programi 3x1 për Migrantët në Meksikë- mbështet nismat e meksikanëve që jetojnë jashtë vendit dhe u jep atyre mundësinë për të kanalizuar burimet e tyre në punë me ndikim social që janë direkt në përfitim të komuniteteve të tyre të origjinës në Meksikë. Projekti është zbatuar me ndihmën e klubeve ose federatave të migrantëve që jetojnë jashtë vendit, Qeverisë Federale dhe shtetit dhe qeverisjes vendore. Është një skemë financimi përmes së cilës për çdo peso e dërguar nga migrantët, qeveritë federale, shtetërore dhe vendore shtojnë 3 peso secila, prandaj quhet programi 3x1. Fondet e mbledhura përdoren për punë publike që përmirësojnë infrastrukturën e komuniteteve lokale (rrugët, shkollat, shërbimet shëndetësore) dhe promovojnë zhvillimin ekonomik në vend.

**Moduli E**  
**STRATEGJIA E**  
**KOMUNIKIMIT**



# Disclaimer

Përmbajtja e këtij dokumenti “Manual Trajnimi për Qeverisjen e Migracionit dhe Strategjinë e Komunikimit për nëpunësit e shtetit Shqiptar” paraqet vetëm pikëpamjet e autorit dhe përgjegjësinë e tij apo të saj të vetme. Komisioni Evropian nuk pranon asnjë përgjegjësi për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që ai përmban.

Publikuar nga: Organizata Ndërkombëtare për  
Migracionin – Misioni në  
Shqipëri  
Rruga Brigada VIII, P. LID  
Kati III, Ap. 303  
Tirana, Shqipëri  
Tel.: +355 42257836-7  
Fax: +355 4225 7835  
Email: [infotirana@iom.int](mailto:infotirana@iom.int)  
Website: <http://www.albania.iom.int>

## E 1 – KRIJIMI I NJË STRATEGJI KOMUNIKIMI

### E.1.1 Strategjia e komunikimit - kuptimi

Komunikimi ka qenë përherë një faktor i rëndësishëm për suksesin e çdo institucioni, organizate apo projekti. Një strategji komunikimi mund të ndihmojë në sigurimin e informacionit që duhet të komunikohet, rritjen e ndërgjegjësimit, nxitjen e veprimeve, ndërtimin e konsensusit, promovimin e pjesëmarrjes së komunitetit dhe në fund ndryshimin e sjelljes. Komunikimi mund të ndikojë gjithashtu në identifikimin e shqetësimeve që mund të ngrihen dhe të sigurojë arritjen e audiencës së duhur. Strategjitë e komunikimit janë plane për komunikimin e informacionit në lidhje me një çështje specifike, ngjarje, situatë ose audiencë. Ato shërbejnë si plane për të komunikuar me publikun, palët e interesuara, apo edhe grupe shumë më të vogla. Një strategji komunikimi mund të marrë shumë forma a pamje të ndryshme, duke filluar nga një ndërveprim një-më-një deri në një fushatë mbarë botërore siç ka qenë pak kohe më parë në lidhje me pandeminë. Strategjia e komunikimit është gjithashtu "zgjedhja e objektivave të duhur të komunikimit dhe identifikimi i ndërgjegjësimit si dhe strategjisë së qëndrimit ndaj saj. Ato duhet të:

- Skicojnë objektivin/qëllimet e komunikimit
- Identifikojnë palët e interesuara
- Përcaktojnë mesazhet kryesore
- Përkrahin metodat e mundshme të komunikimit dhe mënyrat për komunikimin e informacionit për një qëllimi specifik, dhe
- Specifikojnë mekanizmat që do të përdoren e marrë reagime mbi strategjinë.

→ *Strategjitë e komunikimit janë plane për komunikimin e informacionit në lidhje me një çështje specifike, ngjarje, situatë ose audiencë.*

→ *Kur lindin ngjarje ose çështje të rëndësishme, një strategji komunikimi mund të ndihmojë në organizimin e informacionit që duhet të komunikohet, të identifikojë shqetësimet që mund të ngrihen dhe të sigurojë arritjen e audiencës së duhur.*

Strategjitë e komunikimit ndoshta nuk duhet të jenë domosdoshmërisht dokumente zyrtare të shkruara. Ato thjesht mund të përfshijnë marrjen e kohës për të menduar për një problem ose çështje komunikimi dhe përcaktimin e qasjes më të mirë për komunikimin e mesazhit ose informacionit të planifikuar.

Strategjia e komunikimit është gjithashtu një mjet institucional, biznesi dhe marketingu që ndihmon organizatat të harmonizojnë komunikimin e tyre dhe të prodhojnë mesazhe kuptimplotë dhe të harmonizuara. Këto strategji mund të fokusohen në komunikimet e brendshme ose të jashtme, ose të specifikojnë strategjinë e komunikimit për një projekt të caktuar. Strategjia zakonisht përshkruan planin për dërgimin e një mesazhi tek një audiencë e synuar, ndërsa përshkruan qëllimin, mënyrën se si të përmbushen detyrat dhe rezultatet e dëshiruara.

## ■ E.1.2 Përfitimet e të pasurit të një strategjie komunikimi

Zbatimi i një strategjie komunikimi ka një sërë përfitimesh, të cilat përfshijnë:

### - Rritja e qartësisë

Pasja e një strategjie komunikimi mund të ndihmojë në rritjen e qartësisë në lidhje me mënyrën e komunikimit me njëri-tjetrin ose me palë të treta për një çështje të caktuar. Pavarësisht nga lloji i strategjisë së komunikimit, ai është një mjet që përshkruan aspekte të ndryshme të komunikimit që janë të rëndësishme për audiencën dhe palët e interesuara. Rritja e qartësisë mund t'i ndihmojë ata të ndërveprojnë në mënyrë më efektive, pasi kanë një kuptim të mirë-zhvilluar të mesazheve kryesore dhe qëllimeve si dhe informacion të saktë e të plotë.

### - Drejton ndërveprimet

Nëse organizata vendos të zhvillojë një strategji komunikimi gjithëpërfshirëse, ajo mund të përdoret si një udhëzues për komunikimet e mëtejshme. Për shembull, nëse planifikojmë të ndërveprojmë me një grup a palë të tretë në shoqëri, ne mund t'i referoheni strategjisë së komunikimit për të përcaktuar qëllimet dhe objektivat për bisedën. Për më tepër, strategjia mund të përshkruajë audiencën specifike, mesazhet kryesore dhe detaje të tjera të rëndësishme që kontribuojnë në një fushatë të suksesshme komunikimi.

### - Ruan qëndrueshmërinë në përjasje

Një përfitim tjetër i strategjive të komunikimit është aftësia për të ruajtur qëndrueshmërinë në të gjithë fushatën apo pozicionin e organizatës. Qëndrueshmëria është e rëndësishme si për komunikimet e brendshme ashtu edhe për ato të jashtme. Ajo ndihmon të mendojmë se mund të mbështetemi në pozicionin e marrë dhe veprimet. Komunikimi i qëndrueshëm ndihmon duke rritur të kuptuarit dhe duke zvogëluar mundësinë për keq komunikim.

## ■ E. 1.3 Elementet e një strategjie komunikimi

Ky dokument i krijuar në kuadër të projektit të IOM për migrimin, përfaqëson një strategji të dedikuar komunikimi të mbështetur në rezultatet e një studimi **sasior** dhe **cilësor**. Kjo strategji komunikimi synon të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mundësisht të ndryshojë perceptimin dhe sjelljen ndaj migrimit të parregullt në Shqipëri. Mbështetur në gjetjet e hulumtimit dhe analizimin e kontekstit, fakteve dhe të dhënave, kjo strategji komunikimi synon të ndikojë në përmbushjen e objektivit kryesor të projektit: **uljen e numrit të personave që synojnë dhe përdorin kanale të parregullta të migrimit dhe njëkohësisht, kërkimin dhe evidentimin e mundësive në Shqipëri për t'u zhvilluar në aspektin personal, profesional dhe ekonomik si dhe ndarjen e informacionit mbi mundësitë e rregullta të migrimit.**

Siç përcaktohet nga IOM, kjo strategji do të jetë një gur themeli i projektit pasi shpalos mesazhet dhe elementet kyç për fushatën, mediat dhe kanalet e tjera të komunikimit për të përcjellë mesazhet tek popullata e përgjithshme në Shqipëri, si dhe diaspora shqiptare kryesisht në Belgjikë dhe Holandë. Kjo fushatë gjithashtu do të mbledhë reagimet që synojnë të ndryshojnë sjelljen në lidhje me perceptimin e popullatës së synuar për migrim.

→ Në fushën e komunikimit, ekzistojnë tre metodologji kryesore kërkimore: sasiore, cilësore dhe retorike. Në varësi të çështjes së komunikimit, strategjisë dhe zgjedhjes së studiuesve ata ka të ngjarë ta gjejnë veten duke përdorur njërën nga këto metodologji më shpesh se të tjerat,

Kjo strategji komunikimi është thelbësore për të përmbushur qëllimet dhe objektivat për çështjen e migrimit. Strategjia do të përmirësojë komunikimin brenda komunitetit dhe do të rrisë dukshmërinë përsa i përket çështjes në fjalë. Ajo gjithashtu do të përfaqësojë një plan veprimi të hartuar për të arritur qëllimet ose objektivat e komunikimit, për të dhënë mesazhet kryesore dhe për të ofruar një sërë rekomandimesh për të ardhmen.

Migrimi ka qenë, është dhe do të jetë pjesë e historisë së Shqipërisë. Kjo strategji komunikimi nuk synon ndalimin e migrimit dhe as dekurajimin e njerëzve për të zgjedhur mundësi të tjera jashtë Shqipërisë. Ajo që synon të bëjë është promovimi i metodave të rregullta të migrimit duke paraqitur kanalet e duhura të migrimit, duke u siguruar gjithashtu atyre që kanë më shumë gjasa të migrojnë, informim mbi mundësitë e zhvillimit personal dhe profesional që ofron Shqipëria.

#### ■ E.1.4 Qasja teorike

Kjo Strategji Komunikimi, është bazuar së pari në rezultatet e **kërkimit sasior** dhe **cilësor** të kryer, dhe së dyti, është bazuar në literaturën teorike lidhur me migrimin dhe teorinë e ndryshimit.

→ Ndërkohë marrja e një qasjeje me metoda të përziera rezultoi në një studim kërkimor që përdori dy ose më shumë teknika të trajtuara më sipër. Shpesh, studiuesit vendosin të çiftojnë dy metoda së bashku në të njëjtin studim duke ekzaminuar të njëjtin fenomen. Herë të tjera, studiuesit mund të përdorin metoda cilësore për të zhvilluar kërkime sasiore, të tilla si një studim që përdori një grup fokusi për të diskutuar vlefshmërinë e një sondazhi përpara se ai të finalizohet.

Për të ilustruar këtë strategji në rastin tone praktik hulumtimi sasior është gjykuar të kryhet me intervista të zhvilluara ballë për ballë me rreth 340 banorë shqiptarë të përzgjedhur rastësisht, duke respektuar moshën, gjininë dhe shpërndarjen rajonale të popullsisë së Shqipërisë (sipas statistikave zyrtare). Ky kampionim u përfordua me 100 intervista të tjera me individë që i përkasin grup moshës 18-40, duke i konsideruar ata si grup moshë me potencial të lartë për të

migruar. Periudha e mbledhjes së të dhënave u krye në muajin Qershor 2021.

Hulumtimi cilësor përfshiu 4 grupe diskutimi të fokusuara, pjesë e të cilave ishin individë që synonin të migronin. Gjithashtu, pjesë e hulumtimit cilësor ishte dhe kryerja e 14 intervistave të thelluara me individë që përbënin interes për projektin (persona që duan të migrojnë, të kthyer, diskutime me përfaqësues të institucioneve shtetërore, persona që nuk duan të migrojnë, qytetarë shqiptarë, shtetas shqiptarë me banim në Holandë dhe Belgjikë).

Për sa i përket qasjes teorike, ky dokument është bazuar në një përmbledhje të disa librave dhe publikimeve që lidhen me migrimin në përgjithësi dhe migrimin e shqiptarëve në veçanti. Një pjesë e rëndësishme e literaturës teorike të zgjedhur për të mbështetur këtë strategji është literatura e lidhur me teorinë e ndryshimit, e cila ndihmon shumë në konceptimin e një strategjie komunikimi.

### ■ E.1.5 Komunikimi për ndryshimin shoqëror dhe të sjelljes (SBCC)<sup>1</sup>

Strategjia e komunikimit për ndryshimin shoqëror dhe të sjelljes (*SBCC – Social and Behaviour Change Communication*) është një strategji e njohur që lidh analizën e situatës aktuale dhe zbatimin e një program komunikimi enkas për këtë synim.

SBCC synon të ndryshojë një qëndrim dhe sjellje të caktuar të një grupi të synuar, përmes mesazheve të përshtatura dhe një toni komunikimi të përzgjedhur. Strategjia synon t'u sigurojë individëve informacion, të tregojë sjelljet e duhura të nevojshme për të arritur qëllimin e dëshiruar dhe të krijojë një mjedis mbështetës që mund të përshpejtojë vetë ndryshimin e sjelljes. Përtej thjesht dhënies së një mesazhi, komunikimi për ndryshimin shoqëror dhe të sjelljes (SBCC) është aplikimi sistematik i strategjive të komunikimit të bazuara në teori dhe hulumtime kërkimore për të adresuar ndryshim dhe ndryshimin e nivelit individual brenda niveleve më të gjera mjedisore dhe strukturore.

### ■ E.1.6 Kuadri ekologjik i Bronfenbrenner për zhvillimin njerëzor<sup>2</sup>

Kuadri ekologjik i Bronfenbrenner për zhvillimin njerëzor pasqyron shtresat e shoqërisë - individin, familjen dhe bashkëmoshatarët, komunitetin, institucionet shoqërore e strukturat e tjera - dhe efektin e tyre. Fillimisht u prezantua si një model konceptual në vitet 1970 dhe më pas si një model teorik në vitet 1980.


Familja, të afërmit, miqtë dhe aktorët e komunitetit do të jenë fokusi i planit të komunikimit pasi ata ndihmojnë në vendimet e migrimit duke dhënë mbështetje financiare dhe këshillim. Si rezultat, kuadri ekologjik i Bronfenbrenner për zhvillimin njerëzor do të ndihmojë në ndryshimin e sjelljes së individëve.

<sup>1</sup> <https://www.thecompassforsbc.org/how-to-guides/how-develop-communication-strategy>

<sup>2</sup> <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/1059924X.2017.1358971>

Modeli ekologjik Bronfenbrenner shqyrton zhvillimin njerëzor duke studiuar sesi qeniet njerëzore krijojnë mjediset specifike në të cilat jetojnë, siç tregohet në figurën më poshtë.

Figura 17 - Modeli ekologjik (apo ekosistemi) Bronfenbrenner



Bazuar në qasjen e mësipërme, aktivitetet kanë për qëllim të ndikojnë në ndryshimin e sjelljes së grupeve të synuara me qëllim migrimin e parregullt, në disa nivele.

Siç u përmend me lart kjo përjasje i referohet institucioneve dhe grupeve që ndikojnë menjëherë dhe drejtpërdrejt në zhvillimin e individit duke përfshirë: familjen, shkollën, institucionet fetare, ambienti ku jeton dhe moshatarët.

Teoria e sistemeve ekologjike (apo ekosistemi) shpjegon se si zhvillimi njerëzor ndikohet nga lloje të ndryshme të sistemeve mjedisore. Studiuesit, politikë bërësit dhe praktikuesit janë të interesuar për mundësitë dhe rreziqet që lidhen me mënyrën se si të rinjtë e kalojnë kohën e tyre të lirë jashtë ditës së zakonshme të shkollës. Një nga mjediset kryesore në të cilat të rinjtë kalojnë orët e tyre jashtë shkollës janë aktivitetet e organizuara, të cilat përfshijnë aktivitete jashtëshkollore, programe pas shkollës dhe

aktivitete në organizata me bazë komunitare. Shumë kërkime mbi aktivitetet jashtë shkollës kanë përdorur teorinë e sistemeve ekologjike për të kuptuar se si aktivitetet nxisin zhvillim pozitiv dhe të shëndetshëm të të rinjve me prejardhje të ndryshme. Procesi i zhvillimit njerëzor mund të përcaktohet më saktë nga teoria e rishikuar ekologjike e Bronfenbrenner. Zhvillimi hipotetizohet të jetë produkt i përbashkët i katër vetive përcaktuese: (1) personi, (2) konteksti, (3) procesi dhe (4) koha. Së pari, faktorët e personit i referohen karakteristikave individuale, si mosha, gjinia dhe kompetenca, që ndërveprojnë me mjedisin për të ndikuar në zhvillimin. Faktorët e personit ndihmojnë në shpjegimin se kush merr pjesë kundrejt atij që nuk merr pjesë në aktivitete (të referuara edhe si efektet e "përzgjedhjes"), si dhe rolet që zënë të rinj të ndryshëm brenda mjedisit të aktivitetit dhe se si efektet e aktivitetit ndryshojnë midis individëve (të quajtura efekte moderatore). Vetia e dytë janë faktorët e kontekstit, përfshin katër sistemet e teorisë origjinale të sistemeve ekologjike të Bronfenbrenner të përshkruar më herët.

Mekanizmi primar i zhvillimit krijohet në vetinë e tretë, të quajtur faktorët e procesit, dhe përfaqëson ndërveprimet ndërmjet faktorëve të personit dhe kontekstit. Faktorët e procesit janë shkëmbimet komplekse reciproke midis një organizmi njerëzor aktiv, në zhvillim dhe mjedisit të tij të jashtëm të menjëhershëm, të quajtur procese të afërta (pranë individit). Zhvillimi nxitet kryesisht nga proceset të afërta që ndodhin rregullisht për periudha të gjata kohore. Megjithatë, për të përshkruar në mënyrë të saktë natyrën dinamike të zhvillimit, proceset e afërta duhet të kuptohen duke iu referuar veçorisë së katërt përcaktuese të zhvillimit, përkatësisht kohës. Proceset e afërta ndodhin në një kohë dhe vend të caktuar dhe brenda një historie të caktuar kontekst. Koha interpretohet në nivele të ndryshme të sistemit ekologjik.

### ■ E.1.7. Vlerësimi dhe përshtatja e qasjes

Ky projekt për Strategjinë e komunikimit synon të ndikojë në ndryshimin e sjelljes së grupeve me potencial të lartë për të migruar në mënyrë të parregullt, si dhe "mbështetësit" kryesorë. Një individ i mirë-informuar dhe "mbështetësi" kryesor do të mund të vlerësojë paraprakisht kostot dhe rreziqet e migrimit të parregullt gjatë udhëtimit, pas mbërritjes në destinacion dhe rikthimit në rast të një eksperience të dështuar migrimi. Për të shpërbërë mitet mbi migrimin, popullata e së synuar do të njihet me raste/histori alternative të cilat shpjegojnë rreziqet dhe kostot e migrimit të parregullt drejt BE -së, mundësive në Shqipëri dhe migrimin e rregullt.

Rezultati i pritshëm i projektit është: Rritja e ndërgjegjësimit të grupit të synuar dhe mundësisht ndryshim i perceptimit dhe sjelljes së tyre kundrejt migrimit të parregullt dhe alternativave të zhvillimit në vend ose migrimit të rregullt.

Objektivi specifik i projektit: Grupet e prirura për të migruar në mënyrë të parregullt, familjet dhe anëtarët e komunitetit të tyre që ndikojnë në vendim-marrje ("mbështetësit") do të shmangin migrimin e parregullt.

**Rezultati i pritshëm 1:** Qytetarët shqiptarë që konsiderojnë migrimin e parregullt në Europë janë të vetëdijshëm për rreziqet e migrimit të parregullt si dhe mundësitë ekzistuese ekonomike dhe arsimore në Shqipëri dhe kanalet e rregullta të migrimit në Europë.

**Rezultati i pritshëm 2:** Qeveria Shqiptare në nivelin qendror dhe lokal ka rritur kapacitetet dhe ka mjete shtesë për të mbështetur në mënyrë aktive parandalimin e migrimit të parregullt dhe promovimin e mundësive arsimore dhe ekonomike ekzistuese në Shqipëri, si dhe mundësitë e rregullta të migrimit në BE. Këto objektiva mund të ndiqen si mëposhtme:

*I. Një qasje “360 gradë” do të realizohet përmes:*

- një rrjeti me “influencues” me përvojë personale migrimi, që do të sensibilizojë përmes eventeve, rrjeteve sociale, mini projekteve, ndërjegjësimit, video mesazheve, etj.
- shpërndarjes së mesazheve përmes medias tradicionale dhe sociale, një aplikacioni në telefon dhe materialeve promovuese;
- dy personazheve publik të cilët do të mbështesin fushatën dhe do të shpërndajnë mesazhet.

Kjo do të mund të sigurojë që informacionet e pasakta të sfidohen përmes kanaleve të shumta dhe informacioni i saktë të arrijë tek të interesuarit.

*II. Përfshirja e aktorëve shtetërorë si dhe e Organizatave të Shoqërisë Civile do të përforcojë bashkëpunimin mes palëve nëpërmjet:*


- Disa seminareve
- Një bazë të dhënash mbi mundësitë që ofrohen në vend dhe mbi migrimin e rregullt
- Takime koordinuese

Është e rëndësishme të nënvizohet se projekti ka një qasje të përqendruar tek bashkëpunimi i rrjetit, duke synuar përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës dhe palëve të interesuara në faza dhe aktivitete të ndryshme. Bashkëpunimi efektiv me partnerët e diasporës do të sigurojë që projekti të ketë ndikim në nivel European dhe jo vetëm lokal si dhe do të përmirësojë koordinimin e palëve të interesuara me diasporën shqiptare në Belgjikë dhe Holandë në mënyrë që t'i përfshijë ata në përcjelljen e mesazheve të fushatës.

Në vijim janë hapat e teorisë së ndryshimit janë:



Figura 18 - Burimi i skicës: Materialet te IOM për Migrimin



## PYETJE

1	Çfarë është një strategji komunikimi?
2	Cilat janë përfitimet e një strategjie komunikimi?
3	Çfarë duhet të kemi parasysh në ndërtimin e një strategjie komunikimi?
4	Cilat janë nivelet e ekosistemit të Bronfenbrenner?
5	Cilat janë ndikimet në nivelin individual të ekosistemit Bronfenbrenner?
6	Cilat janë vetitë përcaktuese të ekosistemit të Bronfenbrenner?
7	Çfarë kuptojmë me objektiv të strategjisë së komunikimit?
8	Çfarë kuptojmë me qasje 360 gradë?
9	Çfarë kuptojmë me migrim të paligjshëm?
10	Çfarë nënkuptojmë me metodë të përzier kërkimi?

## E.2 – ANALIZA E SITUATËS

### E.2.1. Migrimi në Shqipëri, realiteti dhe sfidat

#### E.2.1.1. Të dhënat (e limituara) mbi migrimin

Migrimi i shqiptarëve nuk është një fenomen i kohëve të fundit por sidoqoftë, ka ritme dhe dinamika të ndryshme mes valëve të migrimit.

Nga viti 1945 deri në vitin 1991, Shqipëria ka përjetuar një nga regjimet totalitare më të ngurta dhe më të izoluar në të gjithë Evropën Lindore. Kjo është arsyeja pse një nga valët më të forta të migrimit të shqiptarëve përkoi me rënien e regjimit komunist. Gjendja e kaosit në këtë periudhë i çoi njerëzit drejt mënyrave ekstreme për të lënë vendin. Gjatë verës së vitit 1990, rreth 5000 persona hynë me forcë në ambasadat e huaja të vendosura në Tiranë duke kërkuar azil politik dhe shumica e tyre ia dolën për t'u larguar nga vendi. Vendet kryesore ku ata migruan ishin Greqia dhe Italia, ku shqiptarët ikën përmes Detit Adriatik për të arritur brigjet italiane apo përmes maleve për të arritur në Greqi.


Me rënien e skemave piramidale në 1997, Shqipëria u përfshi përsëri në një gjendje kaotike, duke shkaktuar një valë të re të migrimit masiv, të vlerësuar në rreth 100,000 individë të larguar nga vendi.

Për shkak të kompleksitetit të migrimit, për sa i përket përcaktimeve të terminologjisë dhe matjeve, të dhënat mbi migrimin ndërkombëtar në Shqipëri mbeten të kufizuara. Megjithatë të dhënat ekzistuese tregojnë se shifrat janë konsiderueshëm të larta. Sipas statistikave shqiptare, përgjatë viteve 1989 dhe 2001 rreth 700,000 shqiptarë ose rreth 20% e popullsisë u larguan nga vendi. Përgjatë viteve 2001 dhe 2011, statistikatat kombëtare tregojnë se rreth 480,000 shqiptarë kanë migruar në të gjithë botën<sup>3</sup>.

Deri në vitin 2017, bazuar në shifrat e Bankës Botërore, vendi kishte prodhuar një 'stok' prej 1,178,117 migrantësh, ekuivalent me 41% të popullsisë që banonte në Shqipëri.<sup>4</sup>

Aktualisht, Shqipëria po përjeton një valë tjetër migrimi, shpesh e shoqëruar me migrim të parregullt, kryesisht drejt vendeve të BE -së. Sipas Eurostat, numri më i lartë

Figura 19 - Përqindja e popullsisë shqiptare që ka migruar në vende të tjera



<sup>3</sup> Burimi: INSTAT – Instituti i Statistikave

<sup>4</sup>Burimi: Banka Botërore, Migrimi dhe Remitancat. Washington DC: Banka Botërore, 2018, f. 11

i kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë (përditësimi i fundit 12/03/20) u regjistrua në Francë, shteti anëtar i BE -së më i prekur në 2019, me 9235 kërkesa për azil të paraqitura nga shtetas shqiptarë.<sup>5</sup>

Në të njëjtin vit, Italia shënoi një rritje me 21% të kërkesave për azil në krahasim me

→ *Migracioni në formën e tij më të përgjithshme mund të ndahet në imigracion dhe emigracion, në varësi të lëvizjes brenda apo jashtë një vendi.*

→ *Imigracioni është lëvizja në këndvështrimin nga vendi i mbërritjes – lëvizja në një vend tjetër përveç vendit të kombësisë ose vendbanimit të zakonshëm kështu që vendi i destinacionit bëhet vendi i tij i ri i banimit të zakonshëm.*

→ *Emigracioni është lëvizja në këndvështrimin nga vendi i nisjes, pra lëvizja nga vendi i kombësisë ose vendbanimi i zakonshëm në një vend tjetër, kështu që vendi i destinacionit bëhet vendi i tij i ri i banimit të zakonshëm.*

vitin 2018, ndërsa Gjermania dhe Greqia shënuan rënie prej 11% dhe 8% respektivisht. Së bashku me Zonën Shengen, Shengen+ mbetet një destinacion për shumë qytetarë shqiptarë. Numri i kërkesave për azil në zonën Shengen+ në 2019 u ul për të katërtin vit radhazi. Midis 2018 dhe 2019, kërkesat ranë me 5%, me 18555 kërkesa për azil në 2019 krahasuar me 19,615 kërkesa në 2018.<sup>6</sup>

Në Belgjikë, sipas të dhënave të Eurostat për numrin e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë, prej vitit 2011 ka një rënie të dukshme, megjithatë numrat ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, shpesh duke shënuar rritje dhe ulje të ndryshueshme.<sup>7</sup>

Numri i shqiptarëve që kërkojnë azil në Holandë gjithashtu ka pasur luhatje gjatë gjithë periudhës 2011 - 2020, duke shënuar numrin më të lartë të kërkesave në 2015 dhe 2016 dhe më të ulët në

2020.<sup>8</sup>

Edhe pse kishte një tendencë në rënie, Shqipëria mbeti në krye të të gjitha vendeve pa viza të Ballkanit Perëndimor për sa i përket numrit të kërkesave për azil nga shtetasit e saj në zonën Shengen+ në vitin 2019.

Arsyet e migrimit duket se zhvillohen dhe ndryshojnë me kalimin e kohës. Gjatë viteve të para të '90, migrimi ishte i lidhur fort me kërkimin e një jete në një vend që lejonte të drejtat dhe liritë themelore, ndërsa gjatë vitit 1997 u lidh drejtpërdrejt me kërkimin e mundësive më të mira ekonomike, si rezultat i humbjes së gjithë kursimeve të jetës në skemat piramidale të cilat falimentuan dhe lanë shumë shqiptarë në varfëri.

Gjithsesi, një faktor i përbashkët në të gjitha valët e migrimit mbetet kërkimi i mundësive më të mira ekonomike. Gjetjet nga hulumtimi cilësor dhe anketa

<sup>5</sup>Burimi: [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/20200710\\_sw-d-2020-132-report\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/20200710_sw-d-2020-132-report_en.pdf)

<sup>6</sup>Ibid

<sup>7</sup> Kërkesat për azil në Belgjikë nga shtetas shqiptarë

2011 - 1290 kërkesa, 2012 – 1075 kërkesa, 2013 – 775 kërkesa, 2014 – 730 kërkesa, 2015 – 825 kërkesa, 2016 – 815 kërkesa, 2017 – 880 kërkesa, 2018 – 670 kërkesa, 2019 – 680 kërkesa, 2020 – 445 kërkesa,

<sup>8</sup> Kërkesat për azil në Hollandë nga shtetas shqiptarë

2011 - 30 kërkesa 2012 – 20 kërkesa 2013 – 35 kërkesa 2014 –90 kërkesa, 2015 – 1010 kërkesa 2016 – 1700 kërkesa 2017 – 375 kërkesa 2018 – 575 kërkesa 2019 – 270 kërkesa, 2020 – 90 kërkesa.

kombëtare tregojnë se perceptimi i përgjithshëm është se qytetarët shqiptarë migrojnë kryesisht për arsye ekonomike, duke renditur si tre arsyet kryesore të migrimit mungesën e mundësive për punësim në vend, pagat e ulëta dhe mundësitë më të mira të punësimit jashtë vendit.

Rëndësia e të dhënave statistikore dhe analizave mbi tendencat e migrimit paraqet interes të veçantë në krijimin e politikave që i përgjigjen nevojave të shtetasve shqiptarë. Për më tepër, hulumtime si ky, kryer brenda këtij projekti dhe të tjerë të cilët ndihmojnë në kuptimin e arsyeve, perceptimeve dhe sjelljeve që çojnë në migrim, mbështesin krijimin e qasjeve të dedikuara të komunikimit që potencialisht sjellin ndryshime.

Ndërsa ka pasur përpjekje për të komunikuar mesazhe të caktuara për migrantët potencialë, një strategji ndërlidhëse komunikimi, me një plan veprimi të qartë dhe të pranuar nga të gjithë aktorët përkatës, ende mbetet për t'u zbatuar. Ky projekt do të ndihmojë në hapjen e rrugës drejt një qasjeje të tillë dhe do të ndërtohet e zhvillohet mbi përpjekjet e mëparshme të bëra në drejtim të komunikimit me grupet më të prirura për të migruar. Përmes kësaj strategjie komunikimi, synojmë të parashtrijmë një sërë hapash, me kanalet dhe mesazhet e duhura në mënyrë që të kenë ndikim. Përveç kësaj, strategjia përfshin monitorimin dhe vlerësimin, përmes së cilës të mund të matet ndikimi i saj.

Përmes shkëmbimit të përvojave të migrimit dhe qasjes në informacion mbi arsimin dhe mundësitë e punësimit, strategjia e komunikimit synon të inkurajojë ata që përdorin kanale të parregullta për të eksploruar migrimin e rregullt si dhe alternativat për zhvillim brenda vendit. Në këtë mënyrë ata mund të njohin dhe përmbushin më mirë nevojat e tregut të punës në vend dhe jashtë, duke krijuar pritshmëri realiste për migrimin.

#### **E.2.1.2. Gjetjet kryesore të punës kërkimore**

Të dhënat e mbledhura nga hulumtimi i kryer kanë ndihmuar për të identifikuar audiencën e synuar, kanalet e duhura të komunikimit dhe për të formuluar mesazhet kryesore më efektive.

Gjetjet nga anketa kombëtare tregojnë se tre arsyet kryesore për migrim janë mungesa e mundësive të punës në Shqipëri (63%), pagat e ulëta në vend (62%) dhe mundësitë më të mira të punësimit jashtë vendit (51%). Rezultatet nga hulumtimi cilësor i mbështesin më tej këto gjetje, duke treguar se vështirësitë në gjetjen e një pune dhe niveli i lartë i pakënaqësisë me pagat dhe kushtet e punës duket se i shtynjë njerëzit të migrojnë. Rezultatet e tjera nga hulumtimi gjithashtu tregojnë se perceptimi i një sistemi të dobët të kujdesit shëndetësor dhe arsimit, korrupsioni dhe ryshfeti janë faktorë që ndikojnë në qëllimin e dikujt për të migruar.

Gjetjet nga hulumtimi cilësor tregojnë se ekziston një lidhje e fortë e të anketuarve me vendin e tyre (Shqipërinë). Sipas pjesëmarrësve, kushtet e vështira ekonomike dhe mungesa e mundësive, i shtynjë ata të migrojnë; po të mos ishin këto vështirësi, ata nuk do të zgjidhnin të ishin "të huaj" në një vend tjetër. Të dhënat nga sondazhi

kombëtar mbështesin më tej këto gjetje ku më shumë se gjashtë në dhjetë të anketuar që synojnë të migrojnë, tregojnë se pagat më të larta (63%) dhe më shumë mundësi punësimi (62%), do t'i bënin ata të qëndronin në Shqipëri

Gjetjet tregojnë se rreth gjysma e të anketuarve, pavarësisht nëse synojnë të migrojnë apo jo, janë shumë ose disi të interesuar për mundësitë e migrimit në vendet evropiane. Niveli i interesit për grup moshat më të reja 18-40 vjeç është më i lartë krahasuar me të anketuarit e grup moshës 41+, përkatësisht 69% dhe 38%.

Për më tepër, 35% e atyre që janë të interesuar për mundësitë e migrimit në vendet evropiane, janë të interesuar edhe në format e migrimit të parregullt. Niveli i interesit për mundësitë e parregullta të migrimit nuk ndryshon shumë midis grup moshave. Megjithatë, burrat tregojnë një interes më të lartë për mundësitë e migrimit të parregullt krahasuar me gratë, përkatësisht 40% dhe 30% të atyre që janë të interesuar në mundësitë e migrimit në Europë.

Sipas pjesëmarrësve në grupet e fokusuara, politikat e ashpra të migrimit në vendet evropiane duket se i 'shtyjnë' njerëzit drejt formave të parregullta dhe të pasigurta të migrimit. Për shembull, pjesëmarrësit pretendojnë se është e vështirë të marrësh një vizë pune për shkak të ligjeve të rrepta të punësimit. Nga ana tjetër, ata që duan të studiojnë jashtë e kanë të vështirë të mbulojnë shpenzimet ekonomike të jetesës jashtë vendit, duke kërkuar kështu mundësi migrimi të parregullt me shpresën se një punë informale mund t'ju mundësojë të ardhura të mjaftueshme ose kontakte për të siguruar një leje qëndrimi në të ardhmen.

Gjetjet nga hulumtimi cilësor tregojnë se pjesëmarrësit kanë njohuri të mira dhe kuptueshmëri të aktiviteteve të lejuara ndërsa janë në një vend të Zonës Shengen si vizitorë. Kjo përforcohet më tej nga të dhënat e Sondazhit Kombëtar, ku 85% e të anketuarve janë në dijeni të periudhës së lejuar të qëndrimit në Zonën Shengen, pa viza (90 ditë). Konkretisht, më shumë se nëntë në dhjetë të anketuar (97%) e dinë se brenda kësaj periudhe ata mund të vizitojnë familjen/të afërmit e tyre ose ta shfrytëzojnë këtë kohë për turizëm. Rreth gjysma e tyre, dinë se gjatë kësaj periudhe atyre u lejohet të martohen për rastet kur bashkëshorti/ja jeton në vendin pritës (52%); ose të marrin pjesë në trajnime afatshkurtra (51%). Rreth 25%, dinë se lejohen disa veprimtari biznesi siç janë pjesëmarrja në panairë ose takime pune. Sidoqoftë, 37% mendojnë se mund ta shfrytëzojnë këtë periudhë për qëllime studimi, ndërsa 35% mendojnë se lejohet punësimi brenda kësaj qëndrimi, pa vizë. Një gjetje interesante nga hulumtimi cilësor tregon se pjesëmarrësit do të rrezikonin, duke gjetur një punë informale, brenda afatit kohor të tre muajve të qëndrimit.

Gjetjet tregojnë se ka njohuri të mira lidhur me pasojat e mundshme ndaj mosrespektimit të afateve të lejuara të qëndrimit në Zonën Shengen. Të dhënat nga Anketa Kombëtare tregojnë se të anketuarit janë të vetëdijshëm se mund të paguajnë një gjobë (64%), të kthehen me detyrim në vendin e origjinës (59%), t'u ndalohej hyrja në BE (58%). Rreth 25% mendojnë se mund të ndalohen nga policia gjatë qëndrimit të tej zgjatur në Zonën Shengen. Rreth 14% mendojnë se mund të ndalohen apo arrestohen nëse nuk e respektojnë këtë kohë.

Të dhënat nga Anketa Kombëtare tregojnë se të anketuarit janë në dijeni të rasteve të mundshme të migrimit të parregullt siç janë kalimi i kufirit përmes një pike kalimi jozyrtare (94%) ose kalimi i kufirit me dokumente të falsifikuara (93%). Rreth 74% mendojnë që të kesh vetëm një pasaportë por asnjë dokument tjetër që vërteton qëllimin dhe kushtet e qëndrimit të synuar, përbën një rast të migrimit të parregullt.

Në matjen e njohurive dhe perceptimit në lidhje me azilin, të dhënat nga hulumtimi cilësor tregojnë se pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm për procedurat dhe arsyet e vlefshme për të kërkuar azil. Të pyetur nëse ata personalisht të ndiqnin një rrugë të tillë, shumica e tyre nuk do ta bënin, duke njohur paraprakisht kushtet specifike që përbëjnë një rast të vlefshëm azil- kërkuar.

Sidoqoftë, të dhënat nga anketa kombëtare tregojnë se një në dhjetë të anketuar (11%) mendojnë se mund të kualifikohen për azil në Europë. Të dhënat tregojnë se ky mendim mbështetet në motive të pabazuara, të tilla si një gjendje e keqe ekonomike ose vështirësi në punësim.

Nëntë në dhjetë besojnë se dikush që e ka jetën në rrezik për shkak të hakmarrjes ose gjakmarrjes (93%) përbën një rast të vlefshëm kërkesë për azil. Tre në dhjetë të anketuarit (31%) mendojnë se një rast i vlefshëm është dhe kërkimi i azilit për shkak pakënaqësisë me jetën në vendin e tyre. Më shumë se një në dhjetë (15%) besojnë se dëshira për të jetuar në Europë është një arsye e vlefshme për të kërkuar azil. Ndryshe nga rezultatet e hulumtimit cilësor, gjetjet nga Anketa Kombëtare tregojnë se ka një mungesë njohurish lidhur me rastet e vlefshme të azilit.

Gjetjet nga Anketa Kombëtare tregojnë se rreth katër në dhjetë të anketuar (40%) synojnë ose do të dëshirojnë të migrojnë dhe rreth 40% e tyre kanë plane konkrete për t'u larguar nga vendi brenda dy viteve të ardhshme. Megjithatë, ka ndryshime thelbësore mes qëllimeve për të migruar sipas grup moshave. Të dhënat tregojnë se 56% e grup moshës 18-40 duan të migrojnë krahasuar me 25% të grup moshës 41+. Duke patur parasysh vetëm grup moshën 18-40, duket se ata që synojnë të migrojnë kanë norma më të larta papunësie, krahasimisht me ata që nuk dëshirojnë të migrojnë, përkatësisht 38% (të papunë) kundrejt 25% (të papunë). Nga ana tjetër, rreth 40% e të anketuarve të punësuar dhe që dëshirojnë të migrojnë, pavarësisht moshës, deklarojnë se puna që kanë nuk i përmbush aspiratat e tyre profesionale.

Europa rezulton të jetë destinacioni i preferuar për të migruar (84%). Gjetjet nga Anketa Kombëtare tregojnë se më shumë se tetë në dhjetë të anketuar që dëshirojnë / po planifikojnë të migrojnë brenda dy viteve të ardhshme, edhe kur nuk e kanë vendosur konkretisht se ku duan të migrojnë, përzgjedhin 'diku në Europë' si destinacionin e tyre të preferuar. Rreth 9% rendisin Shtetet e Bashkuara.

Për ata që e dinë saktësisht se ku duan të migrojnë, Gjermani është destinacioni kryesor (31%). Rreth 20% rendisin Italinë si destinacionin e tyre të preferuar dhe 19% Greqinë. Këto gjetje përforcohen nga rezultatet e hulumtimit cilësor, duke treguar se destinacionet e preferuara të shqiptarëve janë Gjermania (renditur shumë më lart se vendet e tjera) e ndjekur nga Anglia dhe Italia. Zgjedhja e vendit të preferuar ndikohet nga pasja e të afërmeve që jetojnë jashtë, të cilët mund të ndihmojnë në akomodimin

dhe integrimin e tyre. Arsye të tjera të përmendura janë standardi më i lartë i jetesës dhe kërkesa e lartë për punë, veçanërisht për punonjës të kualifikuar dhe të arsimuar. Të anketuarit që duan të migrojnë, kanë më shumë miq shqiptarë që jetojnë në Europë krahasuar me ata që nuk dëshirojnë të migrojnë, 56% dhe 40%. Kjo përforcohet më tej nga hulumtimi cilësor, ku pjesëmarrësit deklarojnë se kanë të afërm dhe miq migrantë që i konsiderojnë si mbështetjen e tyre më të madhe në përpjekjen për t'u larguar nga vendi. Gjetjet nga hulumtimi cilësor tregojnë se të afërmit që tashmë kanë migruar rekomandojnë migrimin. Kjo përforcohet më tej përmes përgjigjeve nga intervistat në thellësi, pavarësisht grupit të intervistuar.

Rreth një në tre të anketuar (29%) kanë përvoja të mëparshme migrimi. Kjo është më e theksuar tek burrat (41%) sesa gratë (17%). Të anketuarit rendisin Greqinë (42%), Italinë (30%) dhe Gjermaninë (14%) si vendet e tyre të mëparshme të qëndrimit. Rreth 60% e tyre do të dëshironin të migronin përsëri, dhe më shumë se tetë në dhjetë (81%) do t'ju rekomandonin të tjerëve të migrojnë.

TV (85%), Facebook (30%) dhe Instagram (24%) janë kanalet kryesore nga të cilat njerëzit informohen rreth tematikave të përgjithshme. Të dhënat tregojnë se të anketuarit e grup moshës 18-40 vjeç përdorin më së shumti kanale të mediave sociale (Facebook dhe Instagram), ndërsa të anketuarit e grup moshës 41+ vjeç, përdorin më së shumti Televizionin.

Të afërmit dhe miqtë që tashmë jetojnë jashtë duket se janë 'burimi' kryesor i informacionit për procedurat e migrimit, bazuar kjo në gjetjet nga hulumtimi cilësor. Edhe kur aplikojnë për një vizë pune apo studentore, pjesëmarrësit deklarojnë se ata mbështeten te miqtë e tyre për informacione më të besueshme. Burime të tjera informacioni janë ambasadat, agjencitë private të punësimit dhe interneti. Duhet të theksohet se shumë pjesëmarrës janë të shqetësuar për vërtetësinë e informacionit në internet.

Duke marrë parasysh informacionin e dhënë në mediat sociale, gjetjet e hulumtimit cilësor tregojnë se pjesëmarrësit e kanë më të lehtë marrjen e informacionit përmes tregimeve të shkurtra sesa artikujve të hollësishëm. Gjithashtu, ata do të preferonin videot e shpejta, gazmore me një mesazh kuptimplotë sesa bisedat televizive.

Rreth katër në dhjetë të anketuar (42%) tregojnë jashtëzakonisht shumë ose shumë interes për të biseduar me familjen për migrimin e parregullt, për të parë një film, ose një program investigativ në TV në lidhje me migrimin e parregullt. Rreth 19% do të dëshironin të merrnin pjesë në një fushatë sensibilizuese për migrimin e parregullt ose të dëgjonin 'podcasts' nga gazetarë / folës / motivues të famshëm që ndajnë përvojat e tyre / të tjerëve mbi migrimin e parregullt.

Gjetjet tregojnë një mungesë njohurish lidhur me ekzistencën e institucioneve publike në vend, të cilat mund të ofrojnë informacion në lidhje me çështjet e migrimit. Pjesëmarrësit e Fokus Grupeve thonë se edhe nëse ka zyra të tilla, veprimtaria e tyre nuk është e dukshme. Gjetjet sugjerojnë nevojën për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me këto institucione.

Rezultatet e testimit të mesazheve në diskutimet e fokus grupeve tregojnë se pjesëmarrësit, kryesisht dëshirojnë të informohen për procedurat dhe mundësitë më tepër se sa mbi ndëshkimet dhe pasojat e migrimit të parregullt. Gjetjet cilësore tregojnë se ndarja e përvojave personale të migrantëve të tjerë nuk ndikon në vendimin për të migruar. Pjesëmarrësit u pyetën qartë për ndikimin që mund të kishte një histori e vështirë dhe sfiduese migrimi tek ta. Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe u shprehën se historia apo përvoja jo e mirë e dikujt nuk nënkupton të njëjtin rezultat për të gjithë. Ndër të tjera, u theksua edhe transmetimi në media i lajmeve negative; një ndryshim drejt një perspektive më pozitive do të përbënte më tepër interes.

Të gjitha sa më sipër janë marrë parasysht gjatë fazës së zhvillimit të strategjisë së dedikuar të komunikimit, duke krijuar një qasje e cila merr parasysht këto gjetje dhe ndërton hapa konkretë të cilat synojnë t'i përgjigjen dhe potencialisht të ndikojnë në sjelljen e dikujt përkundrejt vendimmarrjes së tyre mbi migrimin (e parregullt).

## **E.2.2. Mjedisitë e komunikimit në Shqipëri**

Njohja dhe kuptimi i mjedisit të komunikimit është thelbësor për konceptimin dhe përshtatjen me sukses të një strategjie komunikimi që i shërben fushatës së migrimit. Kjo ndihmon për të përcjellë mesazhet e duhura dhe për të identifikuar kanalet dhe rrjetet më të përshtatshme për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e projektit. Prandaj është e nevojshme që të kemi një pasqyrë të mjedisit të komunikimit në Shqipëri dhe të ndërtojmë një strategji e cila merr parasysht specifikat dhe veçoritë e saj.

### **E.2.2.1. Media tradicionale**

Shqipëria ka një mjedis mediatik dinamik dhe aktiv. Numri i mediave është relativisht i madh në krahasim me popullsinë e vendit. Përveç transmetuesit publik (RTSH) dhe agjencisë publike të lajmeve (ATA), të gjitha mediat e tjera në vend janë në pronësi private.<sup>9</sup> E drejta për krijimin e mediave garantohet me ligj për të gjithë individët dhe organizatat.

Hulumtimi i kryer për këtë projekt tregoi se individët në Shqipëri përdorin një larmi burimesh informacioni në jetën e tyre të përditshme. Midis tyre, televizioni qëndron si burimi më i përdorur i informacionit, me 85 % të të anketuarve që thonë se e përdorin atë në përditshmëri.<sup>10</sup>

#### **▪ Televizioni**

Deri në fund të vitit 2020, në Shqipëri operonin 5 SMP (ofrues të shërbimit të mediave) me licencë transmetimi kombëtar (respektivisht: ADTN, DigitalbTV, Top Channel, Klan TV dhe Vizion +), 45 kanale televizive lokale që transmetojnë në platformë analoge

<sup>9</sup>Londo, Ilda, *Shqipëria në*: Petkovic, B. (Ed.), Rëndësia e integritetit të medias. Ljubljana: Peace Institute, 2014

<sup>10</sup>Burimi: Hulumtimi i kryer në kuadër të këtij projekti, IDRA, Tiranë, Qershor 2021



dhe 2 ofrues shërbime satelitore. Ekziston edhe 1 transmetues publik (TVSH) me tre degë lokale. Televizioni publik operon në dy programe kombëtare dhe në kuadër të transmetimit digjital ka nisur transmetimin në pesë kanale tematike.<sup>11</sup>

Përveç kësaj, në të gjithë vendin janë të shpërndara 68 kanale televizive kabllore<sup>12</sup>. Këto shërbime gjenden pothuajse në çdo qytet. Këto kanale nuk prodhojnë përmbajtjen e tyre, por ofrojnë një përzjerje të programeve shqiptare dhe të huaja me çmime përgjithësisht të përshtatshme. Në shumë raste, këto shërbime janë bërë një burim shqetësimi në lidhje me piraterinë.<sup>13</sup>

Me përhapjen e shërbimeve digjitale, kohët e fundit në Shqipëri janë shtuar gjithashtu katërmbëdhjetë shërbime OTT-IPTV dhe gjashtë kanale televizive online, por audienca dhe ndikimi i tyre mbetet i kufizuar.

### ▪ Radio

Në të shkuarën, radio ka qenë një burim i rëndësishëm informacioni për shqiptarët. Por në ditët e sotme ajo konsiderohet kryesisht si media “drejtuesve të automjeteve”<sup>14</sup>, me fokus tek të rinjtë. Ndikimi i radios është zvogëluar që nga rënia e regjimit komunist në 1991. Zhvillimet teknologjike të tilla si interneti dhe televizioni digjital ndikuan në rrëzimin e radios nga pozicioni i saj dominues në treg.

Radio Tirana, transmetuesi publik, u themelua në vitin 1938 dhe gjatë diktaturës komuniste, e cila zgjati nga 1945 në 1991, u përdor kryesisht si një medium propagandistik.

Në Shqipëri aktualisht ka 6 stacione kombëtare radio dhe 57 lokale. Radio Tirana, Radio Tirana 2 dhe Radio Tirana 3 janë tre nga gjashtë stacionet e radiove kombëtare. Ekzistojnë gjithashtu dhe tre stacione të tjera radio kombëtare private: Club FM, Top Albania Radio dhe Radio Klan<sup>15</sup>. Ndër stacionet e radiot lokale, 4 prej tyre janë në pronësi të komuniteteve fetare.

### ▪ Media e printuar/ Shtypi i shkruar

Media e shkruar ka patur një rënie të vazhdueshme si rezultat i krizave globale dhe lokale, si dhe rritjes së mediave digjitale. Ashtu si në shumë të vende të tjera, mediat e printuara në Shqipëri po përjetojnë një situatë të vështirë ekonomike. Për shkak të shitjeve të kufizuara, disa media të shkruara janë detyruar të ndalojnë botimet e tyre të printuara. Nuk ka një listë zyrtare të mediave të shkruara në vend, as të dhëna të verifikuara mbi tirazhin dhe shitjet e gazetave në Shqipëri. Disa emisione televizive të mëngjesit lexojnë titujt nga faqet e para të gazetave, duke plotësuar disi mungesën e

---

<sup>11</sup>Burimi: AMA (Autoriteti Mediave Audiovizive), Link: <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Subjekte-Audiovizive-2020..pdf>, Aksesuar në Korrik 2021

<sup>12</sup> ibid

<sup>13</sup>Hartëzimi i medias dixhitale: Shqipëri, Instituti Shqiptar i Medias, 2012

<sup>14</sup> Arben MUKA, Foli Shoferit! Tiranë 2012, Botues: “M&B”

<sup>15</sup> Burimi: AMA (Autoriteti Mediave Audiovizive), Link: <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Subjektet-audio-2020.pdf>, Aksesuar në Korrik 2021

mediave në versionin e printuar në tregun mediatik shqiptar. Ndërkohë, shumica e artikujve në gazeta janë gjithashtu të disponueshëm në versionin online të mediave. Në krahasim me gazetatat, tregu i revistave është më i qëndrueshëm dhe aktiv përse i përket titujve të rinj që hyjnë në treg. Ato përqendrohen kryesisht tek argëtimi, moda dhe stili i jetës me fokus tek lexueset femra. Gjithashtu janë dhe disa revista të specializuara në fusha si ekonomia, shëndeti, sporti, kinema, etj.

#### **E.2.2.2. Interneti dhe media online**

Depërtimi i internetit në Shqipëri ka qenë gradual, me rritje të moderuar gjatë viteve të fundit, por ende nën normën e BE-së. Sipas ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit - cituar nga internetworldstats.com), deri më 31 Dhjetor 2020, depërtimi i internetit në Shqipëri arriti në 75.2 % të popullsisë, me rreth 2.160.000 përdorues të internetit në të gjithë vendin.<sup>16</sup> Ndërkohë, shkalla e depërtimit në Greqi, e fundit në listën e vendeve të BE kur bëhet fjalë për qasjen në internet, ishte në 80.4 % të popullsisë.<sup>17</sup>

Krahas depërtimit relativisht të ngadaltë në internet, shqetësues mbetet niveli i ulët i aftësive digjitale në popullatën e përgjithshme. Komisioni Evropian raporton se, midis vendeve kandidate dhe kandidatëve të mundshëm, përqindja më e ulët e individëve që kishin aftësi bazë ose mbi bazën e përgjithshme digjitale në vitin 2019 u raportua nga Shqipëria, në 21%, ndërsa Mali i Zi raportoi shkallën më të lartë me 50 % të individëve që kishin aftësitë digjitale bazë ose mbi bazike.

Në kuadër të kësaj Strategjie Komunikimi, vlen gjithashtu të shihen të dhënat që lidhen me depërtimin e telefonisë celulare në Shqipëri. Sipas disa burimeve, deri në janar 2021 kishte rreth 3.77 milion lidhje celulare në vend. Kjo shifër u ul me 11 mijë (-0.3%) gjatë periudhës janar 2020 dhe janar 2021.<sup>18</sup>

Numri i përgjithshëm i lidhjeve celulare në janar 2021 ishte ekuivalent me 131.2% të popullsisë së përgjithshme. Shumë njerëz kanë në përdorim më shumë se një lidhje dhe kjo është arsyeja pse shifrat për lidhjet celulare tejkalojnë 100% të popullsisë së përgjithshme.<sup>19</sup>

##### **▪ Mediat online/ Portalet informative**

Përhapja e shpejtë e internetit, krijoi një gamë të gjerë të mediave online në Shqipëri. Aktualisht në hapësirën kibernetike shqiptare janë krijuar një numër i konsiderueshëm faqesh web informative, duke fituar gjithnjë e më shumë audiencë.

Faqet web janë krijuar kryesisht nga organizatat tradicionale të medias ose gazetarë. Pothuajse të gjitha mediat tradicionale kanë faqet e tyre në internet. Por, përveç tyre, janë krijuar edhe media online që burojnë nga nismat individuale.

<sup>16</sup>Burimi: <https://www.internetworldstats.com/europa2.htm#a1> , Aksesuar në Korrik 2021

<sup>17</sup><https://data.oecd.org/ict/internet-access.htm>

<sup>18</sup>Burimi: DIGITAL 2021: SHQIPËRI, Link: <https://datareportal.com/reports/digital-2021-albania>

<sup>19</sup>Ibid

Në ndryshim nga radio dhe televizioni, nuk ka statistika zyrtare mbi numrin e portaleve informative që ekzistojnë; gjithashtu numri i mediave online është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Sipas Unionit të Gazetarëve në Shqipëri ka rreth 650 faqe informative online.<sup>20</sup>

Gazetaria online dhe media online kanë ofruar gjithnjë një shkallë të lartë lirie për gazetarët dhe qytetarët.

#### ▪ **Mediat Sociale**

Interneti vazhdon të ndryshojë mënyrën se si njerëzit komunikojnë, organizojnë dhe shkëmbejnë informacion. Si rezultat, teknologjitë e reja të komunikimit janë bërë një komponent gjithnjë e më i rëndësishëm i jetës sonë të përditshme. Ndër këto teknologji, mediat sociale janë ato që kanë tërhequr një numër të madh të përdoruesve të internetit në Shqipëri.

Aktualisht Facebook, YouTube dhe Instagram janë mediat sociale më të përdorura nga shqiptarët. Sipas STATISTA, deri në Qershor 2021 numri i përdoruesve të Facebook arriti në 1,733,000, ose rreth 57 % e popullsisë.<sup>21</sup>

Në vitin 2021, përdoruesit e YouTube në Shqipëri arritën në afërsisht 1.44 milion dhe parashikohet të arrijë në 1.60 milion përdorues deri në vitin 2025. Shifrat e përdoruesve janë përlogaritur duke marrë parasysh regjistrimet e kompanisë ose materialin për shtyp, hulumtimet dytësore, shkarkimet e aplikacioneve dhe të dhënat e trafikut. Ato i referohen përdoruesve mesatarë aktivë mujorë gjatë kësaj periudhe.<sup>22</sup>

Media e tretë më e përdorur në Shqipëri, Instagram, ka regjistruar 1,214,400 përdorues në Qershor 2021, me 37.9% prej tyre të moshës 25 deri në 34 vjeç.<sup>23</sup>

Krahas rrjeteve sociale si Facebook ose platformave për ndarjen e përmbajtjeve si YouTube ose Instagram, një rritje të konsiderueshme në Shqipëri kanë dhe blogjet. Themelimi i blogosferës shqiptare daton në 2002-2003, me blogje të njohura si: peizazhe.com (ish xhaxhai.wordpress.com), themeluar nga studiuesi dhe analisti i medias Ardian Vehbiu, peshkupauje.com, krijuar në dhjetor 2003 nga Penar Musaraj dhe Blendi Salaj, etj. Në fakt, disa nga blogerët në Shqipëri kanë arritur të jenë “influencer” në fushën e tyre të specializimit dhe mund të shërbejnë edhe si të tillë për fushatat e komunikimit si ajo e organizuar në kuadër të projektit ARISE-ALL.

#### **E.2.2.3. Kanale alternative të komunikimit**

Kur kërkojnë kanale komunikimi, organizatat shpesh i drejtohen formave më të dukshme të komunikimit: radio, televizion, gazeta dhe media online. Por përveç këtyre, ka forma të tjera, ndonjëherë më të fuqishme të komunikimit masiv.

Në ditët e sotme, web-i ofron mundësinë për të dërguar shënime ose mesazhe të personalizuar drejtpërdrejt në postën elektronike përmes marketingut me email ose

<sup>20</sup><https://businessmag.al/numri-i-portaleve-online-shqiptare-eshte-ne-rritje-kush-po-i-drejton-ato/>

<sup>21</sup><https://www.statista.com/statistics/1029695/facebook-users-albania/>

<sup>22</sup><https://www.statista.com/forecasts/1146092/youtube-users-in-albania>

<sup>23</sup><https://www.statista.com/statistics/1022040/instagram-users-albania/>

gazeta elektronike, ose drejtpërdrejt në profilin personal në rrjetet sociale. Në vetëm pak minuta, një organizatë mund të krijojë një fushatë ndërgjegjësimi përmes *Google Adwords* dhe një faqe të kuruar në rrjetet sociale për të promovuar projektin e saj ose për të komunikuar me audiencën e synuar. Ekzistojnë një sërë shërbimesh në Shqipëri që ndihmojnë në ndërgjegjësimin dhe komunikimin e mesazheve të shkurtra që mbeten gjatë në kujtesë.

Billboard-e të mëdha në pjesët anësore të autostradave kombëtare, që tashmë përdoren nga reklamat komerciale, janë të përshtatshme të mbushen me mesazhe ndërgjegjësimi gjatë fushatave të migrimit, si kjo e propozuar nëpërmjet këtij projekti. Gjithashtu do të ishin të përshtatshme dhe hapësirat reklamuese përgjatë zonave tregtare apo rrugëve për këmbësorë si dhe në stacionet e autobusëve.

Ndërkohë kanale të tjera tradicionale të komunikimit, si marketingu i drejtpërdrejtë, katalogu i porosive postare, posta (sipas objektivit ose masës), ose komunikime alternative si konferenca, ekspozita, marketing guerile, trajnime, njoftime për shtyp, konferenca, thirrje telefonike, SMS, takime, promovime aktiviteteve, etj. mund të përdoren me sukses në Shqipëri. Këtu mund të përmendim gjithashtu materiale të printuara si broshura, postera dhe banderola, animacione komike dhe piktura, fletëpalosje, fletushka, dhe pse jo, mesazhe të pikturuara me grafitë të cilat janë aq popullore mes të rinjve.

Gjithashtu, një kanal i rëndësishëm ndër personal dhe i komunikimit masiv që funksionon mirë në shoqërinë shqiptare është ai i "lajmëtarëve të besuar" (figura publike, të famshëm nga sporti, muzika ose TV, migrantët, udhëheqësit fetarë, etj.)

<b>PYETJE</b>	
1	<i>Çfarë kuptojmë me imigracion?</i>
2	<i>Çfarë kuptojmë me emigracion?</i>
3	<i>Pse është e rëndësishme analiza e tendencave të migrimit?</i>
4	<i>Pse është e rëndësishme analiza e mjedisit të komunikimit?</i>
5	<i>Cilat quajmë media tradicionale?</i>
6	<i>Çfarë kuptojmë me komunikim masiv?</i>
7	<i>Çfarë kuptojmë me kanal ndër personal të komunikimit masiv?</i>

## E.3 – OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT

### E.3.1 Objektivat e strategjisë

Një strategji komunikimi udhëheq një program të tërë ose fushatë. Ajo vendos tonin dhe drejtimin në mënyrë që të gjitha aktivitetet e komunikimit, produktet dhe materialet të funksionojnë në harmoni për të arritur ndryshimin e dëshiruar. Aktivitetet dhe materialet strategjike kanë më shumë të ngjarë të promovojnë ndryshimin.

Në rastin tonë, zbatimi i një strategjie komunikimit do të shërbejë në përmbushjen e objektivit të përgjithshëm që është në këtë rast “ulja e numrit të atyre që synojnë dhe përdorin kanale të parregullta të migrimit, duke kërkuar dhe evidentuar mundësitë në Shqipëri që lejojnë zhvillimin personal, profesional dhe ekonomik si dhe informimin në lidhje me mundësitë e rregullta të migrimit.”

Institucioni zbatues duhet të përcaktojë në rastin tonë objektivat e komunikimit që do t'i shërbejnë objektivave të politikave apo politikave operacionale, në përputhje me objektivat e projektit. Objektivat e komunikimit paraqiten në figurat më poshtë, të ndara sipas kategorive kryesore.

Figura 20 - Objektivat e politikave dhe komunikimit 1




Figura 21 - Objektivat e politikave dhe komunikimit 2





Figura 22 - Objektivat e politikave dhe komunikimit 3



Objektivat e mësipërm të politikave, të detajuar më tej dhe të përkthyer në objektiva komunikimi, do të jenë bazat mbi të cilat do të ndërtohet Strategjia e dedikuar e Komunikimit. Përmes zbatimit ndër sektorial të këtyre elementeve, synohet përcaktimi i një zinxhiri veprimesh që përfundimisht do të kenë ndikim në zgjedhjet e migrimit.

### **E.3.2. Fushat e përqendrimit**

Kjo strategji identifikon fushat kryesore të komunikimit për projektin rreth çështjeve të migrimit, duke u përqendruar dhe dhënë propozime të cilat klasifikohen në katër fusha:

#### **i. Zgjerimi i audiencës dhe vizibiliteti**

Aktivitetet kryesore në këtë fushë do të jenë aktivitetet e informimit publik që synojnë një shikueshmëri dhe prezantim të qëllimeve dhe mesazheve të projektit rreth çështjeve të migrimit. Fushata e informimit do të ndihmojë në njohjen e rreziqeve të migrimit të parregullt dhe gjithashtu mundësive në Shqipëri. Ndër të tjera, aktivitetet në këtë fushë do të ndihmojnë në rritjen e vizibilitetit të institucioneve shqiptare që punojnë në fushën e migrimit.

#### **ii. Ndërgjegjësimi dhe përforsimi i njohurive**

Nismat për ndërgjegjësim do të përqendrohen në përdorimin e mediave tradicionale dhe sociale, mbështetjes nga personazhe të famshëm dhe sensibilizimit përmes "influencers" lokalë dhe të diasporës. Fushata do të arrijë 200,000 njerëz, ndër të cilët 10,000 do të ndërveprojnë me aplikacionin e krijuar për aparatet celulare 'Mobile App'.

#### **iii. Angazhimi dhe pjesëmarrja**

Bashkëpunimi efektiv me partnerët do të sigurojë që qasja të ketë ndikim në nivel European dhe jo vetëm në nivel lokal. Aktivitetet nën këtë fushë do të ndihmojë në koordinimin e palëve të interesuara me diasporën shqiptare në Belgjikë dhe Holandë për t'i përfshirë ata në shpërndarjen e mesazheve të fushatës.

#### **iv. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve**

Synohet ngritja e kapaciteteve të institucioneve publike dhe OShC -ve që punojnë në fushën e migrimit në nivel kombëtar dhe lokal për t'u angazhuar në mënyrë aktive në parandalimin e migrimit të parregullt, promovimin e mundësive arsimore dhe ekonomike në Shqipëri, si dhe mundësive të rregullta migrimi në BE.

Kjo qasje strategjike do të sigurojë që audiencia e targetuar të arrihet në forma të ndryshme dhe që aktivitetet e komunikimit të kenë një shikueshmëri të lartë. Fushata do të realizohet e tillë që të mirëkuptohet nga audiencia dhe të rrisë ndërgjegjësimin e tyre përmes mesazheve dhe aktiviteteve të përshtatura sipas nevojave të tyre specifike.

Për t'i bindur njerëzit të besojnë në ndryshim, ata duhet të ndihen se i përkasin ndryshimit dhe të marrin pjesë në aktivitete, prandaj kjo strategji kërkon përfshirjen e tyre.

Personat që duan të migrojnë, shprehen se i marrin vetë vendimet e tyre, megjithatë gjetjet e hulumtimit tregojnë se ata mbështeten tek familja dhe miqtë për informacion dhe udhëzime lidhur me migrimin. Ndaj për këtë nevojitet një qasje që synon të informojë jo vetëm ata që duan të migrojnë, por edhe rrethin e tyre familjar e shoqëror.

### **E.3.3. Përqendrimi tek shtresat e shoqërisë Shqiptare**

Modeli ekologjik i Bronfenbrenner për zhvillimin njerëzor (e përshkruar më sipër në pjesën teorike) do të ndihmojë në përshtatjen e teknikave të komunikimit për secilin nivel të ndikimit.

Bazuar në këtë qasje, aktivitetet synojnë të ndikojnë në ndryshimin e sjelljes së grupeve të synuara brenda shtresave të mëposhtme të shoqërisë shqiptare:

**Individuale** - Në nivelin individual, ndryshimi i sjelljes buron nga brenda dhe ndikohet nga variablat e brendshëm. Individët duhet të informohen për rreziqet e migrimit të parregullt dhe të kenë njohuritë e nevojshme në lidhje me mundësitë e rregullta të migrimit për t'u ndjerë të sigurt.

Si rezultat, kjo mund të arrihet duke iu drejtuar atyre gjatë kohës që kalojnë me veten, kur janë të angazhuar në aktivitete individuale të tilla si: vizitat në mediat sociale, dëgjimi i një programi radio, një temë interesante e diskutuar në një emision televiziv, ose një seri podcast-esh (e cila duhet të promovohet më parë në rrjetet sociale), një film i shkurtër ose seri televizive që lidhen me migrimin e parregullt në YouTube, një aplikacion i dedikuar në celular, etj.

**Familja dhe bashkëmoshatarët** - Sjellja e një personi ndikohet nga rrethi i tij i ngushtë shoqëror dhe familjar. Kjo përfshin ndikimin e bashkëmoshatarëve, bashkëshortit, partnerit dhe familjes. Nëse ky rreth i mbështet ata në ndryshimin e sjelljes së tyre, në rastin tonë - për të mos konsideruar migrimin e parregullt si një mundësi, kjo do të ndikonte pozitivisht në arritjen e qëllimit të fushatës.

Është e nevojshme të arrihen të dy grupet, individë që synojnë të migrojnë në mënyrë të parregullt dhe rrethi i tyre, përmes aktiviteteve që mund të ndajnë me të tjerët, të tilla si shikimi i një shfaqjeje televizive, një filmi/dokumentari të shkurtër investigativ në shtëpi ose në mjedise publike, ose një reklamë televizive e shkurtër dhe tërheqëse, një postim interesant në mediat sociale i krijuar me humor që mund ta ndajnë me miqtë.

**Komuniteti** - Krahas rrethit të tyre të ngushtë të miqve dhe familjes, njerëzit i përkasin gjithashtu një komuniteti, lagjeje, qyteti, shkolle, mjedisi pune, etj. Ashtu si familja dhe miqtë e tyre, ata janë të ndikuar nga shoqëria dhe mjedisi ku jetojnë, por në nivele të ndryshme. Çdo komunitet ka udhëheqësit e vet dhe kur udhëheqësit nxisin sjelljet e dëshiruara, individët kanë më shumë gjasa të përfshihen në to.

Pjesëmarrja në një takim ose diskutim në grup (seminar) të organizuar nga një "influencer" për të ndarë përvojat e migrimit dhe mundësitë për sukses personal mund të jetë i dobishëm. Një "Ted Talks" i organizuar mirë gjithashtu është pë t'u konsideruar. Reklamimet në mjediset publike, të tilla si Citylights, stacionet e



autobusëve, billboard, e kështu me radhë, gjithashtu ndihmojnë në shpërndarjen e mesazheve në komunitet.

**Struktura Sociale** - Individët kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në aktivitete të cilat nxisin sjelljet e dëshiruara nëse institucionet promovojnë aktivitete të tilla, nëse ekzistojnë mekanizma koordinimi dhe inkurajojnë normat mbështetëse rreth sjelljes së dëshiruar. Në këtë nivel, fakti që personat që morën pjesë në hulumtimin cilësor nuk ishin në dijeni të ekzistencës së zyrave të migrimit në Shqipëri, nxjerr në pah nevojën për të përmirësuar prezencën e tyre në publik.

Kjo mund të arrihet duke shpërndarë informacion në lidhje me këto zyra dhe në lidhje me mundësitë e rregullta të migrimit në Europë. Gjithashtu, duke ndarë informacione të dobishme për tregun e punësimit në Shqipëri dhe duke ofruar udhëzime mbi arsimin dhe aftësimin profesional që lehtësojnë përshtatjen me nevojat e tregut. Kjo fushatë do të realizohet në bashkëpunim me institucionet si zyrat e punësimit, institucionet e aftësimin profesional dhe trajnimeve, ministritë e linjës, zyrat e migracionit, etj.

### **E.3.4 Audiencia e synuar**

Identifikimi i audiencës së synuar ndihmon në menaxhimin e burimeve dhe maksimizimin e ndikimit. Përqendrimi tek një pjesë e audiencës që mund të jetë e interesuar ose e përfshirë në aktivitetet tona do të na lejojë të komunikojmë dhe të angazhohemi me atë segment në një nivel më të thellë. Grupet e mëposhtme janë ndër audiencat strategjike që duhen arritur gjatë promovimit dhe zbatimit të Strategjisë së Komunikimit të zhvilluar:

#### **i. Migrantë të mundshëm, njerëz që kanë synime ose plane konkrete për të migruar**

Sipas të dhënave nga hulumtimi cilësor dhe sasior, të kryer në kontekstin e këtij projekti, kryesisht të rinjtë me diplomë universitare ose të shkollës së mesme duket se janë grupi i synuar i cili ose po mendon të largohet nga vendi ose që ka bërë plane për ta bërë këtë në vitet e ardhshme. Ata janë ose të papunë ose të pakënaqur me gjendjen e tyre ekzistuese të punësimit. Ata mbështeten tek familja dhe miqtë për të marrë vendime migratore dhe gjithashtu shikojnë TV, përdorin mediat sociale dhe lexojnë në internet. Në të njëjtën kohë do të preferonin të kishin një aplikacion në celular të dedikuar për informacionet e migrimit, si dhe të shikonin video të shkurtra me mesazhe pozitive. Ata gjithashtu do të shihnin filma ose programe investigative në TV.

Më poshtë është tipologjia e tyre, sipas të dhënave të studimit:

- 40% e të anketuarve që i përkasin këtij grupi nga të cilët 37% gra dhe 42% meshkuj
- Moshë 18-40 vjeç (56%), 41+ (25%)
- Punësimi: 51% janë të punësuar dhe 43% prej tyre të pakënaqur; të papunë 38%
- Arsimimi: 38% me universitet, 37% me arsim të mesëm, 25% arsim fillor
- Rreth 36% e atyre që duan të migrojnë janë të pakënaqur me sistemin arsimor

- *Rreth 43% e atyre që duan të migrojnë janë të pakënaqur me sistemin e kujdesit shëndetësor*

## **ii. Individë të interesuar për migrim të parregullt**

Ekziston një nëngrup i atyre që duan të migrojnë, të cilët e konsiderojnë migrimin e parregullt si një opsion për largimin nga vendi. Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se migrimi i parregullt nuk perceptohet njësoj i rrezikshëm për grupe të ndryshme të popullsisë. Vajzat e reja (nën 18 vjeç) mendohet se janë më të rrezikuara, ndërsa perceptimi është se ka më pak rrezik për djemtë e rinj që kërkojnë mënyra të migrimit të parregullt. Duket se ata që kërkojnë ose janë të interesuar në mundësitë e migrimit të parregullt, kanë anëtarë të familjes që jetojnë në vendin ku dëshirojnë të shkojnë. Rezultatet e hulumtimit cilësor tregojnë se perceptimi midis pjesëmarrësve është se politikat e ashpra të migrimit i shtyjnë njerëzit drejt kanaleve të parregullta dhe të rrezikshme të migrimit.

Ekziston një perceptim i përgjithshëm midis pjesëmarrësve, se aktualisht është më e ndërlikuar marrja e një leje qëndrimi të ligjshme apo gjetja e një pune jashtë vendit duke qëndruar në Shqipëri. Kjo i shtyn këta individë drejt migrimit të parregullt, që pas hyrjes në shtetin që dëshirojnë të jetojnë, të kërkojnë mundësi për të legalizuar statusin e qëndrimit.

Më poshtë është tipologjia e tyre, sipas të dhënave të studimit:

- *35% e atyre që janë të interesuar për mundësitë e migrimit në Europë, janë të interesuar për migracionin e parregullt*
- *Burrat 40% dhe gratë 30%,*
- *Gratë konsiderohen të jenë më shumë në rrezik*
- *Burrat konsiderohen më të diskriminuar*
- *Për ata, procedurat e BE -së demotivojnë migrimin e rregullt*
- *Migrimi i parregullt shihet si një mundësi për të kursyer para dhe për të krijuar një rrjet njohjesh për të siguruar lejen e qëndrimit*
- *Të vetëdijshëm për lejimet në zonën Schengen dhe pasojat*
- *Të informuar nga anëtarët e familjes ose miqtë jashtë vendit, mediat sociale, TV*

## **iii. Të kthyerit**

Individët brenda grupit të të kthyerve kanë pasur një përvojë konkrete dhe personale të migrimit. Ata kanë një histori për të treguar. Ata mund të kenë një zë në informimin mbi rreziqet dhe problemet e të qenit një migrant i parregullt, sepse 81 % e tyre sugjerojnë migrim vetëm përmes kanaleve të rregullta.

Më poshtë është tipologjia e tyre, sipas të dhënave të studimit:

- *Një në tre ka një përvojë të mëparshme migrimi*
- *60% do të donin të migronin përsëri*

- 81% rekomandojnë migrimin kryesisht në mënyrë të rregullt
- Një e treta e të anketuarve deklarojnë se kanë migruar më parë. Më shumë se dy nga pesë burra kanë migruar më parë dhe më pak se një në pesë gra kanë migruar më parë.
- Pas kthimit janë përballur me vështirësi për t'u ri integruar
- Grup moshë 18-40 vjeç do të rekomandonte më shumë mënyra të paligjshme të migrimit, krahasuar me grup moshat më të mëdha

#### iv. Diaspora shqiptare - shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë vendit

Ata duket se kanë një rol të rëndësishëm në rrjedhën migratore, duke ndikuar në vendimet e anëtarëve të familjes, të afërmeve dhe miqve të tyre.

#### E.3.4 Grupet e interesit

Bashkëpunimi me grupet e interesit do ta ndihmojë projektin në përmbushjen e objektivave të tij.

→ Një grup interesi ose një grup përkrahës (avokimi) është një organ që përdor forma të ndryshme të avokimit për të ndikuar në opinionin publik dhe/ose në një politikë të caktuar. Grupet e interesit gjithashtu mund t'i referohen shoqërisë që zhvillohet duke mësuar apo mbrojtur një çështje. Një grup i interesit të veçantë është një grup individësh që ndajnë njohuri të specializuara.

#### ▪ Influencers – Kryesisht njerëz me përvojë të mëparshme migrimi

Ky grup do të përdoret si një mjet informimi. Ata do të tregojnë përvojat e tyre personale dhe do të synojnë të qartësojnë disa nga keqkuptimet e migrimit. Duke u treguar individëve që dëshirojnë të migrojnë për rreziqet dhe pengesat, ata do të vendosin pritshmëri realiste për ta.

#### ▪ Organizatat e Shoqërisë Civile

OSHC-të, organizatat jo qeveritare, grupet e studimit, sindikatat, grupet dhe individët që

ndikojnë në debate dhe në opinione - janë pranë publikut dhe palëve bazë të interesit dhe mund të ndihmojnë përpjekjet e IOM -it në transmetimin e mesazheve. Ata gjithashtu janë nxitës të mundshëm të ndryshimit dhe mund të sjellin propozime novatore.

#### ▪ Media

Mediat mbeten partnerë të rëndësishëm dhe ndikojnë në promovimin e projektit rreth çështjeve të migrimit. Ato mund të përdoren jo vetëm si një kanal për të përcjellë mesazhet e projektit tek audienca e synuar, por edhe si lojtarë kryesorë dhe udhëheqës opinionesh. Për më tepër, në kuadër të këtij projekti, profesionistët e mediave do të ftohen të luajnë rolin e tyre si opinionistë për sa i përket ndryshimit të sjelljes ndaj migrimit të parregullt. Krahas mediave, një pjesë e rëndësishme janë gjithashtu reporterët, analistët, redaktorët, regjisorët, skenaristët, producentët, fotografët, kameramanët, specialistë të multimedias, specialistë të mediave dhe marketingut, studentë të gazetarisë, etj.

#### ▪ Qeveria Shqiptare / Institucionet publike që punojnë në fushën e migrimit

Institucionet publike shqiptare që luajnë një rol të rëndësishëm në trajtimin dhe parandalimin e migrimit të parregullt si:

- Ministria e Brendshme, përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022,
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA),
- Zyrat e Migrimit,
- Qeverisja lokale,
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Projekti do të ndihmojë në koordinimin e palëve të interesuara, duke bërë të mundur që ata që të angazhohen në ndërgjegjësim.

OSHC -të lokale do të përfshihen gjithashtu, në mënyrë që të përmirësojnë ekspertizën dhe bashkëpunimin e tyre me agjencitë qeveritare.

#### ▪ **Persona të njohur/Personazhe**

Shkrimtarë të njohur, artistë, atletë, intelektualë, aktivistë socialë, drejtues të komuniteteve, etj., që bëhen imazhe të fushatës dhe janë të gatshëm të angazhohen në betejën kundër migrimit të parregullt.

#### ▪ **Partnerët e zhvillimit**

Pjesë e rëndësishme e projektit janë edhe partnerët dypalësh dhe shumëpalësh të zhvillimit. Ky segment mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në mobilizimin e burimeve, mbështetjen në dialogun e politikave dhe partneritetin në zbatimin e projektit.

<b>PYETJE</b>	
1	<i>Cilat mund të jenë disa nga fushat e komunikimit?</i>
2	<i>Çfarë kuptojmë me zgjerim audience?</i>
3	<i>Pse është i rëndësishëm komuniteti në strategjitë e komunikimit?</i>
4	<i>Pse është e rëndësishme analiza e audiencës së synuar?</i>
5	<i>Çfarë kuptojmë me grup interesi?</i>
6	<i>Pse janë të rëndësishme organizatat e shoqërisë civile?</i>
7	<i>Cilat janë institucionet publike që luajnë një rol me rëndësi në trajtimin e migrimit?</i>

## **E.4 – KANALET DHE MJETET E KOMUNIKIMIT**

### **E.4.1 Kanalet e komunikimit**

Arritja e audiencës së targetuar është një detyrë vendimtare që ka nevojë për kanale dhe mjete të përshtatshme dhe efektive. Këto kanale dhe mjete luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e imazhit dhe vizibilitetit të çështjes së projektit.

Në fakt, TV kombëtar dhe lokale në Shqipëri janë kanalet më të fuqishme të komunikimit masiv, me shtrirjen më të gjerë, që sigurojnë informacione për të gjitha grupet shoqërore, pavarësisht niveleve të ndryshme të edukimit dhe statusit shoqëror. Por kohët e fundit Shqipëria ka parë një përhapje të gjerë të mediave të bazuara në internet dhe kanaleve të komunikimit në internet, që po fitojnë gjithnjë e më shumë audiencë. Më poshtë janë kanalet dhe mjetet që mund të përdoren në mënyrë efektive për të përcjellë mesazhet strategjike për të gjithë audiencën e synuar të objektit të projektit për migrimin.

#### **1. Televizioni**

Kanalet televizive në Shqipëri mund të përdoren për fushata komunikimi në nivel kombëtar, si dhe për fushata komunikimi në nivel lokal. Në fakt, kanalet televizive kombëtare vazhdojnë të dominojnë jo vetëm audiencën kombëtare, por edhe atë lokale. Sipas gjetjeve të studimit, njerëzit që duan të migrojnë e konsiderojnë televizionin si burimin kryesor të informacionit.

Si kanalet më të përdorura të komunikimit, stacionet kryesore televizive kombëtare dhe lokale janë planifikuar të përfshihen për shpërndarjen e mesazheve të fushatës përmes programeve dhe shfaqjeve të tyre më të ndjekura. Për këtë, sugjerohet të ketë 3 pjesëmarrje në TV kombëtar, një pjesëmarrje në radio Kombëtare dhe 14 pjesëmarrje në televizionet lokale (3 në televizionet lokale në Tiranë dhe 11 të tjera në televizionet lokale - ndoshta një për secilin prefekturë).

Më poshtë është një tabelë me listën e stacioneve televizive dhe programeve që mund të përdoren për daljet në media të parashikuara në kuadër të këtij projekti dhe ku mund të marrin pjesë përfaqësues të projektit apo dhe personazhe të njohur.

Nr.	Programet Televizive/medi	Kanali	Mbulimi i sinjalit
Kanale TV Kombëtare			
1	Mirëmëngjes, Dite pas dite,	TVSH	Në të gjithë territorin e vendit
2	E diela shqiptare	Klan TV	Në të gjithë territorin e vendit
3	“E diell”, Përputhen or “Wake Up”	TOP CHANNEL	Në të gjithë territorin e vendit
4	Shqipëria LIVE	TOP CHANNEL	Në të gjithë territorin e vendit
5	Mirëmëngjes	Euronews Albania	Në të gjithë territorin e vendit
Kanale TV Lokale			
1	Shqiptarët për shqiptarët	Tv News 24	Prefektura e Tiranës
2	“Log” or “ABC Story”	ABC News	Prefektura: Tirana, Fier, Elbasan, Durrës
3	A Show	Syri Tv	Prefektura: Tirana, Durrës, Fier
4	TBD	TV Lobi	Prefektura: Korça
5	TBD	TV Mati	Prefektura: Dibër
6	TBD	TV Apollon	Prefektura: Fier, Vlora
7	TBD	TV Bulqiza	Qyteti i Bulqizës
8	TBD	Alpo TV	Prefektura: Gjirokastrë
9	TBD	TV Channel 1	Prefektura: Shkodër
10	TBD	TV Saranda	Qyteti i Sarandës
11	TBD	Best Channel, or Scampa	Prefektura: Elbasan
12	TBD	TV Lezha	Prefektura: Lezhë
13	Fusion	Real TV	Prefektura: Vlorë
14	TBD	Tema TV	Online
Gazetat online			
15	Panorama	Panorama	Online
16	Shqiptarja	Shqiptarja	Online
17	Koha Jone	Koha Jone	Online
18	SOT	SOT	Online

Më poshtë janë disa produkte ose programe të tjera që propozohen të shpërndahen përmes kanaleve televizive:

- **Reklama televizive të shkurtra, promovuese/ndërgjegjësuere**

Kanalet televizive do të përdoren gjerësisht jo vetëm përmes programeve televizive që mund të përfshijnë intervista me përfaqësuesit e projektit, por edhe përmes reklamave të shkurtra televizive ose videove të shkurtra që shpërndajnë mesazhe të rëndësishme dhe pozitive në një mënyrë tërheqëse dhe kreative.

Në këtë linjë, prodhimi dhe transmetimi i një spoti televiziv të përgatitur gjithashtu në format të përshtatshëm për mediat sociale, është një nga mjetet që sugjerohet të përdoret për këtë fushatë.

- **Propozime për spotet televizive**

Ideja është të krijohen spote/reklama televizive që u lejojnë njerëzve të asimilojnë mesazhet në mënyrën më të përshtatshme për ta. Reklamata televizive me mesazhe të sakta, të realizuara mirë dhe të transmetuara shpesh duket se kanë ndikim.

- **TVC emocionale** - evidenton gjithçka duke nisur nga marrëdhëniet apo ndjenjat që u mungojnë më së shumti atyre që largohen nga vendi në mënyrë të parregullt; kufizimet në lëvizje, të imponuara nga migrimi i parregullt, për vizituar familjen dhe miqtë si dhe ndarjen me ta të përvojave që ndodhin vetëm një herë në jetë. Përmes këtij spoti është e rëndësishme të theksohet rëndësia e marrjes së vendimeve të migrimit të mirë informuar përmes Burimeve Zyrtare të Informacionit, zyrave ose faqeve të internetit. Shfaqja e mënyrave të gabuara dhe të drejta brenda një TVC (reklama) të shkurtër dhe emocionale.
- **TVC Argëtuese** – thekson nevojën e verifikimit të të gjitha mesazheve të marra përmes burimeve jo zyrtare, siç janë anëtarët e familjes dhe miqtë që jetojnë jashtë vendit. Kjo ide është e lidhur me lojën e "Telefonit të prishur", e cila tregon transformimin që pësojnë deklaratat e dëgjuesit. Personazhi qendror i skenarit të TVC mund të jetë një aktor humorit i cili ndan rrëfimin e tij për migrimin e parregullt që filloi me një telefonatë dhe se si dëgjimi i tij i dobët e bëri atë të keqinterpretonte indikacionet dhe të krijojë pritshmëri joreale për aventurën e tij migratore. Ky spot synon të sqarojë iluzionet në lidhje me migrimin dhe thekson nevojën për t'u bazuar ekskluzivisht në burimet zyrtare për të gjitha informacionet.

- **Talent show**

Qëllimi është nxitja e krijimit të një SHOW Tv të ri që fokusohet tek profesionistët e rinj dhe mundësitë e punësimit në Shqipëri, kryesisht në sektorin privat. Gjetjet e hulumtimit nxjerrin në pah se të rinjtë në Shqipëri duan të migrojnë për shkak të mungesës së shanseve në vendin e tyre, vështirësi në punësim, përvoja të reja ose

sfida. Shumica e pjesëmarrësve në Grupet e Fokusuara deklaruan, "Unë dua të migroj, për të provuar veten." Në këtë situatë, është e rëndësishme t'u dërgohet atyre një mesazh shprese, jo përmes fjalëve, por nga emocionet, adrenalina e konkurrencës, modelet pozitive, dhe natyrisht promovimi i vlerave dhe virtyteve. Ky emision televiziv i propozuar mund të jetë një mundësi shumë e mirë.

#### ▪ **Mini serial Televiziv**

Ne propozojmë, në bashkëpunim me një studio relativisht të vogël, për të prodhuar një mini-serial të bazuar në një histori migrimi të parregullt. Episodet do të përqendrohen në rreziqet e migrimit të parregullt dhe nevojën për t'u informuar siç duhet përpara se të merret një vendim i rrezikshëm.

Cilat janë vështirësitë me të cilat mund të përballlet dikush dhe cila është situata më e keqe që mund të ndodhë? Historia mund të prodhohet në një skenar paralel ku personazhi kryesor mund të zgjedhe të dyja opsionet, të migrojë në mënyrë të parregullt dhe të përballlet me të gjitha vështirësitë, si dhe një situatë paralele ku mund të marrë më shumë njohuri për të përmirësuar karrierën dhe jetën e personale dhe të migrojë në mënyrë të rregullt.

#### ▪ **Programe TV mëngjesi dhe pasdite**

Programet e mëngjesit dhe pasdites mund të përdoren për këtë fushatë si një mjet për të informuar individët që janë të interesuar të migrojnë, në lidhje me mundësitë në Shqipëri. Këto mjete do të ndihmojnë gjithashtu në promovimin e institucioneve publike dhe private në Shqipëri që operojnë në fushën e migrimit.

## **2. Radio**

Radio mund të përdoret si një mjet efektiv për audiencën që udhëton dhe për zonat rurale ku sot jeton rreth një e treta e popullsisë shqiptare. Radio tejkalon barrierat e distancës dhe analfabetizmit më mirë se çdo medium tjetër. Ekziston një numër i madh i radiove lokale në Shqipëri, dhe përdorimi më i mirë i tyre në kuadrin e këtyre projekteve mund të jetë në fushën e lajmeve të shkurtra dhe në oraret kryesore, audio-reklama dhe programeve të ashtuquajtura 'argëtuese- edukuese'.

#### ▪ **Radio spot**

Në serinë e aktiviteteve në media, të planifikuara në kuadër të këtij projekti, është parashikuar prodhimi dhe transmetimi i një spoti në Radio, që mund të transmetohet përmes Radio Stacionit Kombëtar (Club FM) dhe të shpërndahet përmes mediave sociale si një produkt podcast.

#### ▪ **Podcast**

Një seri *Podcast* mbi mundësitë e migrimit propozohet të zhvillohet në bashkëpunim me një gazetar/folës të njohur i cili ka përvojë të mëparshme migrimi. *Podcast*-et (vetëm audio ose audio dhe video grafike) tani konsiderohen një lloj argëtimi, si dhe një burim informacioni dhe frymëzimi për dëgjuesit. Së bashku me përvojën e tij, prezantuesi do të tregojë histori dhe intervista me njerëz që kanë pasur përvoja të suksesshme dhe të pasuksesshme të migrimit, si dhe mundësitë dhe pengesat me të cilat ata janë përballur si dhe rekomandime stimuluese.



#### **E.4.2. Media e shkruar dhe materialet informuese**

Media e shkruar përdoret kryesisht nga brezat e vjetër dhe zyrtarët qeveritarë. Qarkullimi i mediave të shkruara mbetet ende i ulët veçanërisht në zonat rurale; por media e shkruar mbetet një medium i rëndësishëm për udhëheqësit e opinionit.

Kolonat tematike, reportazhet ose intervistat me individë të njohur që mësuan të duan të jetojnë në Shqipëri si rezultat i përvojës së tyre migruese, janë disa mjete të dobishme të planifikuara për t'u përdorur nëpërmjet mediave të shkruara.

Këtu mund të përmendim edhe materiale të printuara si broshura, postera dhe banderola, histori të animuara, vizatime dhe karikatura, fletëpalosje, broshura dhe fletushka.

#### **E.4.3. Mediat e bazuara në internet dhe kanalet e komunikimit elektronik**

Një shumëllojshmëri komunikimesh mund të organizohen përmes kanaleve online, duke përfshirë website-in e IOM Albania, profilet dhe kanalet e projektit në Facebook, Instagram, YouTube, etj. Kanalet online janë veçanërisht të rëndësishme për të arritur tek të rinjtë, zyrtarët qeveritarë dhe audienca e arsimuar.

##### **▪ Fushatë në social media**

Sipas hulumtimit të kryer në kuadër të këtij projekti, njerëzit kalojnë shumë kohë në mediat sociale dhe ndjekin njerëz që kanë interesa të ngjashme me ta. Lundrimi nëpër këto media është një nga aktivitetet më të shpeshta që individët bëjnë kur janë vetëm. Kjo na mundëson t'i arrijmë ata në një moment qetësie dhe pse jo ata mund t'i ndajnë informacionet dhe me rrjetin e tyre lokal dhe ndërkombëtar. Në këtë strategji, audienca jonë kryesore (njerëzit që planifikojnë të migrojnë) mund të veprojnë gjithashtu dhe si një urë për përçimin e mesazheve të projektit tek ata që jetojnë jashtë vendit dhe kanë rolin e mbështetësve kryesorë. Siç është parashikuar në këtë strategji komunikimi, do të zhvillohet **një fushatë në mediat sociale**, e cila do të shtrihet në të gjithë vendin si dhe diasporën shqiptare në BE dhe veçanërisht në Belgjikë dhe Holandë, kur është e mundur, duke përdorur një qasje me disa kanale. Në këtë drejtim, Facebook, Instagram dhe YouTube do të jenë mediat kryesore sociale të përdorura në kuadër të këtij projekti, pasi ato raportohen si mediat sociale më të përdorura sipas gjetjeve të anketës kombëtare.

Kjo strategji komunikimi merr në konsideratë edhe gjetjet e hulumtimit cilësor të cilat tregojnë se përdoruesit e mediave sociale e kanë më të lehtë të përpunojnë informacionin e dhënë me tekste të shkurtra sesa artikuj të detajuar. Gjithashtu, siç u përmend më lart, ata do të preferoheshin video të shkurtra dhe argëtuese me një mesazh kuptimplotë sesa biseda të zgjatura në programe televizive.

Në këtë aspekt, **ndërgjegjësimi përmes reklamave të shkurtra promovuese dhe videove** konsiderohet gjithashtu shumë efektive për fushatat në internet. Këto materiale komunikimi do të shpërndahen përmes rrjeteve sociale më të përdorura në Shqipëri: Facebook, Instagram dhe YouTube. Për këtë rekomandohet një

bashkëpunim me **një platformë digjitale** me një numër të madh ndjekësish, të ndërtuar nga një ekip kreativ aktorësh, regjisorësh dhe producentësh që synojnë të **argëtojnë dhe rrisin ndërgjegjësimin e publikut për çështje të ndryshme socio-politike përmes dublimeve, parodive dhe skeçeve komike**. Gjithashtu, **fushatat e ndërgjegjësimit të Google AdWords** mund të përdoren si një mjet i dobishëm për të arritur audiencën e synuar. Fushatat e ndërgjegjësimit të Google AdWords dhe **marketingu me email përmes platformës Mail Chimp** janë në fakt mjetet më të suksesshme të komunikimit në internet, të cilat gjithashtu janë planifikuar të përdoren në mënyrë efektive në zbatimin e kësaj strategjie komunikimi.

- **Realizimi dhe shpërndarja online e video mesazheve të shkurtra**

Rrjeti prej disa "influencers" të përzgjedhur mund të parashikohet në projektin e informimit për migrimin do të ndikojë në krijimin e disa video mesazheve të shkurtra të regjistruara me të rinj që ndajnë përvojën e tyre të kaluar, aktuale ose të mundshme migrimi.

Çdo *'influencer'* do të identifikojë të paktën dy të rinj, një djalë dhe një vajzë me përvojë personale migrimi ose migrues të mundshëm. Këta të rinj do të ndajnë historinë e tyre përmes një video mesazhi të shkurtër prej rreth 3-5 minutash që do të publikohet në internet dhe do të shpërndahet gjatë eventeve publike të projektit. Videot do të përgatiten nga një kompani prodhuese e videove sipas nevojës në formate të përshtatshme dhe për mediat sociale. Ato do të shpërndahen gjatë ngjarjeve të fushatës, prezantimeve në shkollë, universitete etj. Gjithashtu, një kanal në YouTube do t'i kushtohet këtyre video mesazheve.

- **Kurs i hapur online**

Si një mjet inovativ për ngritjen e kapaciteteve, mund të zhvillohet një kurs i hapur online. Ky kurs online do të mund të ndiqet në mënyrë të pavarur dhe do të shërbejë si një mundësi trajnimi e vazhdueshme që nuk do të ndahet vetëm me institucionet përkatëse dhe OShC-të, por edhe me universitetet dhe publikun e gjerë, duke u bërë një promovues vendimtar i informimit mbi migrimin e parregullt dhe të rregullt. Kursi i hapur online do të jetë i krijuar për të gjithë ata që kanë interes në legjislacionin dhe politikën e lidhura me migrimin, si dhe mundësi për migrim të rregullt, arsim, trajnim, biznes, vetëpunësim dhe punësim. Përmbajtja e kursit do të marrë parasysh nevojat specifike gjinore dhe pjesëmarrësit do të ndahen sipas gjinisë.

#### **E.4.4. Kanale alternative komunikimi**

- **Seminare dhe workshop**

12 seminare do të zhvillohen me institucionet publike dhe OShC -të që punojnë në fushën e migrimit në nivel kombëtar dhe lokal. Këto do të japin një pasqyrë të politikave së migrimit, arsimit, biznesit dhe mundësive të punësimit në Shqipëri, si dhe rrugët e rregullta të migrimit drejt BE -së. Organizimi i seminareve synon të sigurojë qëndrueshmëri dhe përfshirje afatgjatë të palëve të interesuara duke ndërtuar kapacitetet për t'u angazhuar me migrantët potencialë dhe mbështetësit e tyre.

Në lidhje me seminarët, në mënyrë që ato të jenë efektive dhe të krijojnë interesimin e dëshiruar për të mundësuar rritjen e ndërgjegjësimit, ato do të dokumentohen dhe shpërndahen përmes mediave, kanaleve sociale të palëve të interesit dhe aplikacionit celular. Këto evente do të promovohen mirë paraprakisht, si në mediat tradicionale ashtu edhe në ato online. Është planifikuar gjithashtu që të ketë kronika lajmesh në televizionet lokale që raportojnë për këto aktivitete.

#### ▪ **Materiale vizive**

Prodhimi i materialeve promovuese për projektin përfshin materiale tradicionale dhe të pëlqyera nga të rinjtë, si fletëpalosje, stikera, kartolina, stema me kapse, stilolapsa, dosje, varëse çelësash, USB, fletore, çanta, filxhanë, çadra, postera, bluza, unaza për mbajtjen e celularit etj.

#### ▪ **Evente të njohura tërheqëse**

Në bashkëpunim me organizatorët e festivaleve muzikore, eventeve sportive, artistike, ekspozitave dhe panairove, festimeve lokale, etj. do të angazhohet 1 festival muzikor, ose ngjarje sportive popullore dhe panairë tregtare me mbulim kombëtar dhe në 6 evente me mbulim lokal, për përhapjen e mesazheve të fushatës

Disa prej tyre mund të jenë:

- Evente sportive kombëtare dhe ndërkombëtare
- Festivali i Këngës Magjike, etj.

#### ▪ **Aplikacioni për celular dhe data baza e projektit**

**Aplikacioni celular** përmes të cilit individët informohen për mundësitë e rregullta të migrimit, si dhe mundësitë e karrierës dhe arsimit brenda dhe jashtë Shqipërisë, do të jetë një kanal i shumë i mirë komunikimi për projektin e informimit për migrimin. Ky aplikacion do të përmbajë gjithashtu një axhendë të fushatës në mënyrë që individët që e shkarkojnë atë të mund të ndjekin aktivitetet me interes për ta. Një komponent tjetër që duket të jetë domethënës për projektin mund të jetë arkivimi i të gjitha seminareve të organizuara për këtë qëllim, të cilat do të vendosen në një hapësirë të veçantë të aplikacionit.

Për të siguruar qëndrueshmëri për fushatën, do të krijohet një **bazë të dhënash** që mbledh informacionet mbi migrimin e rregullt, arsimin, trajnimin, biznesin, vetëpunësimin dhe mundësitë e punës për të kthyerit dhe migrantët potencialë në Shqipëri dhe në vendet e zgjedhura të BE-së.

Mjete dhe kanale të tjera alternative për t'i shërbyer këtij projekti mund të jenë:

#### ▪ **Aktivitete përkujtimore**

Një ekspozitë fotografike që përkujton përvjetorin e *Eksodit Masiv Shqiptar* gjatë vitit 1991, do të shërbejë për të kujtuar dramën e migrimit të parregullt shqiptar.

Gjithashtu, një aktivitet përkujtimor do të organizohet në përvjetorin e Tragjedisë së Otrantos e cila ndodhi më 28 mars 1997 kur një anije shqiptare që transportonte migrantë ilegalë në Itali u mbyt në një përplasje me një anije italiane në ngushticën e Otrantos dhe të paktën 84 Shqiptarë, të moshës 3 muaj deri në 69 vjeç, humbën jetën.

Një sërë aktivitete të ndryshme janë planifikuar gjithashtu të organizohen me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Migrantëve më 18 Dhjetor.

#### ▪ **Ted Talks**

Ted Talks është një fenomen i ditëve moderne që është veçanërisht efektiv në rritjen e vetëdijes për tema të veçanta. Zakonisht, përdoret për objektivat komerciale dhe industriale, megjithëse disa nga fjalimet më me ndikim kanë trajtuar çështje të jetës së përditshme. Njerëzit që kanë të njëjtin interes mbledhen së bashku për të ndarë historitë e tyre, për të mësuar nga njëri -tjetri dhe për të mësuar nga përvojat e të tjerëve. Të gjitha fjalimet regjistrohen dhe më pas vihen në dispozicion në internet.

Një aktivitet i ngjashëm mund të organizohet për shkëmbimin e përvojave të migrimit. Shumë individë në Shqipëri emigruan në fillim të viteve 1990 dhe janë kthyer, duke sjellë me vete gjithçka që kanë fituar, financat, ekspertizën dhe përvojat. Ka edhe nga ata që kanë studiuar jashtë vendit dhe kanë zgjedhur të kthehen në vendin e tyre për të investuar dhe ofruar zgjidhje të reja për bashkëmoshatarët. Historitë e tyre mund të japin shpresë, duke theksuar idenë se ka individë që janë përballur me sfida të ngjashme dhe megjithatë kanë arritur të përmirësojnë jetën e tyre duke kontribuar gjithashtu në mirëqenien e të tjerëve.

Njerëz të njohur dhe influencues mund të përfshihen gjatë këtij lloji aktiviteti.

Disa vende të përshtatshme ku mund të organizohen këto lloji aktivitete janë:

- Reja (The Cloud) një instalacion i vendosur përpara Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë,
- Amfiteatri tek Parku i Liqenit Artificial,
- Hapësira të tjera publike në qytete të vogla ose fshatra.


Të gjitha regjistrimet e eventeve mund të publikohen në internet përmes llogarive të ndryshme të mediave sociale, dhe profileve individuale në Facebook, YouTube dhe Instagram si fjalime motivuese/frymëzuese.

#### ▪ **Reklamimi jashtë shtëpisë**

Njerëzit duket se janë në kontakt të përditshëm me mediat tradicionale dhe online, si dhe me kanalet e ndërgjegjësimit offline (Jashtë shtëpisë - OOH) siç janë citylights, stacionet e autobusëve, billboardet, etj. Mediat offline gjithashtu mund të përdoren për këtë fushatë, por vetëm mesazhet kryesore duhet të ndahen, me gjuhë dhe fjalor që lexuesit e përdorin në përditshmëri, dhe imazhe me ngjyra të tërheqëse. Vendndodhjet e OOH gjithashtu duhet të jenë pranë zyrave që ofrojnë informacione për migrimin, si dhe në rrugët me trafik të lartë dhe rrugët për këmbësorë.

Sipas gjetjeve të anketës kombëtare duket se komunikimet shumëngjyrëshe janë më tërheqëse. Siç tregohet në Udhëzimet për Fushatat e Komunikimeve Publike të IOM, ne rekomandojmë përdorimin e ngjyrave dytësore të IOM të lidhura me ngjyrën blu parësore. Në këtë kontekst, përdorimi i ngjyrave dytësore do t'i ofrojë mesazheve të fushatës më shumë dinamizëm, duke e bërë atë më tërheqëse dhe të paharrueshme për audiencën.

Figura 23 - Përdorimi i ngjyrave për mesazhet



▪ **Mesazhet grafike**

Mesazhet e vizatuara me grafitë po bëhen gjithnjë e më të popullarizuara në mesin e të rinjve shqiptarë dhe mund të përdoren me sukses gjatë zbatimit të kësaj strategjie. Një mesazh grafik është një formë e komunikimit me efektin vizual. Ajo eksploron idenë se një mesazh vizual me tekst ka një fuqi më të madhe për të informuar, edukuar ose bindur një person dhe është komunikim duke paraqitur informacione përmes formës vizuale dhe përdorimit të ngjyrave specifike të lidhura me konceptin dhe institucionin iniciues. Komunikimi vizual gjithashtu është një mënyrë që është më efikase dhe ndihmon për të përcjellë më shumë kuptim pasi është një element i rëndësishëm i çdo strategjie të marketingut me përmbajtje. Kjo për shkak se pamjet vizuale mund të ndihmojnë për të evokuar emocione në audiencë dhe të japin shembuj më të fortë për mesazhin që duam të përçojmë. Komunikimet e mira grafike mund të përcjellin përmbledhjen e një postimi në media sociale, të shfaqin një produkt të ri, të përdoren për të shpjeguar qartë një informacion dhe, më e rëndësishmja, të vendosin shenja në kujtimet e audiencës së synuar. Komunikimi grafik frymëzon njerëzit të ndër marrin veprime dhe mund të jenë emocionues dhe bindës njëkohësisht.

PYETJE	
1	<i>Cilat mund të jenë disa nga kanalet alternative të komunikimit?</i>
2	<i>Çfarë kuptojmë me mesazh grafik?</i>
3	<i>Pse është e rëndësishme grafika në komunikim?</i>

## E.5 – MESAZHET KRYESORE DHE NDERVEPRIMI

### E.5.1 Komunikimi ndër personal


Komunikimi ndër personal mund të përdoret në takime të ndryshme dhe relativisht të vogla ose në evente të tjera publike.

#### ▪ Personazhe të njohur

"Lajmëtarët e besuar" (figura publike, të njohur nga sporti, muzika apo televizioni, udhëheqës fetarë, etj.) janë një shtresë e rëndësishme e shoqërisë shqiptare që pritet të sjellë rezultate pozitive gjatë zbatimit të kësaj strategjie komunikimi. Ata do të angazhohen si një kanal i rëndësishëm i komunikimit ndër personal, si dhe një tribunë efektive e komunikimit masiv.

Anketa kombëtare identifikoi profilet më të ndjekura në mediat sociale sipas pjesëmarrësve në hulumtim, që mund të ndikojnë në vendimet e njerëzve. Preferencat e pjesëmarrësve (të ndara sipas grup moshës) tregohen në grafikun më poshtë.

Figura 24 - Preferencat e pjesëmarrësve



#### ▪ Rrjeti i "Influencers"

Rrjeti i "influencer" do të hyjë në kontakt me popullatën e synuar dhe të nxjerrë në pah alternativa më të mira sesa zgjedhjet e migrimit të parregullt duke ofruar në të njëjtën kohë dëshmi reale mbi rreziqet e migrimit të parregullt. Këta janë kryesisht njerëz me reputacion të mirë në komunitet dhe përvojë të mëparshme migruese.

Slogani që propozojmë për këtë fushatë është:

*Anglisht: Albania is YOU! Shqip: Shqipëria je Ti!*

Mesazhi që ky slogan përcjell lidhet me mënyrën se si njerëzit i faturojnë pakënaqësitë e tyre vendit ku jetojnë, pa e menduar se vet vendi bëhet prej tyre. Janë ata që ndërtojnë "fytyrën" e vendit, ndikojnë drejt për së drejti në të ardhmen e tij.

"Shqipëria je Ti", mund të synojë të sjellë në vëmendje se pakënaqësitë nisin nga vetja, e nëse dëshirojnë të përmirësojnë jetën e tyre duhet ta nisin nga përmirësimi i vetes duke zbuluar të gjitha mundësitë për vet-zhvillim që ofrohen në Shqipëri.

Ky slogan vjen si një thirrje për ata që synojnë të migrojnë që të kërkojnë mundësi në vend përpara se të vendosin të largohen prej tij.

Nga ana tjetër “Shqipëria je ti!” sjell mesazhin se kudo të shkosh Shqipëria është vendi yt dhe e ardhmja jote lidhet me të.

Për të mbërritur këtu, është kaluar në një sërë hapash me diskutime dhe testime, për gjetjen e sloganit kryesor të fushatës. Ndërkohë që ekipi propozoi dhe testoi tre slogane kryesore, më i përshtatshmi ndër to u vlerësua slogan i cili reflekton gjetjet nga hulumtimi dhe potencialisht mund të ndikohen në vendimmarrjen e individëve lidhur me migrimin.

Ndërkohë krahas sloganit që do të jete i pandryshueshëm përgjatë të gjitha komunikimeve të fushatës për migrimin, në varësi të përmbajtës, kanalit, grupit të synuar apo situatës, sloganit duhet të shoqërohet dhe me disa mesazhe.

Zhvillimi i tyre është po aq i rëndësishëm sa përcaktimi i sloganit. Mesazhet duhet të jenë të shkurtra dhe kuptimplota që të ndihmojnë mbarëvajtjen e fushatës së komunikimit. Kombinuar me sloganin, do të japin efektin e duhur.

Për këtë strategji komunikimi, ne kemi përdorur një qasje ku migrantët potencialë duhet të zgjedhin midis dy skenarëve: **Zgjedhjes së gabuar përkundrejt zgjedhjes së duhur.**

Në këtë skenar, mesazhet kryesore përqendrohen në 4 shtylla

**Shtylla e parë:** Mënyrat e parregullta kundrejt mënyrat e rregullta

*Mesazhi kryesor:* Mbro veten! Migro në rrugë të rregullta!

**Shtylla e dytë:** Pasojat kundrejt Mundësitë

*Mesazhi kryesor:* Mbaj hapur dyert e Europës! Migro si European!

**Shtylla e tretë:** Vendim i bazuar në informacione të gabuara kundrejt Vendim i mirë informuar \*

*Mesazhi kryesor:* Informohu mirë para se të migrosh. Zgjidh mënyrën e duhur!

\*Hulumtimi cilësor zbuloi se individët nuk janë në dijeni të Zyrave të Migrimit që mund të ndihmojnë migrantët në vendimmarrjen e tyre. Ky mesazh mund të përdoret për të rritur ndërgjegjësimin mbi institucionet shqiptare që ofrojnë informacion dhe ndihmë mbi mundësitë e rregullta të migrimit.

**Shtylla e katërt:** Mundësitë në vend kundrejt Migrimi

*Mesazhi kryesor:* Nuk ka rrugë të shkurtër që të çon aty ku ti meriton të jesh. Migro në mënyrë të rregullta!

Më poshtë janë disa nga mesazhet kryesore që vijnë nga akset kryesore të projektit për migrimin:

- Projekti për migrimin duhet të ndikojë në ndryshimin e sjelljes së grupeve me potencial të lartë për të migruar në mënyrë të parregullt, si dhe “mbështetësve” kryesorë (familja, miqtë etj.)
- Projekti do të ndërgjegjësojë mbi rreziqet e migrimit të parregullt qytetarët shqiptarë që e konsiderojnë atë si një mundësi .
- Projekti do të sigurojë informacion mbi mundësitë ekzistuese ekonomike dhe arsimore në Shqipëri dhe institucionet publike që ndihmojnë në informimin mbi kanalet e rregullta të migrimit në Europë.
- Me qëllim ndërgjegjësimin për vështirësitë e migrimit të parregullt me të cilin përballen personat që largohen nga Shqipëria, Plani është strukturuar të zhvillohet tërësisht në Shqipëri.
- Shqipëria do të përfitojë drejtpërdrejt nga zbatimi i projektit, i cili do të zhvillohet në territorin e saj dhe do të angazhojë drejtpërdrejt qytetarët, shoqërinë civile, aktorët shtetërorë dhe diasporën.
- Të gjitha vendet e Bashkimit Europian do të përfitojnë nga rezultatet e Fushatës të cilat do të ndikojnë në uljen e numrit të shqiptarëve që kalojnë në mënyrë të parregullt kufijtë e BE -së.
- Shqipëria është njohur si një vend i sigurt origjine nga 12 shtete anëtare të BE -së deri më tani.
- BE -ja ka përcaktuar një qasje të balancuar për menaxhimin e migrimit të rregullt dhe luftimin e migrimit të parregullt.
- Qytetarët Shqiptarë, vazhdimisht, e kanë perceptuar azilin si një mënyrë drejt qëndrimit dhe punësimit të ligjshëm. Megjithatë, shumica e kërkesave për azil refuzohen.
- Duke u bërë të parregullt, individët shqiptarë janë më të ekspozuar ndaj kontrabandës, trafikimit, krimit të organizuar, dënimeve dhe ndalimeve të udhëtimit.
- Migrimi i parregullt ka efekte negative në liberalizimin e vizave për Shqipërinë, si dhe integrimin në BE. Gjithashtu, është përmendur si një nga arsyet kryesore prej vendeve që ngurrojnë të hapin negociatat për Shqipërinë.
- Rrëfimet e rreme mbi migrimin vazhdojnë në shoqërinë shqiptare. Ndryshimi i sjelljes ndodh në një nivel racional dhe emocional, jo vetëm përmes qasjes të drejtpërdrejtë në fakte, por edhe si një reflektim ndaj normave dhe rrëfimeve dominuese.
- Përmes shpërbërjes së miteve mbi migrimin, popullatës së synuar do t'i ofrohen histori alternative mbi rreziqet dhe kostot e migrimit të parregullt drejt BE -së, mundësitë në Shqipëri dhe migrimin e rregullt.



- Një individ i mirë informuar dhe “mbështetësit” kryesorë do të vlerësojë më mirë kostot dhe rreziqet e migrimit të parregullt gjatë udhëtimit, pas mbërritjes dhe pas kthimit në rastet e një vendimi të gabuar migrimi.
- Rrjetet e trafikimit mund të dobësohen nëse më pak njerëz kërkojnë shërbimet e tyre.
- Fushata është krijuar për të pasur qasjen “360 gradë”, jo vetëm duke u fokusuar tek informimi i individëve, por edhe duke krijuar një kundër-narracion përmes burimeve dhe kanaleve të ndryshme.
- Institucionet publike shqiptare luajnë një rol të rëndësishëm në trajtimin dhe parandalimin e migrimit të parregullt.
- Projekti do të ndihmojë në koordinimin e palëve të interesuara duke i mundësuar që të angazhohen në mënyrë autonome në ndërgjegjësimin e qytetarëve.
- OShC-të lokale gjithashtu mund të përfshihen në mënyrë që të zhvillojnë njohuritë dhe koordinimin e tyre me institucionet publike.
